

# PËR MËSUESIN/EN

**duk<sup>a</sup>gjini**  
shtëpia botuese publishing house

Mimoza Lipaj, Ardora Morina,  
Dorentina Trolli, Shqiponja Kamberi

# SHOQËRIA DHE MJEDISI

Për klasën e tretë të arsimit fillor

# 3

## PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes .....	5
Hyrje.....	7
Planifikimi vjetor.....	15
Plani dymujor: shtator—tetor.....	16
Plani dymujor: nëntor—dhjetor .....	19
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	23
Plani tremujor: prill—maj—qershor .....	28
Mësimi 1: Mirë se erdhe në klasën e tretë .....	32
Mësimi 2: Jetojmë së bashku .....	34
Mësimi 3: Grupet shoqërore.....	36
Mësimi 4: Unë dhe shkolla .....	38
Mësimi 5: Unë dhe të tjerët.....	40
Mësimi 6: Respektojmë njëri-tjetrin.....	42
Mësimi 7: Planifikojmë dhe veprojmë .....	44
Mësimi 8: Pjesëmarrja ime .....	46
Mësimi 9: Unë dhe familja ime .....	48
Mësimi 10: Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime .....	50
Mësimi 11: Sendet me vlerë të familjes sime .....	52
Mësimi 12: Ngjarjet në familje .....	54
Mësimi 13: Albumi i familjes dhe pema e familjes .....	56
Mësimi 14: Të drejtat dhe përgjegjësitë .....	58
Mësimi 15: Unë kam të drejta në familje .....	60
Mësimi 16: Të drejtat e mia në shkollë .....	62
Mësimi 17: Përgjegjësitë në komunitet.....	64
Mësimi 18: Stop dhunës në familje!.....	66
Mësimi 19: Stop dhunës në shkollë!.....	68
Mësimi 20: Shkolla ime.....	70
Mësimi 21: Festojmë së bashku.....	72
Mësimi 22: Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tim.....	74
Mësimi 23: Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme .....	76
Mësimi 24: Ruajmë traditat tona.....	78
Mësimi 25: Mjedisi ku jetoj.....	80
Mësimi 26: Pasuritë natyrore të vendit tim .....	82
Mësimi 27: Njeriu e ndryshon natyrën .....	84
Mësimi 28: Ndotja e mjedisit.....	86
Mësimi 29: Kujdesem për bimët dhe për kafshët.....	88
Mësimi 30: Uji është jetë .....	90
Mësimi 31: Rëndësia e ujit për jetën e njeriut.....	92
Mësimi 32: Toka dhe ajri.....	94
Mësimi 33: Diversiteti (llojllojshmëria) etnik e ai kulturor .....	96
Mësimi 34: Jetojmë së bashku me tolerancë e dashuri .....	98
Mësimi 35: Profesionet tona.....	100
Mësimi 36: Të ndryshëm, por të barabartë.....	102
Mësimi 37: Të punojmë së bashku .....	104
Mësimi 38: Unë dhe ti - të barabartë.....	106
Mësimi 39: Vendosim së bashku në familje .....	108

Mësimi 40: Vendosim së bashku në shkollë.....	110
Mësimi 41: Vendimmarrja në komunitet .....	112
Mësimi 42: Respektojmë mendimin ndryshe.....	114
Mësimi 43: Si të marr një vendim të drejtë .....	116
Mësimi 44: Pasuritë natyrore.....	118
Mësimi 45: Pasuritë nëntokësore.....	120
Mësimi 46: Profesionet e trashëguara.....	122
Mësimi 47: Ta kursejmë energjinë .....	124
Mësimi 48: Riciklimi i mbetjeve.....	126
Mësimi 49: Aktivitet: Ta mbrojmë mjedisin në të cilin jetojmë .....	128
Mësimi 50: Njeriu dhe mjedisi natyror.....	130
Mësimi 51: Njeriu dhe mjedisi kulturor .....	132
Mësimi 52: Një mjedis i pastër për të gjithë.....	134
Mësimi 53: Higjiena në komunitet .....	136

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimit. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimit ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimit dhe të të nxënësve, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.


Cilësia e re e të nxënësve dhe mësimit përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimit, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimit janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

# UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model

## Faqja në të majtë


- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënës të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënës.
- Parashikimi, faza e parë e orës mësimore, e cila siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato orës mësimore, tema është më e gjerë. mësimi.
- Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zberthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.
- Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera që evidencohen.

## Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit, ndihmon mësuesin/en, gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënës.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Përpunimi i përmbajtjes, faza e dytë e orës mësimore, e cila bën përzgjedhjen e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik të tij.
- Përfundimi, faza e tretë e orës mësimore, e cila bën integrimin e dijeve dhe të shprehive dhe zbatimin e tyre.

## Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësim

**Rezultatet e të nxënës të temës:** Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve dhe mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast mund merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me kurrikulën bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy, a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore, mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërës të tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** Filluar nga klasa e tretë e më lart, zotërojnë operacionet mendore, të menduarit e tyre është konkret me elemente të të menduarit abstrakt, prandaj mësimi me këta nxënës kalon në tri faza dhe të të menduarit të nxënësve sipas proceseve njohëse. Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e kurrikulës bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

**Rezultatet e të nxënësve:** Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës e që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

**Kriteret e vlerësimit/suksesit:** Janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënësit - hapat e zhvillimit të mësimi:** Mësimi zhvillohet përmes hapave, duke nxitur të menduarit logjik e kritik të nxënësve, duke pasur parasysh fazat e zhvillimit sipas Piazhesë.

**Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimi?**

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi/ja vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



**Parashikimi: Përgatitja për të nxënësve**

Në fazën e parashikimit mbillet një farë, në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënësve, kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimi, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



**Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes.**

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve.**

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësve e ri dhe, në mënyrë të gjallë, ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

## HYRJE

### Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin

## SHOQËRIA DHE MJEDISI 3

Përderisa përgatitja për jetë dhe për punë theksohet në tërë kurrikulën si një çështje e rëndësishme, fusha e Kurrikulës *Shoqëria dhe mjedisi* synon të kontribuojë veçanërisht si një fushë “mbartëse” në zhvillimin e kompetencave për jetë dhe për punë. Në shkallët 1 dhe 2 të kurrikulës, ajo përqendrohet në shkathtësitë për jetë, krahas shkathtësive që kanë të bëjnë me artizanatet dhe amvisërinë. Përmes kësaj fushe të kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si: anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin, duke qenë po ashtu të vetëdijshëm për ekzistimin e të tjerëve dhe nevojës për t'u mbështetur në marrëdhënie ndërpersonale në jetë dhe në punë, për sa i përket tolerancës dhe respektit të ndërsjellë. Ata do të zhvillojnë shpirtin për iniciativë dhe përgjegjshmëri; të hartojnë dhe të respektojnë planet e punës dhe afatet kohore, si dhe të njihen me cilësinë e proceseve dhe të rezultateve të tyre.


### Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën kurrikulare Jeta dhe puna mund të përdoren metodat e ndryshme të punës, me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo fushë, por, edhe për shkak të specifikave që bart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

### Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësit

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimitin e shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje, “Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës” (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënimit të fushës, rezultatet specifike të të nxënimit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimin e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mossuksesin, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvillonin mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënimit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënimit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndëshi magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënimit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënimit dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Burimi: *Metodologji e mësimdhënies*, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



**Zgjeroni dhe thelloni dijet**

*Për më shumë lexoni në: Musai, B. (2014)*

*Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.*

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijuar është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënien mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe të pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi/ja apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimin të japë rezultate.



**Zgjeroni dhe thelloni dijet**

*Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011)*

*Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.*

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijuar është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënien mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe të pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi/ja apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimin të japë rezultate.





Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



**Zgjeroni dhe thelloni dijet**

*Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)*

*Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.*

## Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh, në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

<b>III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm</b>	
1.	Parashtron pyetje që nxësin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

<b>IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv</b>	
1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

## V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike - lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njërin nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime, të cilat i konsumon familja, duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

## VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësues, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërit rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet - mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS SHOQËRIA DHE MJEDISI - Shkalla 2

<b>1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHTËSITË</b> që zhvillohen	
<b>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b> <b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup,
2.	Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdoreje, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.
<b>2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë</b>	
<b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.
<b>3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme</b>	
<b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Përdor vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë.
2.	Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësimdhënësit.
<b>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b>	
<b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.
2.	Përdor i sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.
<b>5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit</b>	
<b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Drejtëpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative-buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.
<b>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë</b>	
<b>Nxënësi/ja:</b>	
1.	Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.

## 7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme

### Nxënësi/ja:

1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësive, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

## 8. Komunikimi në/për jetë dhe punë

### Nxënësi/ja:

Është i vetëdijshëm për ekzistimin e diversitetit individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit, dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore.

## 9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm - mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit

### Nxënësi/ja:

1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.
2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

## II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen

- Toleranca;
- Respektimi i diversitetit;
- Përkushtimi;
- Qëndrim pozitiv;
- Bashkëpunimi;
- Respektimi i kodit të mirësjelljes;
- Respektimi rregullor;
- Gatishmëria;
- Siguria;
- Pavarësia në mendime dhe në veprime;
- Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme;
- Besimi në përdorimin e TIK-ut;
- Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit;
- Gatishmëria për bashkëpunim.

## III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

- Njeh veten dhe të tjerët;
- Tregon për veten, për familjen dhe për mjedisin;
- Identifikon rreziqet e ndryshme;
- Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative;
- Shkëmben përvojat;
- Demonstron sjellje, veprime, shprehje;
- Praktikton ushtrime;
- Ndërton bashkëpunim;
- Vendosmëria.

**Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi,  
Klasa III**

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)	
	PERIUDHA I		PERIUDHA II	PERIUDHA III		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor		
SHOQËRIA DHE MJEDISI	Unë, klasa dhe shkolla ime  Arkivi i familjes	Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri  Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim  Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme  Raporti njeri-natyrë	Raporti njeri-natyrë  Llojllojshmëria e shoqërisë  Së bashku dhe të barabartë  Konsultohemi së bashku dhe vendosim	Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre  Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim	I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv 1, 3, 4, 5, 6, 8
				II	Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	
				III	Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9	
				IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv 1, 3, 4, 5, 8	
				V	Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 1, 5, 6, 7, 8, 9	
				VI	Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9	

# PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

## Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

**Fusha e kurrikulës:** Shoqëria dhe mjedisi

**Klasa:** III

**Temat mësimore:** Unë, klasa dhe shkolla ime  
Në arkivin e familjes

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje, pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;
I.5	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.

### Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.

### Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët, përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera, për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo të një aktiviteti të caktuar;
III.7	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
------	--



### Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

<b>V.8</b>	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
------------	---

### Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

<b>VI.1</b>	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni;
<b>VI.2</b>	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
<b>VI.3</b>	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen zbatim ndonjëra nga ato;
<b>VI.5</b>	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre;
<b>VI.7</b>	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët;
<b>VI.8</b>	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet, mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.

### Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

<b>1.1</b>	Identifikon dhe krahason dëshmi të thjeshta (objekte, mjete, fotografi, veshje dhe gjëra të tjera) që lidhen me ngjarje personale, familjare dhe të komunitetit ku jeton dhe i klasifikon sipas kronologjisë;
<b>1.2</b>	Dallon strukturën e grupeve të ndryshme shoqërore, p.sh.: familja, shkolla, etj., dhe mund të bëjë krahasime si kanë qenë ato dikur dhe si janë tani;
<b>1.3</b>	Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe bashkësisë nga padrejtësitë.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Në arkivin e familjes</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Grumbullon gjësende të veçanta të familjes dhe të komunitetit; i klasifikon ato sipas llojit dhe bën prezantimin e tyre (në klasë, grup etj.);</li> <li>- Mbledh informacione për ngjarje të rëndësishme, nga familjarët dhe të tjerët, gjen të përbashkëtat dhe dallimet në mes tyre dhe i prezanton ato para të tjerëve;</li> <li>- Krahason ngjarjet personale dhe familjare, dikur dhe sot dhe i evidenton ndryshimet në mënyrë kronologjike, përmes kujtimeve, fotografive familjare dhe gjësendeve të tjera;</li> <li>- Përkrahet grupet shoqërore ku bën pjesë (në familje, në klasë, në shkollë etj.) dhe dallon përbërjen e tyre;</li> <li>- Dallon llojllojshmërinë në klasë, shkollë dhe shoqëri dhe tregon mirëkuptim dhe respekt ndaj të tjerëve ndryshe;</li> <li>- Tregon shembuj konkretë të aktiviteteve shkollore (shënime të ditëve të veçanta, koncerte, shfaqje, gara, gjelbërimin e mjedisit etj.) dhe përkrahet mënyrën e planifikimit të tyre;</li> <li>- Merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve në klasë dhe shkollë dhe kontribuon në mënyrë kreative në realizimin e tyre;</li> <li>- Planifikon bashkërisht me bashkëmohatarët aktivitete të ndryshme, duke përcaktuar përbërjen dhe rolin e secilit anëtar pjesëmarrës.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mirë se erdhe në klasën e tretë</li> <li>2. Jetojmë së bashku</li> <li>3. Grupet shoqërore</li> <li>4. Unë dhe shkolla</li> <li>5. Unë dhe të tjerët</li> <li>6. Respektojmë njëri-tjetrin</li> <li>7. Planifikojmë dhe veprojmë</li> <li>8. Pjesëmarrja ime</li> <li>9. Unë dhe familja ime</li> <li>10. Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime</li> <li>11. Sendet me vlerë të familjes sime</li> <li>12. Ngjarjet në familje</li> <li>13. Albumi i familjes dhe pema e familjes</li> </ol>	13	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit me fëmijën në qendër dhe gjithëpërfshirja</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar</li> </ul>	- Vlerësimi formativ	<p>Gjuhë amtare</p> <p>Matematikë</p> <p>Edukatë figurative</p> <p>Njeriu dhe natyra</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare:</p> <p>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</p>	<p>“Shoqëria dhe mjedisi 3”</p> <p>“Shoqëria dhe mjedisi 3”, fletore pune</p>
<p>Unë, klasa dhe shkolla ime</p>						

# PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

## Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

**Fusha e kurrikulës:** Shoqëria dhe mjedisi

**Klasa:** III

**Temat mësimore:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri  
Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim  
Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme  
Raporti njeri-natyrë

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës që synohen të arrihen përmes shtjellit të temës/temave: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv</i>	
I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje, pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërin nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore, historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimit) të tyre.

Kompetenca e të nxënësve – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj;
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinën për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
------	---

### Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.7	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

### Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni;
VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.3	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato;
VI.4	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet;
VI.6	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjëres rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj;
VI.7	Identifikon dy e më shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

### Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.3	Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe bashkësisë nga padrejtësitë;
2.1	Identifikon ngjarje shoqërore, kulturore e historike të nivelit lokal, vendor, kombëtar e më gjerë dhe shkaqet që sollën ato;
2.2	Kupton rëndësinë e objekteve, dukurive dhe proceseve shoqërore, natyrore e mjedisore në nivel lokal, vendi, regional dhe botëror;
2.3	Tregon respekt për trashëgiminë kulturore e natyrore, si dhe shpreh solidaritet në proceset shoqërore ku ai është i përfshirë.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<b>Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dallon llojllojshmërinë në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe tregon mirëkuptim dhe respekt ndaj të tjerëve ndryshe.</li> <li>- Tregon shembuj konkretë të aktiviteteve shkollore (shënime të ditëve të veçanta, koncerte, shfaqje, gara, gjelbërimin e mjedisit etj.) dhe përshkruan mënyrën e planifikimit të tyre.</li> <li>- Merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve në klasë dhe në shkollë dhe kontribuon në mënyrë kreative në realizimin e tyre. Planifikon me bashkëmohatarët aktivitete të ndryshme, duke përcaktuar përbërjen dhe rolin e secilit anëtar pjesëmarrës.</li> <li>- Identifikon të drejtat themelore në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato.</li> <li>- Dallon raste të shkeljes së të drejtave të femijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (cenimi i shprehjes së lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.).</li> <li>- Dallon përgjegjësitë e veta, të anëtarëve të familjes, të bashkësisë, të shkollës dhe argumenton rëndësinë e zbatimit të tyre për të mirën e përgjithshme.</li> <li>- Identifikon disa nga ngjarjet që organizohen në shkollë dhe në rrethin e tij dhe shpjegon arsyet e manifestimeve të tyre.</li> </ul>	<p>14. Të drejtat dhe përgjegjësitë</p> <p>15. Unë kam të drejta në familje</p> <p>16. Të drejtat e mia në shkollë</p> <p>17. Përgjegjësitë në komunitet</p> <p>18. Stop dhunës në familje!</p> <p>19. Stop dhunës në shkollë!</p> <p>20. Shkolla ime</p> <p>21. Festojmë së bashku</p> <p>22. Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tim</p> <p>23. Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme</p> <p>24. Ruajmë traditat tona</p> <p>25. Mjedisit ku jetoj</p>	12	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia e të nxënimit të diferencuar</li> <li>- Mësimdhënia e të nxënimit të integruar</li> <li>- Metodat: Bashkëbisedimi; Ilustrimi dhe demonstrimi</li> <li>- Teknikat: Listë kontrolli</li> <li>- Stuhi mendimesh; Dramatizim me role; Rrjet diskutimi.</li> <li>- Format e punës: Individuale; Në grupe; Në çifte.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi formativ</li> <li>- Vlerësimi i të nxënimit</li> <li>- Informata kthyesë</li> <li>- Listë kontrolli</li> <li>- Portfolio</li> </ul>	<p>Gjuhë shqipe</p> <p>Matematikë</p> <p>Njeriu dhe natyra</p> <p>Shkathësi për jetë</p> <p>Edukatë figurative</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare:</p> <p>Edukimi për qytetari demokratike</p> <p>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</p>	<p>“Shoqëria dhe mjedisi 3”</p> <p>“Shoqëria dhe mjedisi 3”, fletore pune</p>
<b>Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim</b>							

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndiërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p><b>Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme</b></p> <p><b>Raporti njeri- natyrë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Atdheu është vendi ku kemi lindur ne dhe të afërmit tanë.</li> <li>- Kudo që të jetojmë ne, duhet të mos e harrojmë gjuhën tonë, traditat e zakonet tona.</li> <li>- Njerëzit nuk jetojnë të gjithë në të njëjtin vend.</li> <li>- Zakonet dhe traditat zënë vend të rëndësishëm në historinë e një populli.</li> <li>- Njerëzit kanë kultura të ndryshme, varësisht nga vendi se ku jetojnë.</li> </ul>						

# PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

## Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

**Fusha e kurrikulës:** Shoqëria dhe mjedisi

**Temat mësimore:** Raporti njeri-naturë  
Llojlojshmëria e shoqërisë  
Së bashku dhe të barabartë  
Konsultohemi së bashku dhe vendosim

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv</i>	
I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje, pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërin nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;
I.5	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore, historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyrë/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj;
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.;
IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes;
IV.5	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë/laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.

### Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësëndeve personale) dhe të higjienës së mjedisit ku jeton dhe vepron përmes formave të ndryshme të shprehjes;
V.6	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal, duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

### Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni;
VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.3	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato;
VI.4	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet;
VI.5	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre;
VI.7	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët;
VI.8	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet - mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.



**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:**

2.1	Identifikon ngjarje shoqërore, kulturore e historike të nivelit lokal, vendor, kombëtar e më gjerë dhe shkaqet që sollën ato;
2.2	Kupton rëndësinë e objekteve, dukurive dhe proceseve shoqërore, natyrore e mjedisore në nivel lokal, vendi, regjional dhe botëror;
2.3	Tregon respekt për trashëgiminë kulturore e natyrore, si dhe shpreh solidaritet në proceset shoqërore ku ai është i përfshirë;
3.1	Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet;
3.2	Tregon ndërgjegjshmëri për dallimet gjinore, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demonstroi tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët;
4.1	Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet t`i marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme;
4.2	Kupton nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucione dhe shoqëri, dikur dhe tani, dhe i respekton ato në veprimet e tij.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimit	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<b>Raporti njeri-natyrë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon objekte dhe dukuri natyrore (lumi, liqeni, fusha, kodra, mali, era, etj.), të cilat kanë shërbyer dhe i shërbejnë njeriut për udhëtim, për ushqim, për energji etj.</li> <li>- Përkrauan veprimet e njeriut për transformimin e vazhdueshëm të natyrës (hapja e tokës, çelja e kanaleve plleshmërisë së tokës, çelja e kanaleve për ujë dhe lundrim, akumulimi i ujit, i liqeneve artificiale, ndërtimi i rrugëve, urave etj.) dhe identifikon disa nga këto transformime në vendbanimin e tij.</li> <li>- Dallon anët negative të ndërhyrjes së njeriut në natyrë (ndotja e mjedisit, shpyllëzimi, erozioni, dëmtimi i florës dhe i faunës etj.) dhe përshkruan disa nga këto dukuri në vendbanimin e vet.</li> <li>- Shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë dhe shfaq përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit, tokës dhe ajrit).</li> <li>- Dallon llojllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare në mjedisin e tij shoqëror (familje, shkollë, komunitet) dhe shpjegon thjesht këto dallime.</li> <li>- Identifikon profesione të ndryshme (mësues, mjek, artist, polic, murator, bujk etj.) dhe arsyeton këtë llojllojshmëri veprimtarie.</li> </ul>	<p>26. Pasuritë natyrore të vendit tim</p> <p>27. Njeriu e ndryshon natyrën</p> <p>28. Ndotja e mjedisit</p> <p>29. Kujdesem për bimët dhe për kafshët</p> <p>30. Uji është jetë</p> <p>31. Rëndësia e ujit për jetën e njeriut</p> <p>32. Toka dhe ajri</p> <p>33. Diversiteti (llojllojshmëria) etnik e ai kulturor</p> <p>34. Jetojmë së bashku me tolerancë e dashuri</p> <p>35. Profesionet tona</p> <p>36. Të ndryshëm, por të barabartë</p> <p>37. Të punojmë së bashku</p> <p>38. Unë dhe ti - të barabartë</p> <p>39. Vendosim së bashku në familje</p> <p>40. Vendosim së bashku në shkollë</p> <p>41. Vendimmarrja në komunitet</p> <p>42. Respektojmë mendimin ndryshe</p> <p>43. Si të marr një vendim të drejtë</p>	18	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia e të nxënësve të diferencuar</li> <li>- Mësimdhënia e të nxënësve të integruar</li> <li>Metodat: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëbisedimi;</li> <li>- Ilustrimi dhe demonstrimi</li> </ul> </li> <li>Teknikat: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Stuhi mendimesh;</li> <li>2. Dramatizim me role;</li> <li>3. Rrjet diskutimi</li> </ol> </li> <li>Format e punës: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Individuale;</li> <li>2. Në grupe;</li> <li>3. Në çifte.</li> </ol> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi formativ</li> <li>- Vlerësimi i të nxënësve</li> <li>- Informata këthuese</li> <li>- Listë kontrolli</li> <li>- Portfolio</li> </ul>	<p>Gjuha shqipe</p> <p>Matematikë</p> <p>Njeriu dhe natyra</p> <p>Shkathësi për jetë</p> <p>Edukatë figurative</p> <p>Çështjet ndërkurrikulare:</p> <p>Edukimi për qytetari demokratike</p> <p>Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</p>	<p>“Shoqëria dhe mjedisi 3”</p> <p>“Shoqëria dhe mjedisi 3”, fletore pune</p> <p>Interneti dhe burimet e tjera</p>
<b>Llojllojshmëri në shoqëri</b>							
<b>Së bashku dhe të barabartë</b>							

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndiërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p><b>Konsultohemi së bashku dhe vendosim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Demonstron mirëkuptim dhe solidaritet midis të ndryshmeve (në aspektin gjinor) dhe angazhohet për trajtim të barabartë mes tyre.</li> <li>- Demonstron gatishmëri për bashkëpunim gjinor (djalë, vajzë) në aktivitete grupore (lojë, detyra, gara etj.).</li> <li>- Vlerëson komunikimin (në familje, në grup dhe në shkollë) si element të përbashkët pozitiv për vendimmarrje të qëndrueshme.</li> <li>- Diskuton me të tjerët përvoja të ndryshme, para se të marrë vendime për situata nga jeta e përditshme.</li> <li>- Gjykon se mendimet e ndryshme midis shokëve e shoqeve janë përparësi dhe jo pengesë për vendimmarrje të drejtë.</li> <li>- Trajton vendimin e të tjerëve dhe vlerëson në mënyrë objektive (pa anime, tendenca) atë vendim.</li> </ul>							Burimet

# PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

## Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi

**Fusha e kurrikulës:** Shoqëria dhe mjedisi

**Klasa:** III

**Temat mësimore:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre  
Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim

### Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

I.1	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë;
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje, pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.4	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

### Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.3	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore-historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një probleme/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimi) të tyre.

### Kompetenca e të nxëniet – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme);
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj;
III.9	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.3	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.;
IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
IV.5	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë/laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.6	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal, duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit;
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.3	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga to;
VI.4	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet;
VI.5	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre;
VI.6	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërit rregull të propozuar në formë të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellit të temës/temave:	
4.1	Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet të i marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme;
4.2	Kupton nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucione dhe shoqëri, dikur dhe tani, dhe i respekton ato në veprimet e tij;
5.1	Shpjegon disa nga shkaqet dhe pasojat e rreziqeve natyrore e shoqërore, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe veprimeve të njeriut, dhe merr pjesë në aktivitete për ruajtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë;
5.2	Bashkëpunon me të tjerët dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër, kujdeset për përdorim të drejtë të të mirave jetësore për higjienën e përgjithshme dhe për atë personale.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
-	- Demonstron mirëkuptim dhe solidaritet midis të ndryshmeve (në aspektin gjinor) dhe angazhohet për trajtim të barabartë mes tyre; - Demonstron gatishmëri për bashkëpunim gjinor (djalë, vajzë) në aktivitetet grupore (lojë, detyra, gara etj.); - Vlerëson komunikimin (në familje, në grup dhe në shkollë) si element të përbashkët pozitiv për vendimmarrje të qëndrueshme; - Diskuton me të tjerët përvoja të ndryshme, para se të marrë vendime për situata nga jeta e përditshme; - Gjykon se mendimet e ndryshme midis shokëve e shoqeve janë përparësi dhe jo pengesë për vendimmarrje të drejtë; - Trajton vëllimin e të tjerëve dhe vlerëson në mënyrë objektive (pa anime, tendenca) atë vendim.	44. Pasuritë natyrore 45. Pasuritë nëntokësore 46. Trashëgimia e profesioneve 47. Ta kursejmë energjinë 48. Riciklimi i mbetjeve 49. Aktivitet: Ta mbrojmë mjedisin ku jetojmë 50. Njeriu dhe mjedisi natyror 51. Njeriu dhe mjedisi kulturor 52. Një mjedis i pastër për të gjithë 53. Hìgjiena në komunitetit	10	- Mësimdhënia e të nxënit të diferencuar - Mësimdhënia e të nxënit të integruar Metodat: - Bashkëbisedimi; - Ilustrimi dhe demonstrimi. Teknikat: 1. Stuhi mendimesh; 2. Dramatizim me role; 3. Rrjet diskutimi. Format e punës: 1. Individuale; 2. Në grupe; 3. Në çifte.	Gjuha shqipe Matematikë Njeriu dhe natyra Shkathësi për jetë Edukatë figurative Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	“Shoqëria dhe mjedisi 3” “Shoqëria dhe mjedisi 3” fletore pune
<b>Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre</b>	- Dallon pasuritë natyrore (tokësore dhe nëntokësore, si: xehet, ujërat, toka e punueshme etj.) dhe humane (trashëgimia kulturore, artsimimi, profesionet etj.). Ndërlidh llojin e pasurive natyrore dhe humane me vendbanimin (lokalitetin, rrethin) e tij/saj.					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e mësimdhënies	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<b>Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezanton shembuj të shfrytëzimit racional të pasurive në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm (si përdorimi racional i ujit, i energjisë elektrike, drurëve, riciklimi i mbetjeve të ndryshme etj.) dhe tregon se mbrojtja e tyre nuk do të thotë mosshfrytëzim.</li> <li>- Përshkruan të veçantat e mjedisit natyror dhe kulturor (p.sh., bimët, kafshët, malet, fushat, vendbanimet, fabrikat, rrugët, etj.), karakteristikë e vendit ku jeton, që tërheqin vëmendjen e vizitorëve.</li> <li>- Tregon se njeriu është përgjegjës për përkujdesjen, mirëmbajtjen e mjedisit dhe shkakton kryesor i ndotjes së tij.</li> <li>- Demonstron veprime konkrete (në klasë, në shtëpi apo rrethinë) për një ambient dhe mjedis të qëndrueshëm.</li> </ul>						

# Mësimi 1

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve në klasë dhe shkollë dhe kontribuon në mënyrë kreative në realizimin e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Mirë se erdhe në klasën e tretë

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Prezanton veten e tij/saj;
- Tregon ndryshimet e tij/saj gjatë viteve;
- Bisedon për dallimet nga klasa e parë deri në klasën e tretë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë e bardhë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, shkencat e natyrës, jeta dhe puna, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**


**Përgatitja për të nxënësit**

Zhvillohet një aktivitet me anë të të cilit nxënësit do të rikujtojnë se si është dukur tjetri në klasën e dytë, për një minutë. Secilit nxënës i vendoset nga një letër në shpinë dhe shkruan një fjalë që i kujtohet për shokun ose shoqen e klasës, pa shkruar asnjë emër. Pasi të përfundojë koha, të gjithë ulen në rreth dhe lexojnë letrat që i kanë në shpinë dhe komentohen ato nga vetë nxënësit, po ashtu edhe ndryshimet e tyre nga klasa e dytë.




### I. Unë, klasa dhe shkolla ime Mirë se erdhe në klasën e tretë!

**Situata 1.** Ana dhe Mati po rriten. Këtë vit ata kanë dalë në klasën e tretë. Në ditën e parë të shkollës, mësuesi/ja u kërkoi atyre që të tregonin për ndryshimet e tyre nga klasa e parë e deri tani.



Unë jam Ana.  
Në klasën e parë isha 6 vjeçe.  
Isha e gjatë 120 cm.  
Kisha flokë të shkurtër.  
Nuk dija të shkruaja.  
Kisha frikë të shkoja te dentisti.

Në klasën e tretë jam 8 vjeçe.  
Tani jam e gjatë 130 cm.  
Kam flokë të gjatë.  
Di të shkruaj pa gabime.  
Tani shkoj me kënaqësi te dentisti.



Unë jam Mati.  
Në klasën e parë isha 7 vjeç.  
Peshoja 20 kg.  
Lodra ime më e pëlqyer ishte topi.  
Nuk dija të lexoja.  
Kisha frikë ta kaloja rrugën e vetëm.

Në klasën e tretë jam 9 vjeç.  
Peshoj 30 kg.  
Lodra ime më e pëlqyer vazhdon të mbetet topi, por më tërheqin shumë edhe lojërat kompjuterike.  
Di të lexoj dhe ta shpjegoj atë që e kam lexuar.  
Tani rrugën e kaloj i vetëm, sepse i njoh rregullat e trafikut.



- Bisedoni me njëri-tjetrin për ndryshimet tuaja nga klasa e parë në klasën e tretë.
- Diskutoni për gjërat që ju kanë pëlqyer atëherë dhe tash. A kanë ndryshuar ato?



Tani kemi filluar klasën e tretë. Që të jemi nxënës të mirë, duhet të jemi të përgjegjshëm për kryerjen e detyrave tona. Mirëpo, duhet të mendojmë edhe për një jetë të shëndetshme. Për këtë na ndihmojnë disa rregulla të përgjithshme, si: të flemë 8 orë në ditë, të ushqehemi shëndetshëm, të kujdesemi për higjienën personale, të bëjmë ushtrime trupore dhe aktivitete sportive, ta mbajmë trupin drejt kur qëndrojmë ulur, ta bëjmë përshtatjen e veshjeve sipas stinës. Për të pasur sukses, na nevojitet një planifikim i mirë ditor.



**Fjalët kyçe:** përgjegjësi, rregull, shëndet.





## I. Unë, klasa dhe shkolla ime Mirë se erdhe në klasën e tretë!

**Situata 1.** Ana dhe Mati po rriten. Këtë vit ata kanë dalë në klasën e tretë. Në ditën e parë të shkollës, mësuesi/ja u kërkoi atyre që të tregonin për ndryshimet e tyre nga klasa e parë e deri tani.



Unë jam Ana.  
Në klasën e parë isha 6 vjeçe.  
Isha e gjatë 120 cm.  
Kisha flokë të shkurtër.  
Nuk dija të shkruaja.  
Kisha frikë të shkoja te dentisti.

Në klasën e tretë jam 8 vjeçe.  
Tani jam e gjatë 130 cm.  
Kam flokë të gjatë.  
Di të shkruaj pa gabime.  
Tani shkoj me kënaqësi te dentisti.



Unë jam Mati.  
Në klasën e parë isha 7 vjeç.  
Peshoja 20 kg.  
Lodra ime më e pëlqyer ishte topi.  
Nuk dija të lexoja.  
Kisha frikë ta kaloja rrugën  
i vetëm.

Në klasën e tretë jam 9 vjeç.  
Peshoj 30 kg.  
Lodra ime më e pëlqyer vazhdon të mbetet topi, por më tërheqin shumë edhe lojërat kompjuterike.  
Di të lexoj dhe ta shpjegoj atë që e kam lexuar.  
Tani rrugën e kaloj i vetëm, sepse i njoh rregullat e trafikut.



- Bisedoni me njëri-tjetrin për ndryshimet tuaja nga klasa e parë në klasën e tretë.
- Diskutoni për gjërat që ju kanë pëlqyer atëherë dhe tash. A kanë ndryshuar ato?



Tani keni filluar klasën e tretë. Që të jeni nxënës të mirë, duhet të jeni të përgjegjshëm për kryerjen e detyrave tuaja. Mirëpo, duhet të mendojmë edhe për një fletë të shëndetshme. Për këtë na ndihmojnë disa rregulla të përgjithshme, si: të flemë 8 orë në ditë, të ushqehemi shëndetshëm, të kujdesemi për higjienën personale, të bëjmë ushtrime trupore dhe aktivitete sportive, ta mbajmë trupin drejt kur qëndrojmë ulur, ta bëjmë përshtatjen e veshjeve sipas stinës. Për të pasur sukses, na nevojitet një planifikim i mirë ditor.



**Fjalët kyçe:** përgjegjësi, rregull, shëndet.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Pasi të lexohet pjesa e shkruar në libër, diskutoni për Anën dhe Matin, po ashtu edhe për ndryshimet e tyre nga klasa e parë. Dy nxënës përshkruajnë veten dhe ndryshimet që ata i kanë pësuar nga klasa e parë.

Përgjigjen në pyetjet që janë në libër, po ashtu bëhet komentimi i pjesës në fund të mësimit dhe komentojnë për rregullat dhe zhvillimin e rutinës së tyre ditore.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Në tabelë shkruhen fjalët kyçe: përgjegjësi, rregull, shëndet.

Nxënësve u shpërndahet nga një fletë, në të cilën kanë për detyrë që të shkruajnë nga një ese me fjalët kyçe që janë të shënuara në tabelë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për prezantimin, ndryshimet nga klasa e parë deri në klasën e tretë.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon llojllojshmërinë në klasë, shkollë dhe shoqëri dhe tregon mirëkuptim dhe respekt ndaj të tjerëve.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Jetojmë së bashku

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan shoqen/shokun e klasës me fjalët e dhëna;
- Analizon rastet e paraqitura në foto;
- Vlerëson rëndësinë që ka ndihma dhe mirëkuptimi brenda grupit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Parashikim me terma paraprakë

Shkruhen në tabelë fjalët: solidaritet, mirëkuptim, shoqe, shok, cilësi individuale. Disa nga nxënësit do të përshkruajnë një shoqe/shok dhe disa të tjerë do të përshkruajnë vetëm me fjalë për pesë minuta njërin nga shoqet/shokët.

**Jetojmë së bashku**

Mua më pëlqen të lexoj libra.

Të gjithë jemi shoqe/shokë të një klase.

ua më pëlqen luaj në piano.

Argëtohemi së bashku në kohën e lirë.

? - A të kujtohet dita e parë e shkollës?  
- Sa prej shoqeve/shokëve i njihje që më parë?  
- Çfarë kujtimesh ruan për ta?  
- A kishë shokë të rinj në klasë?  
- Çfarë prisje ti prej shokëve të rinj?


**Situata 1.** Leka erdhi në bankën time. Ai kishte vënë syze, pasi mjeku e kishte këshilluar për një gjë të tillë. Të gjithë ishin dakord që ai duhej të ulej në bankën e parë. Ky quhet solidaritet. Secili nga anëtarët e grupit duhet të ndihmojë shoqet/shokët në rast nevojë.

? - Si silleni ju me njëri-tjetrin në klasë? Çfarë raportesh keni ju?  
- Si i zgjidhni ju mosmarrëveshjet?  
- Merrni shembuj që tregojnë se toleranca e bashkëpunimi janë shumë të rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve.

Anëtarët e grupit duhet të kenë marrëdhënie të mira mes vete. Në grup, secili anëtar i paraqet afërsitë e tij. Anëtarët e grupit duhet të kenë mirëkuptim, bashkëpunim, si dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin gjatë punës në grup.

Fjalët kyçe: individ, individualitet, marrëdhënie, solidaritet, tolerancë, zgjidhje.

7

Jetojmë së bashku 



Mua më pëlqen të lexoj libra.

Të gjithë jemi shoqe/shokë të një klase.

Mua më pëlqen të luaj në piano.

Argëtohem i së bashku në kohën e lirë.

**?**

- A të kujtohet dita e parë e shkollës?
- Sa prej shoqeve/shokëve i njihje që më parë?
- Çfarë kujtimesh ruan për ta?
- A kishe shokë të rinj në klasë?
- Çfarë prisje ti prej shokëve të rinj?

**Situata 1.** Leka erdhi në bankën time. Ai kishte vënë syze, pasi mjeku e kishte këshilluar për një gjë të tillë. Të gjithë ishin dakord që ai duhej të ulej në bankën e parë. Ky quhet solidaritet. Secili nga anëtarët e grupit duhet të ndihmojë shoqet/shokët në rast nevoje.

**?**

- Si silleni ju me njëri-tjetrin në klasë? Çfarë raportesh keni ju?
- Si i zgjidhni ju mosmarrëveshjet?
- Merrni shembuj që tregojnë se toleranca e bashkëpunimi janë shumë të rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve.

 Anëtarët e grupit duhet të kenë marrëdhënie të mira mes vete. Në grup, secili anëtar i paraqet aftësitë e tij. Anëtarët e grupit duhet të kenë mirëkuptim, bashkëpunim, si dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin gjatë punës në grup.

**Fjalët kyçe:** individ, individualitet, marrëdhënie, solidaritet, tolerancë, zgjidhje.

**7**



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
 Bashkëbisedim

Prezantohen në klasë disa fotografi të ndryshme të argëtimit dhe veprimeve të fëmijëve, diskutohet lidhur me këto veprimtari. Hapen librat dhe parashtrihen pyetjet nga libri dhe diskutohet për ditën e parë të shkollës dhe kujtimet e tyre nga klasa e parë. Lexohet situata e parashtruar në libër, informacioni i dhënë dhe pyetjet lidhur me këto veprime.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
 Shkrim i lirë

Sqarohet kuptimi i fjalës solidaritet dhe formojnë një pesëvargësh me këtë fjalë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për diskutimin e dhënë në libër, analizën e rastit në libër dhe formimin e pesëvargëshit.

**Detyrë:**

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon llojllojshmërinë në klasë, shkollë dhe shoqëri dhe tregon mirëkuptim dhe respekt ndaj të tjerëve.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Grupet shoqërore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan si është i ndërtuar grupi shoqëror;
- Analizon rastet e paraqitura në foto;
- Vlerëson rëndësinë që kanë respektimi i të drejtave dhe përgjegjësitë në grup.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografji të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**


**Përgatitja për të nxënë**

Stuhi mendimesh

Në mes të tabelës, shkruhet “Grupet shoqërore” dhe përreth shkruhen mendimet e fëmijëve se çfarë dinë për grupet shoqërore.




Grupet shoqërore



- Analizoni figurat e dhëna dhe identifikoni grupet shoqërore te secila.
- Diskutoni së bashku për secilin prej tyre.
- A bëni pjesë ju në ndonjërin prej tyre?

**Situata 1.** Në klasën tonë erdhën dy nxënës të rinj, Rrezja dhe Flori. Mësuesja i prezantoi dhe na këshilloi që t'u qëndronim pranë. Në orën e edukatës fizike ne morëm vesh se Flori ishte shahist i zoti, ndërsa Rrezja basketbolliste shumë e mirë. Mati na tha se mund ta formonte grupin e shahut. Më pëlqeu mendimi i tij dhe vendosa që edhe vetë të formoja një grup...



- Si mund ta ndihmoni shoqen/shokun që të formojë një grup?
- Kë do të doje ti ta kishe në grupin tënd?
- Analizo pse është mirë që të punojmë në grup.
- Në cilat grupe bën pjesë ti? Diskuto për to.




*Të gjithë anëtarët e grupit kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Zakonisht, grupet shoqërore kanë udhëheqësit e tyre. Një njeri mund të jetë anëtar në disa grupe shoqërore në të njëjtën kohë.*



**Fjalët kyçe:** individ, grup, anëtar, mirëkuptim, grup shoqëror.




## Grupet shoqërore



- Analizoni figurat e dhëna dhe identifikoni grupet shoqërore të secila.
- Diskutoni së bashku për secilin prej tyre.
- A bëni pjesë ju në ndonjërin prej tyre?

**Situata 1.** Në klasën tonë erdhën dy nxënës të rinj, Rrezja dhe Flori. Mësuesja i prezantoi dhe na këshilloi që t'u qëndronim pranë. Në orën e edukatës fizike ne morëm vesh se Flori ishte shahist i zoti, ndërsa Rrezja basketbolliste shumë e mirë. Mati na tha se mund ta formonte grupin e shahut. Më pëlqeu mendimi i tij dhe vendosa që edhe vetë të formoja një grup...



- Si mund ta ndihmoni shoqen/ shokun që të formojë një grup?
- Kë do të doje ti ta kishe në grupin tënd?
- Analizo pse është mirë që të punojmë në grup.
- Në cilat grupe bën pjesë ti? Diskuto për to.



Të gjithë anëtarët e grupit kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Zakonisht, grupet shoqërore kanë udhëheqësit e tyre. Një njeri mund të jetë anëtar në disa grupe shoqërore në të njëjtën kohë.



**Fjalët kyçe:** individ, grup, anëtar, mirëkuptim, grup shoqëror.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Tryeza rrethore

Në tabelë, vendosen disa fotografi me nxënës që janë duke kryer aktivitete të ndryshme. Disa nga nxënësit i komentojnë fotografitë, duke e vazhduar fjalën e shokut.

Lexohet situata e dhënë në libër dhe vazhdohet me pyetjet që janë në pjesën në vazhdim dhe diskutohet edhe situata e dhënë.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Shkruajnë në fletore nga një ese me fjalët e dhëna, si p.sh.: individ, grup, mirëkuptim, grup shoqëror. Lexohen shkrimet e bëra.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për situatat e dhëna në libër, për përshkrimin e grupeve shoqërore dhe për shkrimin e eseve.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Përshkruan grupet shoqërore ku bën pjesë (në familje, në klasë, në shkollë etj.) dhe dallon përbërjen e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Unë dhe shkolla

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Përshkruan shkollën si një familje e madhe;
- Përmend rregullat që duhen respektuar mes anëtarëve të ndryshëm;
- Vlerëson rëndësinë që ka respektimi i mendimit të secilit anëtar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografia.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënës**

Tryeza rrethore

Lexohet situata e dhënë në libër. Kërkoheq që nxënësit të vazhdojnë situatën e dhënë dhe të shprehin mendimin e tyre për fotografitë e dhëna dhe në cilin grup bëjnë pjesë ata. Më pas, do të arsyetojnë pse mendojnë që janë në atë grup.

Unë dhe shkolla



**Situata 1.** Pas mësimi, mësuesja na tha se do të diskutonim për diçka shumë të rëndësishme. Të gjithë ishim kureshtarë të dinim se për çfarë bëhej fjalë. Ajo filloi të fliste shumë qetë: "Le të diskutojmë së bashku se pjesë e cilit grup do të donim të ishit. Rëndësi ka që ju të ndiheni mirë". E para filloi Ana.


- Unë, - tha ajo,...



- Vazhdoje mendimin e Anës.
- Po ti, në cilin grup bën pjesë?
- Në cilat grupe shoqërore do të doje të bëje pjesë në të ardhmen? Trego pse.



Grupet shoqërore



- Shikoj ilustrimet e mësipërme dhe trego se për cilat grupe bëhet fjalë.
- Cfarë bën secili prej grupeve?
- Cfarë përgjegjësis kanë anëtarët e një grupi?
- Lidh me shigjetë grupin në të cilin ti bën pjesë.
- A të pëlqen ta drejtosh një grup? Pse?
- A janë të nevojshme rregullat në shkollë? Pse?



Shkolla është vendi në të cilin fëmijët mësojnë, edukohen dhe zhvillohen. Në shkollë mund të ketë pak ose shumë klase me nxënës. Nxënësit e një klase formojnë një grup. Por, ata mund të formojnë edhe grupe të tjera. Disa bëjnë pjesë në grupin artistik, disa në grupin e shahut, të tjerë në grupin sportiv etj. Anëtarët e një grupi kryejnë veprimtari të përbashkëta dhe secili prej tyre ka të drejtat dhe përgjegjësitë e veta në raport me grupin. Në grup duhet të respektohet mendimi i secilit prej anëtarëve. Zbatimi i rregullave është detyrim i të gjithëve dhe është kusht për funksionimin dhe mbajtjen e rendit. Mbaj mend! Rregullat duhen zbatuar nga të gjithë nxënësit njësoj.


**Fjalët kyçe:** grup shoqëror, anëtar, drejtues grupi, marrëdhënie, rregull.

9



**Situata 1.** Pas mësimit, mësuesja na tha se do të diskutonin për diçka shumë të rëndësishme. Të gjithë ishim kureshtarë të dinim se për çfarë bëhej fjalë. Ajo filloi të fliste shumë qetë: "Le të diskutojmë së bashku se pjesë e cilit grup do të donit të ishit. Rëndësi ka që ju të ndiheni mirë". E para filloi Ana.  
- Unë, - tha ajo,...

- ? - Vazhdo mendimin e Anës.  
- Po ti, në cilin grup bën pjesë?  
- Në cilat grupe shoqërore do të doje të bëje pjesë në të ardhmen?  
Trego pse.



- ? - Shikoj ilustrimet e mësipërme dhe trego se për cilat grupe bëhet fjalë.  
- Çfarë bën secili prej grupeve?  
- Çfarë përgjegjësisish kanë anëtarët e një grupi?  
- Lidh me shigjetë grupin në të cilin ti bën pjesë.  
- A të pëlqen ta drejtosh një grup? Pse?  
- A janë të nevojshme rregullat në shkollë? Pse?



*Shkolla është vendi në të cilin fëmijët mësojnë, edukohen dhe zhvillohen. Në shkollë mund të ketë pak ose shumë klase me nxënës. Nxënësit e një klase formojnë një grup. Por, ata mund të formojnë edhe grupe të tjera. Disa bëjnë pjesë në grupin artistik, disa në grupin e shalut, të tjerë në grupin sportiv etj. Anëtarët e një grupi kryejnë veprimtari të përbashkëta dhe secili prej tyre ka të drejtat dhe përgjegjësitë e veta në raport me grupin. Në grup duhet të respektohet mendimi i secilit prej anëtarëve. Zbatimi i rregullave është detyrim i të gjithëve dhe është kusht për funksionimin dhe mbajtjen e rendit. Mbaj mend! Rregullat duhen zbatuar nga të gjithë nxënësit njësoj.*

**Fjalët kyçe:** grup shoqëror, anëtar, drejtues grupi, marrëdhënie, rregull.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Punë në grupe

Nxënësit, ashtu të ndarë në grupe, do të zgjedhin një aktivitet, do ta ilustronin në hamer dhe do të shkruajnë çfarë dinë për aktivitetin e zgjedhur. Respektojnë rregullat që duhet të zbatohen gjatë punës në grup në mes të anëtarëve të grupit, gjithmonë duke u munduar që t'i përgjigjen edhe pyetjeve të parashtruara në libër.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Në një fletë të bardhë do të shkruajnë disa rregulla që duhet të zbatohen gjatë punës në grup. Pasi të përfundojnë shkrimet, do të shkruhen dhe do të radhiten rregullat e shkruara nga nxënësit.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e shkollës si një familje dhe rregullat që duhen zbatuar në grup.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan grupet shoqërore ku bën pjesë (në familje, në klasë, në shkollë etj.) dhe dallon përbërjen e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Unë dhe të tjerët

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan sjelljet në vende të ndryshme;
- Numëron detyrimet që ne kemi në komunitet;
- Vlerëson rëndësinë që kanë respektimi i rregullave dhe përgjegjësitë në grup.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografi të ndryshme nëpërmjet projektorit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

Stuhi mendimesh

Përmes projektorit do të paraqiten katër pamje të ndryshme me situata të përshtatura si në libër.



### Unë dhe të tjerët

Mami u kthye nga puna, por nuk u ul si zakonisht në kolltuk. Ajo më tha që të bëhesha gati se do të dilnim.

- Ku do të shkojmë, - i thashë unë.

- Do të marrim pjesë në aktivitetin që po organizojnë banorët e lagjes për pastrimin e mjedisit.

- Po çfarë do të bëj unë aty? - pyeti Joni.



Ndihmoje Jonin duke i treguar se çfarë pune mund të bëjë ai. Vazhdoje situatën e dhënë.

- Çfarë po organizonin banorët e lagjes?

- Pse ishte i shqetësuar Joni?

- Si do ta ndihmonit ju Jonin?

- Po ju, a keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet në lagjen tuaj?

10





- ?
- Çfarë vëreni në figurat e mësipërme?
  - Flisni për ndihmën e dhënë në secilin rast.
  - Po ju, a e keni dhënë ndihmën tuaj në komunitetin ku jetoni?
  - Flisni rreth kontributit tuaj të dhënë.

Të gjithë njerëzit duhet të kontribuojnë në komunitetin ku jetojnë, përfshirë edhe fëmijët. Ata mund të ndihmojnë më të vegjlit dhe më të mëdhenjtë në rast nevojë. Po ashtu, fëmijët mund të kontribuojnë për një mjedis më të pastër në komunitet. Ata e ndiejnë veten si pjesë e rëndësishme e komunitetit, prandaj japin mbështetjen duke marrë përgjegjësitë e tyre.

**Fjalët kyçe:** grup shoqëror, kontribut, komunitet, ndihmë.

11





## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA

Lexohen me ndalesa situatat e dhëna në libër dhe, pas çdo pjese, do të parashtrihen pyetje se çfarë ndodhi dhe çfarë mendoni se do të ndodhë, po ashtu vazhdohet edhe me pyetjet që janë në libër, të cilat i bashkëngjiten mësimi.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Në klasë, do të shkruajnë në grupe nga tri thënie që vlejnë për kontributin, ndihmën dhe respektin. Punimet e bëra do të vendosen në këndin e shkrimeve në klasë.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, përshkrimin e kontributit në komunitet dhe për bashkëpunimin në grup.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

# Mësimi 6

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve në klasë dhe shkollë dhe kontribuon në mënyrë kreative në realizimin e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Respektojmë njëri-tjetrin

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan rregullat që duhet të respektohen në shoqëri;
- Përmend karakteristikat që duhet të ketë brenda grupit për mirëkuptim;
- Vlerëson rëndësinë që ka hartimi i rregullave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografji, fletë e bardhë.

### Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



### Parashikimi:

### Përgatitja për të nxënësit

Punë në grupe

Për secilin grup do të ndahet nga një fotografi me pamje të ndryshme. Detyrë e nxënësve është që të formojnë një përshkrim në formë të një drame, për 10 minuta.

Pasi të përfundojnë, do të shohim a i janë përmbajtur detyrave të dhëna dhe mënyrën se si i kanë realizuar.

## Respektojmë njëri-tjetrin



Nxënës që respekton të moshuarit në autobus.




Nxënës që flasin pa leje.




Nxënës që mësojnë së bashku.



Nxënës që ndihmojnë njëri-tjetrin.



Nxënës që zihen.



Nxënës që nuk respekton të moshuarit.



- Çfarë shikoni në figurat e mësipërme?
- Në cilat raste tregohet respekt ndaj të tjerëve e në cilat jo?
- A i zbatoni gjithmonë rregullat?
- A ka raste kur ju nuk doni t'i zbatoni ato? Nëse po, në cilat raste?



Klasat nëpër shkollë përbëhen nga nxënës, të cilët nuk dallohen vetëm në dukje, por edhe në botëkuptime, qëndrime, shprehje, dëshira, nevoja etj. Për shkak se nxënësit janë të ndryshëm dhe dallojnë nga njëri-tjetri, atyre u duhet që t'u binden rregullave, me të cilat u mundësohet jeta e përbashkët nëpër shkollë. Disa prej atyre rregullave janë të vendosura nga institucionet shtetërore, si p.sh., komuna, ndërsa disa të tjera mund të krijohen ndërkohë me pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Në qoftë se dikush nuk pajtohet me ndonjë rregull, atëherë mospajtimin duhet diskutuar me shokët dhe shoqet e klasës dhe me mësuesin/en.



**Fjalët kyçe:** pjesëmarrje, respektim i rregullave, bashkëpunim, zbatim.



## Respektojmë njëri-tjetrin



Nxënës që respekton të moshuarit në autobus.




Nxënës që flasin pa leje.



Nxënës që mësojnë së bashku.



Nxënës që ndihmojnë njëri-tjetrin.



Nxënës që zihen.



Nxënës që nuk respekton të moshuarit.



- Çfarë shikoni në figurat e mësipërme?
- Në cilat raste tregohet respekt ndaj të tjerëve e në cilat jo?
- A i zbatoni gjithmonë rregullat?
- A ka raste kur ju nuk doni t'i zbatoni ato? Nëse po, në cilat raste?



Klasat nëpër shkollë përbëhen nga nxënës, të cilët nuk dallohen vetëm në dukje, por edhe në botëkuptime, qëndrime, shprehje, dëshira, nevoja etj. Për shkak se nxënësit janë të ndryshëm dhe dallojnë nga njëri-tjetri, atyre u duhet që t'u binden rregullave, me të cilat u mundësohet jeta e përbashkët nëpër shkollë. Disa prej atyre rregullave janë të vendosura nga institucionet shtetërore, si p.sh., komuna, ndërsa disa të tjera mund të krijohen ndërkohë me pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Në qoftë se dikush nuk pajtohet me ndonjë rregull, atëherë mospajtimin duhet diskutuar me shokët dhe shoqet e klasës dhe me mësuesin/en.

12

Fjalët kyçe: pjesëmarrje, respektim i rregullave, bashkëpunim, zbatim.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

### Përpunimi i përmbajtjes

Bashkëbisedim

Lexohet pjesa në libër dhe parashtrihen pyetjet, ku do të përgjigjen dhe do të shihet sa a kanë gjetur një gjuhë të përbashkët me ato që i kanë in-skenuar. Bisedojnë për rastet e tilla në shoqëritë e tyre dhe komunitet.



### Përforcimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Shkrim i lirë

Së bashku me nxënësit, do të hartohen disa rregulla që duhet të zbatohen për të mirën e të gjithëve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim dhe har-timin e rregullave që duhen zbatuar për respek-timin e njëri-tjetrit.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

---



---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

# Mësimi 7

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
Planifikon bashkërisht me bashkëmoshatarët aktivitete të ndryshme, duke përcaktuar përbërjen dhe rolin e secilit anëtar pjesëmarrës.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Planifikojmë dhe veprojmë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Diskuton për fjalën planifikim;
- Komenton rregullat për pjesëmarrje në aktivitet;
- Tregon rregullat që duhet të zbatohen gjatë zhvillimit të një aktiviteti.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Pesëvargëshi

Të gjithë nxënësit kanë për detyrë të formojnë nga një pesëvargësh me fjalën planifikim. Pasi të shkruhen, do të nxjerrim një pesëvargësh të përbashkët, i cili shkruhet në tabelë, në mënyrë që të vazhdohet me punën e përbashkët dhe shtjellimin e mësimi.

### Planifikojmë dhe veprojmë



**Situata 1.** Pranvera vjen më këndshëm kur era ledhaton faqet e shëndetshme të fëmijëve. Në pranverë marrim pjesë në vrapimin pranveror *Gara e Pranverës*. Kështu, edhe këtë vit, mësuesja na njoftoi se do të zhvillohej *Gara e Pranverës*, e cila ishte planifikuar nga organizatorët në fillim të aktiviteteve sportive. Secili nga ne duhet të përgatitet për këtë garë.



- A keni marrë pjesë në ndonjë garë vrapimi?
- Mendoni çfarë duhet të bëni para vrapimit.
- Listoni një varg rregullash që duhen respektuar gjatë garës.
- Diskutoni ato së bashku me shoqet/shokët.
- Çfarë gara të tjera organizoni në shkollë?
- Organizoni një garë në klasë me ndihmën e mësuesit/es.



*Garat janë aktivitete konkurruese, ku ndeshen dy apo më shumë skuadra/persona për vendin e parë. Garat mund të jenë të ndryshme: gara në vrapim, gara noti, kuize nga lëndë të ndryshme, si: matematika, gjuha etj. Të gjitha garat i kanë rregullat dhe kriteret e vlerësimit. Secili që merr pjesë në një garë të caktuar duhet të jetë i parapërgatitur për të. Garues/e quhen ato/o që marrin pjesë në një garë. Ata mbajnë përgjegjësi të caktuar dhe duhet t'i respektojnë rregullat e asaj gare. Për çdo garë që organizohet në shkollë duhet më parë të caktohet dita, ora dhe vendi i organizimit të saj.*

**Fjalët kyçe:** planifikim, garë, përgatitje, vrapim, aktivitet sportiv, organizator.



**Situata 1.** Pranvera vjen më këndshëm kur era ledhaton faqet e shëndetshme të fëmijëve. Në pranverë marrim pjesë në vrapimin pranveror *Gara e Pranverës*. Kështu, edhe këtë vit, mësuesja na njoftoi se do të zhvillohej *Gara e Pranverës*, e cila ishte planifikuar nga organizatorët në fillim të aktiviteteve sportive. Secili nga ne duhet të përgatitet për këtë garë.



- ? - A keni marrë pjesë në ndonjë garë vrapimi?
- Mendoni çfarë duhet të bëni para vrapimit.
- Listoni një varg rregullash që duhen respektuar gjatë garës.
- Diskutoni ato së bashku me shoqet/shokët.
- Çfarë gara të tjera organizoni në shkollë?
- Organizoni një garë në klasë me ndihmën e mësuesit/es.

*Garat janë aktivitete konkurruese, ku ndeshen dy apo më shumë skuadra/persona për vendin e parë. Garat mund të jenë të ndryshme: gara në vrapim, gara noti, kuize nga lëndë të ndryshme, si: matematika, gjuha etj. Të gjitha garat i kanë rregullat dhe kriteret e vlerësimit. Secili që merr pjesë në një garë të caktuar duhet të jetë i parapërgatitur për të. Carues/o quhen ato/o që marrin pjesë në një garë. Ata mbajnë përgjegjësi të caktuar dhe duhet t'i respektojnë rregullat e asaj gare. Për çdo garë që organizohet në shkollë duhet më parë të caktohet dita, ora dhe vendi i organizimit të saj.*

**Fjalët kyçe:** planifikim, garë, përgatitje, vrapim, aktivitet sportiv, organizator.

13



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Lexim dhe komentim

Lexohet dhe analizohet pjesa që është në libër dhe parashtrihen pyetjet, në të cilat nxënësit do të përgjigjen dhe do të mundohen t'i lidhin me pesëvargëshin e formuar më lart në tabelë.

Do të shkruhen disa nga aktivitetet që zhvillohen në shkollë dhe se a kanë marrë pjesë ata në ndonjërin prej tyre.

Si janë ndier?

Cila është arsyeja e pjesëmarrjes?

Si mendojnë që duhet të zgjidhen pjesëmarrësit?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Do të ndahet tabela në mes dhe do të shkruhen disa nga aktivitetet dhe mënyra se si zhvillohen ato, ose kushtet që duhet të plotësohen për pjesëmarrje.

Aktiviteti	Rregullat e aktivitetit

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për formimin e pesëvargëshit, përshkrimin e aktiviteteve dhe rregullat që duhen zbatuar.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve në klasë dhe shkollë dhe kontribuon në mënyrë kreative në realizimin e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.1,5, V.8, IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pjesëmarrja ime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Diskuton për fjalën lojë skenike;
- Zhvillon lojën skenike;
- Vlerëson punën e grupit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Pema e mendimeve

Në mes të tabelës, shkruhet fjala: shfaqje teatrale.

Rreth saj shkruhen fjalët e nxënësve se çfarë duhet të bëjmë për të realizuar një shfaqje teatrale.

Shfaqje teatrale

Pjesëmarrja ime

**Situata 1.** Shkolla jonë do të jetë pjesëmarrëse në konkursin e interpretimit teatror. Do të vëmë në skenë një pjesë teatri. Vendosiem ta përzgjidhim një pjesë për fëmijë. Mësuesi i teatrit na propozoi se mund ta shkruanim vetë tekstin. Duke njohur aftësitë e nxënësve të shkollës, ia besuam shkruimin e tekstit Vesës, e cila është edhe interpretese shumë e mirë. Ajo pranoi ta merrte edhe rolin kryesor, atë të një nxënëseje, e cila kishte problem me të kuptuarit e fjalëve. Na pëlqeu teksti, sepse afrohej me shumë problematika të shkollës. Rolin e mësueses që punon me përkushtim do ta luante Besa, ndërsa Ana e Mati do të luanin rolet e nxënësve që ndihmojnë shoqen/shokun e tyre. Do të punonim në grup, sapo teksti të ishte i përfunduar. Mësuesi do të na ndihmonte për skenën dhe veshjet.

- Për çfarë po përgatiteshin fëmijët?

- Si vepruan ata për ta realizuar pjesën teatrorë?

- A keni interpretuar ndonjëherë ndonjë rol?

- Nëse nuk keni interpretuar ndonjëherë, çfarë roli do të kishit dëshirë të interpretonit?

- Çfarë duhet të kemi parasysh kur na duhet të interpretojmë një pjesë teatrorë?

Të gjithë duhet të marrim pjesë në aktioitete të ndryshme; të japim kontributin tonë duke bashkëpunuar në grup. Kjo ndihmon për përfshirjen aktive të nxënësve, për respektimin e mendimit të tjetrit dhe për rritjen e shkallës së përgjegjësisë ndaj të tjerëve. Duhet t'i pranojmë të tjerët ashtu siç janë, me aftësitë dhe kufizimet, të mirat dhe të metat që kanë. Rëndësi ka që shkolla të krijojë mundësi për pjesëmarrje të përbashkët dhe të barabartë për të gjithë.


14

**Fjalët kyçe:** interpretim, pjesë teatrorë, rol, pjesëmarrje, kontribut, bashkëpunim.



## Pjesëmarrja ime

**Situata 1.** Shkolla jonë do të jetë pjesëmarrëse në konkursin e interpretimit teatror. Do të vëmë në skenë një pjesë teatri. Vendosëm ta përzgjidhim një pjesë për fëmijë. Mësuesi i teatrit na propozoi se mund ta shkruanim vetë tekstin. Duke njohur aftësitë e nxënësve të shkollës, ia besuam shkrimin e tekstit Vesës, e cila është edhe interpretese shumë e mirë. Ajo pranoi ta merrte edhe rolin kryesor, atë të një nxënëseje, e cila kishte problem me të kuptuarit e fjalëve. Na pëlqeu teksti, sepse afrohej me shumë problematika të shkollës. Rolin e mësueses që punon me përkushtim do ta luante Besa, ndërsa Ana e Mati do të luanin rolet e nxënësve që ndihmojnë shoqen/shokun e tyre. Do të punonim në grup, sapo teksti të ishte i përfunduar. Mësuesi do të na ndihmonte për skenën dhe veshjet.



- Për çfarë po përgatiteshin fëmijët?
- Si vepruan ata për ta realizuar pjesën teatrale?
- A keni interpretuar ndonjëherë ndonjë rol?
- Nëse nuk keni interpretuar ndonjëherë, çfarë roli do të kishit dëshirë të interpretonit?
- Çfarë duhet të kemi parasysh kur na duhet të interpretojmë një pjesë teatrale?



Të gjithë duhet të marrim pjesë në aktioitete të ndryshme; të japim kontributin tonë duke bashkëpunuar në grup. Kjo ndihmon për përfshirjen aktive të nxënësve, për respektimin e mendimit të tjetrit dhe për rritjen e shkallës së përgjegjësisë ndaj të tjerëve. Duhet t'i pranojmë të tjerët ashtu siç janë, me aftësitë dhe kufizimet, të mirat dhe të metat që kanë. Rëndësi ka që shkolla të krijojë mundësi për pjesëmarrje të përbashkët dhe të barabartë për të gjithë.

14

**Fjalët kyçe:** interpretim, pjesë teatrale, rol, pjesëmarrje, kontribut, bashkëpunim.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

### Përpunimi i përmbajtjes

Lexim dhe komentim

Lexohet dhe analizohet pjesa që është në libër dhe parashtrihen pyetjet që nxënësit do t'u përgjigjen. Përzgjidhen disa nxënës me të cilët do të organizojmë një shfaqje, kurse një grup tjetër do t'i shkruajë kërkesat e nevojshme për zhvillimin e lojës dhe temën për të cilën do të flitet.



## Përforcimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Organizim skenik

Vizatojnë në grup nga një pamje të një shfaqjeje skenike dhe arsyetojnë pse i kanë paraqitur ato pamje dhe cila është tema.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shprehjen e mendimit të lirë, përshkrimin e lojës skenike dhe bashkëpunimin në grup.

## Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Arkivi i familjes

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Grumbullon gjësende të veçanta të familjes dhe të komunitetit, i klasifikon ato sipas llojit dhe bën prezantimin e tyre (në klasë, grup etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, 4, II.1, 2, 6, III.5, 7, IV.1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Unë dhe familja ime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Krahason ndryshimet nga klasa e parë deri tani;
- Prezanton veten si dukej në klasën e parë dhe si duket tani;
- Numëron anëtarët e familjes.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografi e arkivit të klasës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Gushëkuqi rrethor

Nxënësit ulen në rreth dhe tregojnë për ndryshimet që ata po i vërejnë te shoqja ose shoku që e kanë afër, nga klasa e parë deri tani.

II. Arkivi i familjes  
Unë dhe familja ime



**Situata 1.** Në mesditë erdhi në jetë motra ime, Hëna. Kishte kohë që e përkëdhelja në barkun e mamit. Prindërit më kishin thënë se mund të ishte motër ose vëlla. Ajo do të ketë tipare të ngjashme me mua dhe me prindërit e mi, por, gjithsesi, me kalimin e viteve, do t'i krijojë tiparet e veta. Ajo ka flokë të kaftë; sy bojë qielli e buzë thuaje gjithmonë të hapura e me qumësht në cepat e tyre, ndërsa vetullat nuk i dallohen fare. Mua më pëlqen të kujdesem për motrën time dhe, një ditë, teksa po haja çokollatë, desha ta ndaja me të. Mirëpo prindërit, të shqetësuar, më shpjeguan se ajo ishte ende shumë e vogël për ushqime të tilla dhe se unë nuk guxoja ta ushqeja atë.



- Si ushqehen fëmijët e porsalindur?
- Analizoni bashkë me mësuesin/en se si duhet të sillemi me të vegjlit.
- A patën të drejtë prindërit që u shqetësuan për veprimin e Anës?





## Unë dhe familja ime



**Situata 2.** Prindërit i kanë mësuar Matit që anëtarët e familjes nuk duhet të mbajnë sekrete mes vete. Ata i kanë thënë që në familje gjithmonë duhet diskutuar qoftë për gjëra të mira që ndodhin, qoftë për shqetësimet që kanë. Kështu, një ditë, Mati u tregoi prindërve për një grindje që ndodhi në klasën e tyre. Prindërit e këshilluan atë që herëve të tjera t'i tregonin mësuesit, sepse në jetë është e rëndësishme që të jemi gjithmonë të sinqertë dhe të tregojmë të vërtetën. Të nesërmen prindërit shkuan bashkë me Matin në shkollë dhe biseduan me mësuesin e klasës së tij.



- Çfarë mendon për ngjarjen që ndodhi në klasë?
- Si do të veprime ti po të ishe në vend të Matit?
- Sa janë të rëndësishme diskutimet me anëtarët e familjes?



*Familja është grupi më i vogël shoqëror në të cilin jetojmë. Brenda familjes, të gjithë anëtarët kanë detyrat dhe përgjegjësitë e vetë. Ajo dallohet me afërsinë dhe lidhjen emocionale ndërmjet pjesëtarëve të saj. Pra, emocionet, çfarëdo qofshin ato, dashuria, zemërimi etj. shprehjen më lirshëm dhe më lehtë. Familjet kryesisht janë ambiente të ngrohta ku kultivohen dashuria, harmonia, mirëkuptimi etj. Rëndom njerëzit fillimisht i drejtohen familjes kur kanë nevojë për ndihmë dhe përkrahje.*

16

**Fjalët kyçe:** familje, mbështetje, dashuri, sinqeritet, ngrohtësi.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Prezantohen disa fotografi nga arkivi i klasës së parë dhe pastaj diskutojnë për ndryshimet që ata i shohin te njëri-tjetri.

Lexohet situata e parë dhe diskutohet njëkohësisht, më pas u përgjigjen pyetjeve të parashtruara.

Lexohet edhe situata e dytë dhe diskutohet njëkohësisht, më pas u përgjigjen pyetjeve që janë në fund.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Klasteri

Në mes të tabelës shkruhet fjala familje dhe shkruhen mendimet e nxënësve lidhur me këtë fjalë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e ndryshimeve, përgjigjet e dhëna dhe për mendimet e dhëna lidhur me fjalën familje.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Arkivi i familjes

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Mbledh informacione për ngjarje të rëndësishme, nga familjarët dhe të tjerët, gjen të përbashkëtat dhe dallimet në mes tyre dhe i prezanton ato para të tjerëve.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, 6, II.1, 6, III.1, 5, V.8, VI.7, 8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Komenton fotografinë e dhënë në libër;
- Tregon për pjesëtarët e familjes;
- Diskuton për kuptimin e fjalës paraardhës dhe pasardhës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografi të familjes së gjerë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, artet, shkencat e natyrës, jeta dhe puna, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**  
 Komentim i fotografisë

Nxënësit japin mendimet për fotografinë që e shohin në libër, pa e lexuar se çfarë po shkruan.

- Kush po merr pjesë në ditëlindje?
- E kujt është ditëlindja?
- Sa gjenerata marrin pjesë në ditëlindje?

Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime

**Situata 1.** Ana me prindërit do të shkonin në organizimin për ditëlindjen e stërgjyshit të saj. Ata ishin shumë të gëzuar që do të merrnin pjesë në këtë festë. Për këtë ditëlindje do të jenë së bashku katër gjeneratat e familjes së Anës. Aty do të jenë: Ana, prindërit e Anës, gjyshërit e Anës dhe stërgjyshi i Anës.

**?**

- Diskuto rreth situatës së mësipërme.
- Përmendi anëtarët e familjes sate.
- Përmendi gjeneratat që i njeh në familjen tënde.
- Cilët janë paraardhësit e tu?
- Sa vjeç është anëtari më i ri në familjen tënde?
- Sa vjeç është anëtari më i vjetër në familjen tënde?

**📖** Secili njeri ka një prejardhje. Atë e përbëjnë prindërit, gjyshërit dhe stërgjyshërit. Disa prej tyre i njohim e për disa vetëm kemi dëgjuar ngjarje apo jemi njohur nëpërmjet fotografive që i kemi në albumin e familjes. Këta janë paraardhësit tanë, kurse fëmijët janë pasardhësit e tyre.

**Fjalët kyçe:** familje, prind, gjysh, stërgjyshi, paraardhës, pasardhës.

17

## Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime



**Situata 1.** Ana me prindërit do të shkonin në organizimin për ditëlindjen e stërgjyshit të saj. Ata ishin shumë të gëzuar që do të merrnin pjesë në këtë festë. Për këtë ditëlindje do të jenë së bashku katër gjeneratat e familjes së Anës. Aty do të jenë: Ana, prindërit e Anës, gjyshërit e Anës dhe stërgjyshi i Anës.



- Diskuto rreth situatës së mësipërme.
- Përmendi anëtarët e familjes sate.
- Përmendi gjeneratat që i njeh në familjen tënde.
- Cilët janë paraardhësit e tu?
- Sa vjeç është anëtari më i ri në familjen tënde?
- Sa vjeç është anëtari më i vjetër në familjen tënde?



Secili njeri ka një prejardhje. Atë e përbëjnë prindërit, gjyshërit dhe stërgjyshërit. Disa prej tyre i njohim e për disa vetëm kemi dëgjuar ngjarje apo jemi njohur nëpërmjet fotografive që i kemi në albumin e familjes. Këta janë paraardhësit tanë, kurse fëmijët janë pasardhësit e tyre.

**Fjalët kyçe:** familje, prind, gjysh, stërgjyshi, paraardhës, pasardhës.

17



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

### Përpunimi i përmbajtjes

Lexim - komentim

Lexohet teksti i shkruar në libër, gjejmë cili është gjyshi, gjyshja, prindërit dhe fëmijët. Pastaj numërojmë anëtarët e familjes së disa nga nxënësit, i klasifikojmë sipas moshës, duke i paraqitur me anë të tabelës dhe në tri hapësira. Në të njëjtën kohë, do të sqarohen shprehjet paraardhës dhe pasardhës.

	Unë	Prindërit e mi	Prindërit e prindërve të mi
1.	Pasardhësi i prindërve të mi	Paraardhësit e mi (prindërit e mi) Pasardhësit e prindërve të tyre (prindërit e mi)	Paraardhësit e prindërve të mi (gjyshërit)
2.			



## Përforcimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Truri i gallerisë

Nxënësit në një fletë shkruajnë nga katër fjali për gjyshin, gjyshen, stërgjyshin dhe stërgjyshen, të cilat duhet t'ua dërgojnë kur të shkojnë në shtëpi ose kur t'i takojnë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mendimet e dhëna për fotografitë, komentimin e dhënë për prindërit dhe gjyshërit dhe fjalitë e shkruara.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Arkivi i familjes

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Krahason ngjarjet personale dhe familjare, dikur dhe sot dhe i evidenton ndryshimet në mënyrë kronologjike, përmes kujtimeve, fotografive familjare dhe gjësendeve të tjera.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3, II.1, 6, III.1, 8, V.8, VI.1, 7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Sendet me vlerë të familjes sime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpalos kujtime të familjes së tij/saj;
- Arsyeton emocionet e anëtarëve të familjes;
- Paraqet të përbashkëtat dhe të veçantat me anë të Diagramit të Venit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Sende të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, shkencat e natyrës, jeta dhe puna, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Bashkëbisedim


Nxënësit, të ulur në rreth, fillojnë të prezantojnë gjërat që i kanë sjellë nga shtëpitë e tyre, shpalosin kujtimet e tyre duke u bazuar në ato që i kanë sjellë.



Sendet me vlerë të familjes sime

**Situata 1.** Në një darkë familjare në shtëpinë e Arisë filluan të flisnin për kujtime të ndryshme. Secili tregonte për momentet më të bukura të familjes. Nëna e Arisë për një moment u largua nga dhoma dhe erdhi me një kuti në dorë. Të gjithë mbetën të habitur se çfarë ishte ajo.

Nëna u tregoi që këtu e quan "Kutia e kujtimeve familjare". Ajo e hapi atë dhe të gjithë filluan t'i shikonin gjërat që ishin brenda saj. Aty panë kujtime të brezave të ndryshëm të familjes, si: dëftesën e notave të gjyshit, një varëse të stërgjyshes, një fotografi të klasës së gjyshes, një letër dashurie që babai ia kishte dërguar nënës, si dhe dhëmbin e parë të Arisë. Ky qe një moment emocionues për të gjithë.



Bisedoni për situatën e dhënë.

- Çfarë mendoni për "Kutinë e kujtimeve familjare"?

- Pse u emocionuan anëtarët e familjes?

- A bisedoni ndonjëherë për kujtimet e familjes? Nëse po, trego për to.

- Krijoni në shtëpi "Kutinë e kujtimeve familjare".



Sendet me vlerë të familjes janë shumë të rëndësishme. Ruajtja e kujtimeve e bën lidhjen e së kaluarës me të tashmen. Përmes kujtimeve, ne njohim historinë dhe origjinën e familjes sonë. Njëpërmjet tyre ne trashëgojmë kulturën tonë brez pas brezi. Ato na ndihmojnë që ta duam dhe ta respektojmë njëri-tjetrin.



**Fjalët kyçe:** kujtim, vlerë, emocion, familje, origjinë.



### Sendet me vlerë të familjes sime

**Situata 1.** Në një darkë familjare në shtëpinë e Arisës filluan të flisnin për kujtime të ndryshme. Secili tregonte për momentet më të bukura të familjes. Nëna e Arisës për një moment u largua nga dhoma dhe erdhi me një kuti në dorë. Të gjithë mbetën të habitur se çfarë ishte ajo.

Nëna u tregoi që këtë kuti e quan "Kutia e kujtimeve familjare". Ajo e hapi atë dhe të gjithë filluan t'i shikonin gjërat që ishin brenda saj. Aty panë kujtime të brezave të ndryshëm të familjes, si: dëftesën e notave të gjyshit, një varëse të stërgjyshes, një fotografi të klasës së gjyshes, një letër dashurie që babai ia kishte dërguar nënës, si dhe dhëmbin e parë të Arisës. Ky qe një moment emocionues për të gjithë.



- ? - Bisedoni për situatën e dhënë.
- Çfarë mendoni për "Kutinë e kujtimeve familjare"?
- Pse u emocionuan anëtarët e familjes?
- A bisedoni ndonjëherë për kujtimet e familjes? Nëse po, trego për to.
- Krijoni në shtëpi "Kutinë e kujtimeve familjare".



*Sendet me vlerë të familjes janë shumë të rëndësishme. Ruajta e kujtimeve e bën lidhjen e së kaluarës me të tashmen. Përmes kujtimeve, ne njohim historinë dhe origjinën e familjes sonë. Nëpërmjet tyre ne trashëgojmë kulturën tonë brez pas brezi. Ato na ndihmojnë që ta duam dhe ta respektojmë njëri-tjetrin.*

18

**Fjalët kyçe:** kujtim, vlerë, emocion, familje, origjinë.



### Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA


Lexohet teksti i shkruar në libër. Duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtuara, arsyetojnë emocionet e përjetuara nga anëtarët e familjes:

- Çfarë ndodhi në familjen e Arisës?
- Kush e solli kutinë e kujtimeve?
- Çfarë kishte në kuti?
- Cilat janë kujtimet nga familja juaj?



### Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diagrami i Venit

Në fletoret e tyre, nxënësit paraqesin Diagramin e Venit dhe aty paraqesin të veçantat dhe të përbashkëtat e kujtimeve të familjes së Arisës dhe të familjeve të tyre.



### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shpalljen e kujtimeve, përgjigjet e dhëna nga situata e lexuara dhe plotësimin e Diagramit të Venit.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Arkivi i familjes

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Krahason ngjarjet personale dhe familjare, dikur dhe sot dhe i evidenton ndryshimet në mënyrë kronologjike, përmes kujtimeve, fotografive familjare dhe gjësendeve të tjera.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3, II.1, 6, III.1, 8, V.8, VI.1, 7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ngjarjet në familje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Prezanton albumin e tij/saj;
- Analizon situatën e paraqitur;
- Krahason emocionet që sjellin fotografitë e telefonit me ato të albumit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Albumi i fotografive të familjes, fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, shkencat e natyrës, jeta dhe puna, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**


Prezantim me anë të projektorit

Nxënësit kanë sjellë albumet e tyre nga shtëpia ose disa fotografi të ruajtura nga prindërit dhe, me anë të projektorit, bëhet prezantimi i albumeve dhe tregojnë një kujtim të tyre në ato fotografi. Pasi të prezantohen, komentohen nga nxënësit.

Ngjarjet në familje



**Situata 1.** Një ditë, mësuesja u kërkoi nxënësve që të sillnin albumet e tyre familjare. Ajo përgatiti projektorin, përmes të cilit çdo nxënës do ta bënte prezantimin e albumit të vet. Nxënësit i sollën albumet dhe filluan të bisedonin për ngjarjet që kishin ndodhur në familjet e tyre. Ishte një ditë e veçantë, sepse secili prej tyre shpaloste momentet më të bukura familjare. Atë ditë, në klasë kishte shumë të qeshura dhe duartrokitje, pas çdo ngjarjeje të treguar me shumë emocion. Por, habia më e madhe ishte kur mësuesja prezantoi ngjarjet familjare nga albumi i familjes së saj.



- Bisedo për situatën e dhënë.
- A është i rëndësishëm albumi i familjes?
- Trego disa nga momentet e veçanta në familjen tënde.




Fotografia mundëson ruajtjen e kujtimeve të ndryshme. Ajo regjistron momente të bukura dhe të veçanta në kohë dhe vende të ndryshme. Fotografitë plotësojnë nevojën për të mbajtur kujtime nga jeta e përditshme. Përmes tyre, ne kthehemi në kohë dhe ngjarjet gjatë jetës i mbajmë më të freskëta. Duke shfletuar albumet e fotografive, ne i ripërjetojmë momentet nga e kaluara.

**Fjalët kyçe:** album, fotografi, kujtim, kohë.

## Ngjarjet në familje



**Situata 1.** Një ditë, mësuesja u kërkoi nxënësve që të sillnin albumet e tyre familjare. Ajo përgatiti projektoren, përmes të cilit çdo nxënës do ta bënte prezantimin e albumit të vet. Nxënësit i sollën albumet dhe filluan të bisedonin për ngjarjet që kishin ndodhur në familjet e tyre. Ishte një ditë e veçantë, sepse secili prej tyre shpaloste momentet më të bukura familjare. Atë ditë, në klasë kishte shumë të qeshura dhe duartrokitje, pas çdo ngjarjeje të treguar me shumë emocion. Por, habia më e madhe ishte kur mësuesja prezantoi ngjarjet familjare nga albumi i familjes së saj.



- Bisedo për situatën e dhënë.
- A është i rëndësishëm albumi i familjes?
- Trego disa nga momentet e veçanta në familjen tënde.



Fotografia mundëson ruajtjen e kujtimeve të ndryshme. Ajo regjistron momente të bukura dhe të veçanta në kohë dhe vende të ndryshme. Fotografitë plotësojnë nevojën për të mbajtur kujtime nga jeta e përditshme. Përmes tyre, ne kthehemi në kohë dhe ngjarjet gjatë jetës i mbajmë në të freskëta. Duke shfletuar albumet e fotografive, ne i ripërfetojmë momentet nga e kaluara.

Fjalët kyçe: album, fotografi, kujtim, kohë.

19



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Bashkëbisedim dhe analizë


Lexohet teksti i shkruar në libër dhe vazhdohet me pyetjet që kanë të bëjnë me analizën e situatës së dhënë në libër:

- Çfarë ndodhi në klasë?
- A është i rëndësishëm albumi i familjes? Pse?
- Si u ndjeve kur dëgjove histori të familjes së shokëve/shoqeve?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Historia jonë

Nxënësit zgjedhin nga albumet e tyre nga një fotografi dhe e vendosin atë në fletën A4 dhe pastaj shkruajnë ngjarjen që tregon ajo fotografi, pra një histori të familjes. Grumbullohen të gjitha historitë e nxënësve dhe bëhet një libër klase, i cili titullohet “Historia jonë”.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për prezantimin e fotografive, analizën e situatave të dhëna dhe ndarjen e historisë me klasën.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Në arkivin e familjes

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Mbledh informacione për ngjarje të rëndësishme, nga familjarët dhe të tjerët, gjen të përbashkëtat dhe dallimet në mes tyre dhe i prezanton ato para të tjerëve.

### Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I.1, 3, II.1, 6, III.1, 7, IV.5, V.8, VI.1, 2.

### Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 3.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Albumi i familjes dhe pema e familjes

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Plotëson pemën e familjes, duke u bazuar në tekstin e shkruar;
- Shkruan saktë emrat e anëtarëve të familjes;
- Vlerëson rëndësinë e plotësimit të pemës për njohjen e paraardhësve dhe pasardhësve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Albumi i fotografive të familjes, fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, artet, shkencat e natyrës, jeta dhe puna, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Bashkëbisedim

Bisedojmë për pemën e familjes, duke filluar nga familja e mësuesit/es dhe vazhdon duke sqaruar që një pemë e familjes fillon nga ju vetë dhe vazhdon duke i gjetur anëtarët e tjerë të familjes, duke i ndarë nga nëna dhe babai, pastaj vazhdon me përdorimin e termave, si teze, hallë, dajë, xhaxha etj.



### Albumi i familjes

1. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe plotëso pemën e familjes së Matit.

Fatmiri dhe Merita kanë tre fëmijë: Hanën, që është nëna e Matit, dajën Luan dhe tezen Arditë. Prindërit e Matit janë Hana dhe Rinori. Ata kanë dy fëmijë, Matin dhe Bunën.

Mati ka dëshirë të luajë me vajzën e tezes, Jonën, kurse në shkollë shkon me djemtë e dajës, Rronin e Rrapin, që janë binjakë.

Babai i Matit, Rinori, ka motër Flakën dhe vëlla Blinin. Xhaxhait të Matit, Blinit, i ka lindur një vajzë, Ema.

Mati ka dëshirë që përrallat t'i dëgjojë nga prindërit e babait, që janë gjyshi Agron dhe gjyshja Teutë.

Një ditë, Mati pyeti prindërit se cilët ishin stërgjyshërit e tij. Gjyshi Fatmir u përgjigj:

Prindërit e mi janë Miranda dhe Shpendi.

Prindërit e gjyshe Meritës janë Venera dhe Astriti.


Prindërit e gjyshe Teutës janë Valbona dhe Petriti.


Prindërit e gjyshit Agron janë Violeta dhe Gazmendi.




Fjalët kyçe: familje, album, fotografi.






 **Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
 Lexim dhe plotësim

Lexohet teksti i shkruar në libër dhe vazhdohet me pyetjet që kanë të bëjnë me plotësimin e pemës së familjes së Matit, duke u munduar dhe përshtatur me tekstin, njëkohësisht edhe duke plotësuar librin së bashku me fëmijët dhe duke i kushtuar rëndësi shkrimit të emrave në mënyrën e saktë:



 **Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
 Diskutim - krahasim

Nxënësit në mënyrë të pavarur mundohen të punojnë një pemë të familjes në fletoret e tyre, duke e pasur parasysh që duhet të shkruajnë emrat e familjarëve që ata i dinë dhe ta kuptojnë sa e rëndësishme është që t'i dinë emrat dhe t'i njohin paraardhësit e tyre dhe që ata janë pasardhës të tyre.

Detyrën do ta vazhdojnë në shtëpi së bashku me prindërit e tyre dhe aty do ta shohin se sa kanë njohuri për paraardhësit e familjes.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për plotësimin e pemës së familjes.

**Detyrë:**

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Evidenton raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (shprehja e lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.).  
 Liston përgjegjësitë e veta, të anëtarëve të familjes, të bashkësisë, të shkollës dhe argumenton rëndësinë e zbatimit të tyre për të mirën e përgjithshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, 3. II. 2, 3. V. 8 VI. 2, 5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Të drejtat dhe përgjegjësitë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon të drejtat nga përgjegjësitë;
- Diskuton të drejtat e fëmijëve, të të moshuarve dhe të institucioneve përkatëse;
- Analizon mënyrën e zbatimit të të drejtave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**


Parashikimi me terma paraprakë

Nxënësve u shënohen disa fjalë në tabelë, si:




III. Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri  
 Të drejtat dhe përgjegjësitë

**Situata 1.** Në pallatin përballë nesh banon një i moshuar. Kishte ditë që nuk e kisha parë në ballkon. U shqetësova dhe pyeta nënën. Ajo më tha se ai nuk mund të banonte më vetëm.



- Cili institucion duhet t'i ketë ofruar shërbim?
- Cili është roli i këtyre institucioneve?
- Cila është përgjegjësia e tyre?
- Pse duhet t'i ofrohet të moshuarit shërbimi i nevojshëm?
- Çfarë mendon se do të ndodhë me të moshuarin?
- Si kujdesesh ti për njerëzit në nevojë?

**Situata 2.** Liri është nxënës i klasës së tretë. Prindërit e tij nuk punojnë askund. Liri është i detyruar të shesë lule që të sigurojë të ardhura për familjen e tij.



- A ka të drejtë Liri të punojë?
- Cila është e drejta që e mbrohet atë?
- Çfarë duhet të bëjnë prindërit në këtë rast?
- Përmend disa përgjegjësi që u takojnë fëmijëve, e disa prindërve.



Fëmijët gëzojnë të drejtën që të shkojnë në shkollë, kopshte dhe çerdhe. Nga ana tjetër, të moshuarit, po ashtu, kanë nevojë për mjedise në të cilat ofrohet kujdesi i duhur për ta. Njerëzve, që jetojnë të vetëm dhe nuk janë të shëndetshëm mjaftueshëm sa për t'u kujdesur për veten, duhet t'u ofrohet ndihmë. Kjo ngaqë garantohet e drejta për jetë të sigurt, për realizimin e së cilës shteti i ka institucionet e veta. Me të drejtat që njerëzit gëzojnë, vijnë edhe përgjegjësitë. Edhe fëmijët kanë përgjegjësi të tyre. P.sh., ju keni përgjegjësi shkollore (kryerja e detyrave, leximi i librave, kujdesi për hapësirën shkollore), përgjegjësi për sjelljen, përgjegjësi për organizimin personal (si ta organizoni kohën) etj.




**Fjalët kyçe:** institucion, përgjegjësi, shërbim, kujdes.




### III. Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri Të drejtat dhe përgjegjësitë

**Situata 1.** Në pallatin përballë nesh banon një i moshuar. Kishte ditë që nuk e kisha parë në ballkon. U shqetësova dhe pyeta nënën. Ajo më tha se ai nuk mund të banonte më vetëm.



- ? - Cili institucion duhet t'i ketë ofruar shërbim?
- ? - Cili është roli i këtyre institucioneve?
- ? - Cila është përgjegjësia e tyre?
- Pse duhet t'i ofrohet të moshuarit shërbimi i nevojshëm?
- Çfarë mendon se do të ndodhë me të moshuarin?
- Si kujdesesh ti për njerëzit në nevojë?

**Situata 2.** Liri është nxënës i klasës së tretë. Prindërit e tij nuk punojnë askund. Liri është i detyruar të shesë lule që të sigurojë të ardhura për familjen e tij.



- ? - A ka të drejtë Liri të punojë?
- ? - Cila është e drejta që e mbron atë?
- ? - Çfarë duhet të bëjnë prindërit në këtë rast?
- Përmend disa përgjegjësi që u takojnë fëmijëve, e disa prindërve.



Fëmijët gëzojnë të drejtën që të shkojnë në shkollë, kopshte dhe çerdhe. Nga ana tjetër, të moshuarit, po ashtu, kanë nevojë për mjedise në të cilat ofrohet kujdesi i dulur për ta. Njerëzve, që jetojnë të vetëm dhe nuk janë të shëndetshëm njaftueshëm sa për t'u kujdesur për veten, duhet t'u ofrohet ndihmë. Kjo ngaqë garantohet e drejta për jetë të sigurt, për realizimin e së cilës shteti i ka institucionet e veta. Me të drejtat që njerëzit gëzojnë, vijnë edhe përgjegjësitë. Edhe fëmijët kanë përgjegjësi të tyre. P.sh., ju keni përgjegjësi shkollore (krerja e detyrave, leximi i librave, kujdesi për hapësirën shkollore), përgjegjësi për sjelljen, përgjegjësi për organizimin personal (si ta organizoni kohën) etj.

22

**Fjalët kyçe:** institucion, përgjegjësi, shërbim, kujdes.



Pyesim nxënësit se çfarë na kujtojnë këto fjalë dhe me çfarë kanë të bëjnë. Theksojmë se janë të drejta, mirëpo duhet të kemi edhe përgjegjësi ndaj të drejtave tona. (P.sh., ne kemi të drejtë të shkollohemi, por kemi përgjegjësi ndaj shkollës që të vijojmë mësimet sipas orarit, t'i respektojmë rregullat e shkollës etj.).



### Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Insert

Pas diskutimit të fjalëve të paraqitura në tabelë, do të lexohet teksti, situata 1. Pas leximit, do të bëhet diskutimi i njohurive të marra dhe do të parashtrihen pyetjet lidhur me tekstin e lexuar, si:

- Cili institucion duhet t'i ketë ofruar shërbim?
- Cili është roli i këtyre institucioneve?
- Cila është përgjegjësia e tyre?

Do të lexohet edhe pjesa tjetër e mbetur, situata 2, dhe do të diskutohet përsëri për të drejtat dhe organizatat që përpiqen t'i mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Argumentojnë zgjidhjen e duhur, si dhe flasin për institucionet që ofrojnë shërbime.



### Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Mendo / puno në dyshe / shkëmbe me të tjerët

Nxënësve do t'u shpërndahen etiketa me të drejtat e fëmijëve. Nga dy nxënës do të kenë një të drejtë. Në çifte do të shkruajnë lidhur me të drejtën që e kanë.

- Sa mendoni që zbatohet te fëmijët në Kosovë?
- Cila është rëndësia e kësaj të drejte?

Pastaj, secila e drejtë do të diskutohet para shokëve/shoqeve të klasës, si dhe për institucionet që i kryejnë shërbimet përkatëse.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e të drejtave dhe përgjegjësisve, bashkëpunimin në çifte dhe për analizat e dhëna me shkrim.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon të drejtat themelore, në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3, II.1,7, III.1,2 V.8, VI.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2, 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Unë kam të drejta në familje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Diskuton për sjelljet e anëtarëve të familjes;
- Analizon situatën e dhënë;
- Dallon detyrat dhe përgjegjësitë në familje.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Punë në grup

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup do të ketë nga dy fotografi, ku janë të paraqitura anëtarët e familjes, duke bërë veprime të ndryshme. Detyrë kanë që të vendosin cilën nga fotografitë do ta zgjedhin në grup dhe do të tregojnë se pse e kanë zgjedhur këtë fotografi dhe si kanë vendosur, duke bashkëpunuar apo e ka zgjedhur vetëm njëri.

Unë kam të drejta në familje



**Situata 1.** Jonit, djalit të vogël të familjes, i pëlqente të luante vazhdimisht me telefonin celular të babait. Loja është e drejtë e fëmijëve, të cilët zhvillojnë aftësitë e tyre nëpërmjet saj. Por babai kishte dëgjuar për kujdesin që duhet të tregohet për përdorimin e celularit nga fëmijët. Ai i vendosi Jonit orare për përdorimin e tij. Babai e dinte se kishin ndryshuar kohët dhe tashmë telefoni përdoret dhe si mjet argëtues.



- A kanë të drejtë fëmijët të eksplorojnë duke përdorur teknologjinë?
- A është e drejtë që fëmijët të përdorin mjetet e më të rriturve?
- Si ju duket veprimi i Jonit?



Njohja e fëmijëve me të drejtat e tyre fillon në familje. Fëmijët kanë të drejtë që të kenë një familje, e cila duhet t'i ndihmojë dhe t'i mbështesë ata. Sa më mirë që t'i njohin prindërit të drejtat, aq më të mbrojtur do të jenë fëmijët e tyre. Fëmijët duhet të respektojnë anëtarët e familjes dhe të jenë të kujdesshëm kur përdorin gjërat e të rriturve. Në familje duhet të mbizotërojnë mirëkuptimi dhe toleranca.

**Fjalët kyçe:** përgjegjësi, të drejta, respekt, mirëkuptim.

## Unë kam të drejta në familje



**Situata 1.** Jonit, djalit të vogël të familjes, i pëlqente të luante vazhdimisht me telefonin celular të babait. Loja është e drejtë e fëmijëve, të cilët zhvillojnë aftësitë e tyre nëpërmjet saj. Por babai kishte dëgjuar për kujdesin që duhet të tregohet për përdorimin e celularit nga fëmijët. Ai i vendosi Jonit orare për përdorimin e tij. Babai e dinte se kishin ndryshuar kohët dhe tashmë telefoni përdoret dhe si mjet argëtues.



- A kanë të drejtë fëmijët të eksplorojnë duke përdorur teknologjinë?
- A është e drejtë që fëmijët të përdorin mjetet e më të rriturve?
- Si ju duket veprimi i Jonit?



Njohja e fëmijëve me të drejtat e tyre fillon në familje. Fëmijët kanë të drejtë që të kenë një familje, e cila duhet t'i ndihmojë dhe t'i mbështesë ata. Sa më mirë që t'i njohin prindërit të drejtat, aq më të mbrojtur do të jenë fëmijët e tyre. Fëmijët duhet të respektojnë anëtarët e familjes dhe të jenë të kujdesshëm kur përdorin gjërat e të rriturve. Në familje duhet të mbizotërojnë mirëkuptimi dhe toleranca.

**Fjalët kyçe:** përgjegjësi, të drejta, respekt, mirëkuptim.

23



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

### Përpunimi i përmbajtjes

Shprehje e mendimit

Lexohet pjesa që është në libër dhe iu përgjigjen pyetjeve të parashtruara në libër. Paraqiten në projektor këto fjalë: **përgjegjësi, të drejta, presion** dhe **frikë** dhe diskutohen.



### Përforcimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Shkrim i lirë

Plotëso tabelën në fletë A4.

Detyrat në familje	Përgjegjësi në familje

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për bashkëpunimin në grup, përgjigjet e dhëna dhe plotësimin e tabelës.

## Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Evidenton raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (shprehja e lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.).

Liston përgjegjësitë e veta, të anëtarëve të familjes, të bashkësisë, shkollës dhe argumenton rëndësinë e zbatimit të tyre për të mirën e përgjithshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:**

I.1,3, II.1,7, III.1,2 V.8, VI.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:**

1.3.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Të drejtat e mia në shkollë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë;
- Dallon të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë;
- Aplikon të drejtat dhe përgjegjësitë në shkollë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Imaginatë e drejtuar

Prej nxënësve kërkohet që të tregojnë disa të drejta dhe përgjegjësi që kanë në shkollë.



**Të drejtat e mia në shkollë**

**Situata 1.** Mësuesi i klasës së tretë ishte shumë i shqetësuar. Ai mendoi që shqetësimin e tij ta ndante bashkë me nxënësit e klasës. Kishte tri ditë që Tomorri nuk po vinte në shkollë. Ai ishte mërziur shumë nga nota e ulët që kishte marrë në matematikë. Pasi e diskutuan në klasë, të gjithë menduan që një grup shokësh e shoqesh, bashkë me mësuesin, t'i shkonin Tomorrit për vizitë. Ata kishin menduar edhe një plan se si do të punonin për ta ndihmuar atë që të arrinte rezultate të larta edhe në këtë lëndë. Prindërit e Tomorrit u gëzuan shumë për ndihmën dhe mbështetjen që po i jepeshin djalit të tyre. Tani edhe ai do të mësonte dhe do të ecte me hapat e shokëve dhe të shoqeve të klasës.



- Çfarë janë duke bërë nxënësit e klasës së tretë?
- Si do ta zgjidhje ti situatën e dhënë?
- Argumentoje zgjidhjen tënde.


**Situata 2.** Lexoni episodet e mëposhtme dhe diskutoni për secilin prej tyre.

Shoqet dhe shokët po luajnë së bashku duke folur për të drejtat që ata kishin mësuar një vit më parë në shkollë. Nga loja kishin përjashtuar Drinin, i cili ishte nxënës i ri në këtë klasë.

Të gjithë shokët e klasës ishin të shqetësuar, pasi në klasë ishte thyer një vazë me lule. Ata shikonin njëri-tjetrin se kush kishte dalë i fundit nga klasa një ditë më parë!

Miri dhe Albana ishin shokë banke. Pa dashur, Miri ia rrëzoi Albanës librin. Ajo, e mërzhitur, iu drejtua me fjalë fyese. Miri e uli kokën i turpëruar.

Në klasën tonë kemi një nxënës i cili nuk i lësh shokët dhe shoqet që të flasin në mësim, pasi do që të përgjigjet vetëm ai. Mësuesi i tërhoqi vërejtjen duke i thënë se nuk duhej të fliste vetëm ai. Të gjithëve duhet t'u krijohet mundësia për t'i thënë mendimet e tyre.



? - Si do ta zgjidhje secilën nga situatat e dhëna?  
- Jep sa më shumë mendime për zgjidhjen e tyre.

Shkolla ka përgjegjësinë kryesore për të ardhmen e shoqërisë, sepse i përgatit fëmijët të bëhen pjesëtarë të dobishëm të saj. Misioni i shkollës është që t'i përgatitë nxënësit për një të ardhme të sigurt e të mirë. Mësuesit duhet të bëjnë përpjekje për t'i mbështetur mendimet dhe kërkesat e nxënësve në lidhje me problemet që i shqetësojnë. Shteti duhet t'i marrë të gjitha masat për ta minimizuar braktisjen e shkollës, duke kontribuar për garantimin e së drejtës për shkolllim.

Fjalët kyçe: shkollë, të drejta, investim, pjesëmarrje, braktisje.

25

Të drejtat në shkollë	Përgjegjësitë në shkollë

Nxënësit japin mendime dhe shënohen në tabelë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
Rrjeti i diskutimit

Rikujtojmë të drejtat e mësuarat në njësitë para-prake. Theksojmë se, përveç të drejtave, ne gjithashtu kemi edhe përgjegjësi. Lexojmë tekstin e dhënë në libër, situatën 1, dhe ndërkohë diskutohet dhe analizohet së bashku me nxënësit.

Parashtrihen pyetje lidhur me tekstin e lexuar:

- Çfarë janë duke bërë nxënësit e klasës së tretë?
- Si do ta zgjidhje ti situatën e dhënë?

Lexohet situata 2 dhe parashtrihet pyetja:

- Si do ta zgjidhje secilën nga situatat e dhëna?
- Argumentoje zgjidhjen tënde.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
Copëza të përziera

Nxënësve u shpërndahen etiketa. Në secilën etiketë është e shënuar nga një e drejtë ose një përgjegjësi. Sipas shortit, nxënësit do të bëjnë tërheqjen. E drejta dhe përgjegjësia duhet të lidhen me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë nxënësit do të qëndrojnë pastaj në grupe.

Nxënësit me radhë do të lexojnë etiketën dhe do të përcaktojnë nëse kanë të drejtë ose përgjegjësi të shkruar. P.sh.: “Të shkoj në shkollë”, nxënësi/ja duhet të theksojë që është shkruar një e drejtë. Pas kësaj, do të gjendet edhe përgjegjësia e kësaj të drejte. P.sh., njëri nxënës ka etiketën “Të respektoj orarin e mësimit”. Kështu do të veprojnë të gjithë nxënësit.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e të drejtave nga përgjegjësitë, për përdorimin e një fjalori të pasur, për aftësitë e të analizuarit dhe të argumentuarit drejt dhe saktë.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon të drejtat themelore, në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.3,7, III.1, VI.1,2,3,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përgjegjësitë në komunitet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan mjedisin e lagjes;
- Përcakton përgjegjësitë e shoqërisë ndaj mjedisit;
- Përpilon rregullat e nevojshme për komunitet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4 me fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Njeriu dhe natyra, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**


Imagjinatë e drejtuar

Nxënësit shprehin mendimet e tyre, duke përshkruar mjedisin e lagjes së tyre.

- Si duket mjedisi i lagjes suaj?

Po ashtu, gjatë përshkrimit tregojnë:

- Cilat janë gjërat që ju pengojnë?
- Çka do të ndryshonit?





**Situata 2.** Qyteti shpeshherë përmytet në dimër, sidomos kur shtohen reshjet e shiut. Fëmijët e kanë të pamundshëm kalimin e rrugës për të shkuar në shkollë. Poshhtë banesave, garazhet e makinave dhe bodrumet mbushen me ujë.



- Kujt duhet t'i drejtohemi për të mos pasur më problem të tillë?
- A kanë të drejtë banorët që të kërkojnë zgjidhje të problemit?
- Kush mban përgjegjësi për situatën e krijuar?
- Çfarë do të bëje ti në një situatë të tillë?

Fëmijët kanë shumë të drejta. Për të gëzuar plotësisht të drejtat e tyre, përpos institucioneve shtetërore, ata kanë nevojë edhe për mbështetjen e komunitetit në të cilin jetojnë. Mbështetja e komunitetit i bën fëmijët më të lirë dhe më të fortë për marrjen e vendimeve. Fëmijët kanë të drejtë të jetojnë në mjedis të pastër dhe të mbrojtur.


Fjalët kyçe: komunitet, përmytje, bodrum.

27



### Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Shqyrtojmë së bashku situatat 1 dhe 2, të dhëna në libër. Duke analizuar, përcaktojmë disa përgjegjësi, të cilat kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit që na rrethon.



### Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Ditari dypjesësh

Secili nxënës në fletën e dhënë shkruan rregullat në fotografitë përkatëse, duke vëzhguar me kujdes tri fotografitë e dhëna. Përpilon sipas imagjinatës së tij rregullin që mendon.

Fotografia	Përgjegjësia
Fotografia	Përgjegjësia
Fotografia	Përgjegjësia

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e mjedisit ku jetojnë, përcaktimin e përgjegjësisë dhe përpilimin e rregullave në fotografitë e dhëna.

#### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë kam të drejta në shkollë dhe shoqëri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon të drejtat themelore, në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato.

Evidenton raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (shprehja e lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3, II.3,7, III.1, VI.1,2,3,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Stop dhunës në familje!

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon raste të dhunës në familje, shoqëri dhe komunitet;
- Përshkruan pasojat që sjell përdorimi i dhunës në familje, shoqëri dhe komunitet;
- Identifikon faktorët që parandalojnë dhunën në familje.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Stuhi mendimesh


- A dini ndonjë rast të dhunës?

Nxënësit përgjigjen në pyetjen e parashtruar - secili jep mendimin e vet, duke treguar para klasës ndonjë rast të dëgjuar ose të parë në lagje apo në familje.



Stop dhunës në familje!

**Situata 1.** Familja ime është një familje e madhe. Unë kam 2 motra dhe 3 vëllezër. Motra e vogël është pak tekanjoze dhe shpesh sillet si e tillë. Prindërit na këshillojnë shpesh si të sillemi me të. Një pasdite, ajo ishte duke luajtur në oborr dhe po kërkonte celularin e vëllait të madh për të dëgjuar muzikë. Prindërit nuk na kishin mësuar t'ia plotësonim çdo dëshirë asaj, kështu që unë, i lodhur nga tekat e saj, ia rrëmbeva celularin nga dora. Ajo filloi të qante me të madhe.



Në familje, në shkollë apo në komunitet, mund të ndodhë që të ketë keqkuptime. Fëmijët duhet të mësohen që t'i zgjidhin ato përmes komunikimit. Kjo çon në mirëkuptim dhe paqe. Fëmijët duhet të ndërgjegjësohen për të marrë pjesë në luftën kundër dhunës. Ata kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi. Këtë ua siguron **Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**. Ndonjëherë ndodh të ketë edhe keqkuptime brenda familjes, por të gjithë duhet të tolerojnë, në mënyrë që të ketë harmoni mes nesh.



**Fjalët kyçe:** dhunë, mirëkuptim, keqtrajtimit, ndërgjegjësim, harmoni.



## Stop dhunës në familje!

**Situata 1.** Familja ime është një familje e madhe. Unë kam 2 motra dhe 3 vëllezër. Motra e vogël është pak tekanjoze dhe shpesh sillet si e tillë. Prindërit na këshillojnë shpesh si të sillemi me të. Një pasditë, ajo ishte duke luajtur në oborr dhe po kërkonte celularin e vëllait të madh për të dëgjuar muzikë. Prindërit nuk na kishin mësuar t'ia plotësonim çdo dëshirë asaj, kështu që unë, i lodhur nga tekat e saj, ia rrëmbeva celularin nga dora. Ajo filloi të qante me të madhe.



- Si duhet të sillemi në familje?
- Si duhet t'i zgjidhim problemet në familje?
- Kush kishte faj në situatën e mësipërme?
- A duhet përdorur dhunë për zgjidhjen e problemeve?
- Si do të duhej t'i qaseshim problemit në këtë situatë?



Në familje, në shkollë apo në komunitet, mund të ndodhë që të ketë keqkuptime. Fëmijët duhet të mësohen që t'i zgjidhin ato përmes komunikimit. Kjo çon në mirëkuptim dhe paqe. Fëmijët duhet të ndërgjegjësohen për të marrë pjesë në luftën kundër dhunës. Ata kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi. Këtë ua siguron Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Ndajlerë ndodh të ketë edhe keqkuptime brenda familjes, por të gjithë duhet të tolerojmë, në mënyrë që të ketë harmoni mes nesh.

28

**Fjalët kyçe:** dhunë, mirëkuptim, keqtrajtim, ndërgjegjësim, harmoni.

- Po ju, si silleni në këto raste?

Nga përgjigjet e dhëna, parashtrajmë pyetje vazhdimisht, duke nxjerrë mendime të ndryshme.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mësimdhënia e ndërsjellë

Lexojmë rastin e dhënë në situatën 1 dhe diskutojmë me njëri-tjetrin. Analizojmë pyetjet e parashtruara në libër. Gjatë analizës përshkruajmë edhe pasojat që sjell përdorimi i dhunës, kush i siguron fëmijët, nga kush vjen dhuna në familje, shoqëri e komunitet.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Klaster



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e rasteve të dhunës dhe identifikimin e faktorëve të ndryshëm për parandalimin e dhunës në familje, shoqëri, komunitet.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Unë kam të drejta në shkollë dhe shoqëri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon të drejtat themelore, në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato.

Evidenton raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (shprehja e lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3, II.2,3,7 III.1,4, V.8 VI.2,3,4,6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Stop dhunës në shkollë!

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon raste të dhunës në klasë, shkollë etj.;
- Përshkruan pasojat që sjell përdorimi i dhunës në shkollë;
- Shkruan rregulla kundër dhunës në shkollë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Stuhi mendimesh

- A ka dhunë brenda klasës suaj?

Nxënësit përgjigjen në pyetjen e parashtruar - secili jep mendimin e vet, duke treguar para klasës ndonjë rast të dëgjuar ose të parë.

Stop dhunës në shkollë!

**Situata 1.** Korabi kishte dëshirë të vizatonte. Ai bënte piktura e portrete të shokëve e të prindërve. Thoshte shpesh se përshkrimet e vjeshës apo të dimrit i realizonte më bukur me laps e ngjyra sesa me fjalë. Kishte mbledhur rreth vetes më të pasionuarit pas pikturës. Ai filloi që t'u mburrej shokëve dhe shoqeve, duke i fyer dhe duke theksuar se asnjë në klasë nuk pikturonte si ai. Të gjithë u ndien keq nga fjalët e Korabit. Ata vendosën që t'i jepnin një mësim të mirë shokut të tyre. Në një fletë të bardhë, ata shkruan: *Stop fyerjes ndaj nxënësve dhe dëshirave të tyre!*

- Çfarë mendoni për sjelljen e Korabit?  
 - Pse nuk duhej t'i fyente shokët dhe shoqet?  
 - A keni pasur raste kur jeni ndier të fyer?  
 - Si keni vepruar në këto raste?  
 - Pse duhen shmangur format e dhunës në shkollë?

Diskutoni së bashku dhe hartoni listën e rregullave, të cilat çojnë në shmangien e përdorimit të dhunës në shkollë dhe jashtë saj. Ngjiteni atë në klasë. Kërkoni nga të gjithë nxënësit që rregullat e vendosura të zbatohen.

*Ka raste kur në shkollë përballemi me konflikte të ndryshme që vijnë nga keqkuptimet. Disa nga shkaqet mund të jenë konkurrenca mes nxënësve, mungesa e tolerancës, paufësia për t'i zgjidhur konfliktet, komunikimi i dobët etj. E rëndësishme është që çfarëdo situatë që krijohet, ajo duhet të zgjidhet përmes komunikimit. Ne duhet të tregojmë tolerancë dhe mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit, sepse të drejtat tona janë të barabarta.*

**Fjalët kyçe:** stop dhunës, rregulla, zbatim, keqkuptim.

29

## Stop dhunës në shkollë!



**Situata 1.** Korabi kishte dëshirë të vizatonte. Ai bënte piktura e portrete të shokëve e të prindërve. Thoshte shpesh se përshkrimet e vjeshhtës apo të dimrit i realizonte më bukur me laps e ngjyra sesa me fjalë. Kishte mbledhur rreth vetes më të pasionuarit pas pikturës. Ai filloi që t'u mburrej shokëve dhe shoqeve, duke i fyer dhe duke theksuar se asnjë në klasë nuk pikturonte si ai. Të gjithë u ndien keq nga fjalët e Korabit. Ata vendosën që t'i jepnin një mësim të mirë shokut të tyre. Në një fletë të bardhë, ata shkruan: *Stop fyerjes ndaj nxënësve dhe dëshirave të tyre!*



- Çfarë mendoni për sjelljen e Korabit?
- Pse nuk duhej t'i fyente shokët dhe shoqet?
- A keni pasur raste kur jeni ndier të fyer?
- Si keni vepruar në këto raste?
- Pse duhen shmangur format e dhunës në shkollë?

Diskutoni së bashku dhe hartoni listën e rregullave, të cilat çojnë në shmangien e përdorimit të dhunës në shkollë dhe jashtë saj. Ngjiteni atë në klasë. Kërkoni nga të gjithë nxënësit që rregullat e vendosura të zbatohen.



*Ka raste kur në shkollë përballemi me konflikte të ndryshme që vijnë nga keqkuptimet. Disa nga shkaqet mund të jenë konkurrenca mes nxënësve, mungesa e tolerancës, paaftësia për t'i zgjidhur konfliktet, komunikimi i dobët etj. E rëndësishme është që çfarëdo situatë që krijohet, ajo duhet të zgjidhet përmes komunikimit. Në duhet të tregojmë tolerancë dhe mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit, sepse të drejtat tona janë të barabarta.*

**Fjalët kyçe:** stop dhunës, rregulla, zbatim, keqkuptim.

29

- Po në shkollë, a keni parë raste të dhunës? Nga përgjigjet e dhëna, parashtrajmë pyetje vazhdimisht, duke nxjerrë mendime të ndryshme.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
Mësimdhënia e ndërsjellë

Lexojmë rastin e dhënë në situatën 1 dhe diskutojmë me njëri-tjetrin. Kërkohet nga nxënësit të hartojnë listën e rregullave që na ndihmojnë të shmangim përdorimin e dhunës në shkollë dhe jashtë saj.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
Shkrim i lirë

Në grupe shpërndahen fletat dhe, së bashku, secili grup shkruan katër rregulla, të cilat i listojmë në një fletushkë të shoqëruar me ilustrim. Rregullat prezantohen para shokëve/shoqeve dhe do të shërbejnë si modele. Kërkohet nga nxënësit të zbatohen në klasë, shkollë e më gjerë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e rasteve të dhunës dhe shkrimin e rregullave të ndryshme për parandalimin e dhunës në shkollë.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Identifikon disa nga ngjarjet që organizohen në shkollë dhe shpjegon arsyet e këtyre manifestimeve.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3, II.3,6, III.1, VI.3,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Shkolla ime

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon për mjedisin e shkollës dhe njerëzit që punojnë në të;
  - Identifikon festat që mbahen në shkollën e tij/saj;
  - Përshkruan me shkrim festën që i pëlqen.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
 Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**  
 Imagjinatë e drejtuar

- Si duket mjedisi i shkollës suaj?  
 Nxënësit shprehin mendimet e tyre, duke treguar për mjedisin e shkollës së tyre.
- Kush punon në shkollën tuaj?  
 Po ashtu, gjatë përshkrimit tregojnë:
- Cilat janë punët që kryejnë ata?
- Cilat festa festohen në shkollë?



**IV. Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim**  
 Shkolla ime

**Situata 1.** Jeta dhe Redoni janë shokë klase. Ata këtë muaj janë shumë të angazhuar, pasi po afrohet Dita e Shkollës. Shkolla gumëzhin nga aktivitetet e nxënësve. Disa nga nxënësit po merren me rregullimin e oborrit të shkollës, disa me pastrimin e klasave, disa me provat e vallëzimeve, të recitimeve dhe të këndimeve, si dhe disa të tjerë me shkrimin e ftesave. Secili nxënës dëshiron të japë kontributin e tij për Ditën e Shkollës. Atë ditë, dyert do të hapen për të gjithë prindërit dhe të ftuarit e tjerë. Në Ditën e Shkollës çdo gjë do të shkëlqejë. Prindërit dhe mësuesit do të krenohen me punën e këtyre fëmijëve të palodhshëm.




- ?**
- Bisedoni për situatën e dhënë.
  - Kur është dita e shkollës suaj?
  - Po ju, si e organizoni këtë ngjarje në shkollën tuaj?

**Situata 2.** Për Ditën e Librit, në shkollën ku mësojnë Vesa dhe Flori u organizua një aktivitet i mbledhjes së librave për ta pasuruar bibliotekën e shkollës. Sa e bukur ishte ajo ditë, kur të gjithë fëmijët drejtoheshin në bibliotekë me libra në duar. Raftet e bibliotekës u mbushën plot dhe dukeshin sikur falënderonin fëmijët për këtë aktivitet.



- ? - Bisedoni për situatën e dhënë.
- Si e vlerësoni aktivitetin e nxënësve?
- Diskutoni në klasë dhe organizoni edhe ju një aktivitet të tillë në shkollën tuaj.

 Shkolla është institucion edukativo-arsimor. Në shkollë punojnë: drejtori, zëvendësdrejtori, sekretari i shkollës, psikologu, pedagogu, mësuesit, punonjësit e bibliotekës, infermieri/ja, punonjësit teknikë dhe shitëpiaku i shkollës. Shkolla është vendi ku nxënësit marrin mësim, edukohen dhe shoqërohen mes vete. Ata duhet t'i respektojnë rregullat e klasës dhe të shkollës. Çdo shkollë ka festën e saj në një ditë të veçantë, që quhet Dita e Shkollës. Në ditët e veçanta organizohen programe dhe aktivitete të ndryshme festive.


**Fjalët kyçe:** festë, aktivitet, shkollë, nxënës/e, prind, i ftuar.

31



### Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Shqyrtojmë situatat 1 dhe 2, të dhëna në libër. Së bashku, duke analizuar, identifikojmë disa festa që i festojmë në shkollë.



### Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Secili nxënës në fletorën e tij shkruan për festën që i pëlqen dhe e lexon para klasës.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin dhe përshkrimin e festave që festohen në shkollë.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Identifikon disa nga ngjarjet që organizohen në shkollë dhe rrethin e tij dhe shpjegon arsyet e këtyre manifestimeve.  
 Përshkruan ngjarje të ndryshme shoqërore e kulturore në vendbanimin e tij dhe i ndërlihd ato me objektet përkatëse.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.6 III.1,2,3,4 VI.8.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Festojmë së bashku

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton festat që festojmë në vendin tonë;
  - Tregon rëndësinë e këtyre festave;
  - Dallon festat kombëtare nga festat shtetërore.


**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Stuhi mendimesh (klaster)



Festojmë së bashku

**Situata 1.** Mësuesi u dha detyrë nxënësve që të paraqitnin me anë të vizatimit festën tonë kombëtare. Pasi ta bënin vizatimin, ata do ta përshkruanin atë para klasës. Andrra vizatoi flamurin kuqezi. Ajo tha se festa jonë kombëtare është 28 Nëntori - Dita e Pavarësisë së Shqipërisë. Sa bukur ishte kur u prezantuan punimet e nxënësve. Në klasë valëviteshin flamurët kombëtarë.



**Situata 2.** Ishte një ditë e bukur, 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës. Në qytet po valëviteshin flamurët e Kosovës. Ata ia kishin shtuar hijeshinë vendit tonë. Njerëzit ishin të lumtur që ecnin të lirë rrugëve të qytetit. Ata nderonin luftëtarët e rënë me buqeta lulësh.



- Çfarë mendon për situatat e mësipërme?
- Cili është dallimi në mes të festës kombëtare dhe festës shtetërore?
- Përshkruaj emocionet e tua në ditët e këtyre festave.
- Shkruaj nga një karakteristikë për secilën nga këto festa.



*Festa është ditë e shënuar, e cila lidhet me një ngjarje të rëndësishme historike dhe për të cilën çdo vit organizohen manifestime përkujtimore në nder të saj. Ditëve të festës institucionet zakonisht japin pushim sipas Ligjit për festat zyrtare, ashtu që punëtorët, studentët, nxënësit etj. të mund ta festojnë lirshëm ditën e tyre të shënuar. Dita e Flamurit është festë kombëtare e popullit shqiptar dhe ajo festohet kudo ku ka shqiptarë. Shtetërore është festë shtetërore e Republikës së Kosovës dhe atë festojnë të gjithë qytetarët e Kosovës që jetojnë brenda dhe jashtë saj.*



**Fjalet kyçe:** festë kombëtare, festë shtetërore, flamur, Kosovë, Shqipëri.





## Festojmë së bashku

**Situata 1.** Mësuesi u dha detyrë nxënësve që të paraqitnin me anë të vizatimit festën tonë kombëtare. Pasi ta bënin vizatimin, ata do ta përshkruanin atë para klasës. Andrra vizatoi flamurin kuqezi. Ajo tha se festa jonë kombëtare është 28 Nëntori - Dita e Pavarësisë së Shqipërisë. Sa bukur ishte kur u prezantuan punimet e nxënësve. Në klasë valëviteshin flamurët kombëtarë.



**Situata 2.** Ishte një ditë e bukur, 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës. Në qytet po valëviteshin flamurët e Kosovës. Ata ia kishin shtuar hijeshinë vendit tonë. Njerëzit ishin të lumtur që ecnin të lirë rrugëve të qytetit. Ata nderonin luftëtarët e rënë me buqeta lulësh.



- ? - Çfarë mendon për situatat e mësipërme?  
 - Cili është dallimi në mes të festës kombëtare dhe festës shtetërore?  
 - Përshkruaj emocionet e tua në ditët e këtyre festave.  
 - Shkruaj nga një karakteristikë për secilën nga këto festa.



*Festa është ditë e shënuar, e cila lidhet me një ngjarje të rëndësishme historike dhe për të cilën çdo vit organizohen manifestime përkujtimore në nder të saj. Ditëve të festës institucionet zakonisht japin pushim sipas Ligjit për festat zyrtare, ashtu që punëtorët, studentët, nxënësit etj. të mund ta festojnë lirshëm ditën e tyre të shënuar. Dita e Flamurit është festë kombëtare e popullit shqiptar dhe ajo festohet kudo ku ka shqiptarë. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është festë shtetërore e Republikës së Kosovës dhe atë festojnë të gjithë qytetarët e Kosovës që jetojnë brenda dhe jashtë saj.*



**Fjalët kyçe:** festë kombëtare, festë shtetërore, flamur, Kosovë, Shqipëri.

Çfarë dini për këto festa? (Mendimet paraqiten në formë klasteri.)



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
 Pyetje - përgjigje

Lexojmë situatat 1 dhe 2 dhe parashtrohen pyetjet e dhëna në tekst. Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve në tekst dhe do të tregojnë për rëndësinë e festave, ku festohen dhe kur festohen. Pas përgjigjeve të marra, analizojmë shkurtimisht, duke bërë dallimin e festës kombëtare nga ajo shtetërore.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
 Shkrim i lirë

Nxënësve iu shpërndahet fleta me listën e emrave të festave që i festojmë dhe shënojnë çfarë feste është:

28 Nëntori	F. kombëtare
7 Marsi	
17 Shkurti	F. shtetërore
12 Qershori	

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për rikujtimin e festave, rëndësinë, dallimin dhe njohjen e tyre.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Liston monumentet e trashëgimisë kulturore në vendbanimin e tij, i veçon në bazë të dedikimit, funksionimit dhe shpreh kujdes për to.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3,4,II.3,6, V.1,9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tim

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton mjediset natyrore dhe kulturore të paraqitura në fotografi;
  - Identifikon mjedise të tjera të vendit tonë;

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografia, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Imagjinatë e drejtuar

- Çfarë po shihni në foto?  
 Nxënësit shprehin mendimet e tyre duke treguar çka po shohin (lumë, fusha, shpella, monumente, statuja etj.).
- A i njihni këto vende?  
 Po ashtu, gjatë përshkrimit, tregojnë ku i kanë parë apo a i kanë vizituar dhe a i njohin? Së bashku i emërtojmë fotografitë nga njohuritë që i shprehin nxënësit (p.sh., Gryka e Rugovës, Drini i Bardhë, Prishtina, Shpella e Gadimes etj.).

Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tim



**Situata 1.** Nxënësit e klasave të treta organizuan një ekskursion. Ata do të vizitonin disa nga bukuritë natyrore dhe kulturore të vendit tonë. Ndajësia e parë ishte në shpellën e Gadimes. Ata u mahnitën me bukuritë që panë brenda shpellës. Pastaj, vazhduan rrugën për në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", ku u njohën me historikun e familjes Jashari. Më pas vazhduan me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", ku u njohën me arkitekturën e veçantë të saj dhe me dorëshkrimet e ndryshme që ndodhen aty. Në fund vizituan edhe Monumentin e Skënderbeut në Prishtinë. Sa krenarë ndiheshin nxënësit për jetën dhe veprën e heronjve tanë kombëtarë.




Shpella e Gadimes



Kompleksi Memorial "Adem Jashari"



Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"



Monumenti i Skënderbeut



- Bisedo për situatën e dhënë.
- A i ke vizituar këto vende?
- Merr informacione mbi rëndësinë që kanë këto vende.
- Gjej edhe vende të tjera që tregojnë bukuritë natyrore dhe kulturore të vendit tonë.




*Vendi ynë është Republika e Kosovës. Ajo ka shumë vende të rëndësishme që duhen vizituar. Përmes tyre tregohet historia e vendit tonë. Duke e njohur historinë e vendit tonë, njohim paraardhësit, por edhe veten tonë. Ne duhet të kujtojmë me respekt historikun e këtyre vendeve dhe të kujdesemi për mirëmbajtjen e tyre.*

**Fjalët kyçe:** kulturë, histori, respekt, mirëmbajtje.

Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tim



**Situata 1.** Nxënësit e klasave të treta organizuan një ekskursion. Ata do të vizitonin disa nga bukuritë natyrore dhe kulturore të vendit tonë. Ndajësia e parë ishte në shpellën e Gadimes. Ata u mahnitën me bukuritë që panë brenda shpellës. Pastaj, vazhduan rrugën për në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", ku u njohën me historikun e familjes Jashari. Më pas vazhduan me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", ku u njohën me arkitekturën e veçantë të saj dhe me dorëshkrimet e ndryshme që ndodhen aty. Në fund vizituan edhe Monumentin e Skënderbeut në Prishtinë. Sa krenarë ndiheshin nxënësit për jetën dhe veprën e heronjve tanë kombëtarë.



Shpella e Gadimes



Kompleksi Memorial "Adem Jashari"



Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"



Monumenti i Skënderbeut



- Bisedo për situatën e dhënë.
- A i ke vizituar këto vende?
- Merr informacione mbi rëndësinë që kanë këto vende.
- Gjej edhe vende të tjera që tregojnë bukuritë natyrore dhe kulturore të vendit tonë.



Vendi ynë është Republika e Kosovës. Ajo ka shumë vende të rëndësishme që duhen vizituar. Përmes tyre tregohet historia e vendit tonë. Duke e njohur historinë e vendit tonë, njohim paraardhësit, por edhe veten tonë. Ne duhet të kujtojmë me respekt historikun e këtyre vendeve dhe të kujdesemi për mirëmbajtjen e tyre.

**Fjalët kyçe:** kulturë, histori, respekt, mirëmbajtje.

33



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
Përvijim i të menduarit

Shqyrtojmë situatën 1, të dhënë në libër. Duke analizuar, marrim mendime të tjera nga nxënësit, të cilët tregojnë për vende të tjera që kanë vizituar në vendin tonë së bashku me familjet e tyre.




**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
Harta semantike

Plotësojmë tabelën, duke përmendur bukuritë e vendit dhe gjërat që u përmendën më lart, me pyetjet:

- Shkruaj pesë mjedise natyrore dhe kulturore në R. e Kosovës?
- Cili është vendi që të ka pëlqyer më shumë?
- Cilat janë bukuritë natyrore që përmendëm apo emërtuam në fotografitë më lart?

Malet e Sharrit



Shpella e Gadimes

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për emërtimin e fotografive të paraqitura, duke treguar njohuritë paraprake për mjediset natyrore e kulturore, si dhe për punimin e hartës semantike me mjediset natyrore e kulturore të vendit tonë.

**Detyrë:**

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Liston vendbanimet e të afërmeve të tij, brenda dhe jashtë vendit dhe tregon ku gjenden ato.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.2, III.1,2 V.8 VI.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon për ndonjë anëtar të familjes se ku jeton;
- Analizon situatën e dhënë;
- Identifikon vendet e të afërmeve se ku jetojnë, brenda e jashtë vendit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor, internet.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Stuhi mendimesh

Të gjithë me radhë kanë për të treguar për një anëtar të familjes së ngushtë ose të gjerë dhe vendin ku jeton. Në tabelë do të shënohen të gjitha të dhënat.

Emri i familjarit	Vendi ku jeton



V. Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme

Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme

Me vite jam larguar,  
i dashur Atdhe,  
por nuk të kam harruar,  
se shumë i ëmbël je.

Të fala të dërgoj,  
këndej ku jam Atdhe,  
gjithnjë po të kujtoj,  
se birin tënd më ke.

Asdreni



- Diskuto për vargjet e mësipërme.
- Pse njerëzit janë larguar nga atdheu?
- Çfarë mendon ti për njerëzit që jetojnë jashtë Kosovës?
- Shkruaj një këshillë për ta.

**Situata 1.** Ne kemi farefis të gjerë, por nuk shihemi shpesh, sepse ata jetojnë në vende të ndryshme. Ne jetojmë në Prishtinë, xhaxhai im jeton në Gjakovë, ndërsa halla në Gjiçan. Gjyshërit e mi jetojnë në Pejë, tezia ime në Gjermani dhe disa nga kushërinjtë e mi jetojnë në Zvicër.

Në familjen tonë, ne vendosëm që ta caktonim një ditë në vit dhe ta quanim Dita e Farefisit. Ne menduam që t'i ftonim të gjithë që për pushimet e verës të takoheshim te ne në Prishtinë. Nëna dhe babai filluan që t'i bënin ftesat nëpërmjet telefonave. Të gjithë shprehën gëzim për këtë ide.

- Analizoje situatën e dhënë.
- A ke ti të afërm që jetojnë jashtë Kosovës? Nëse po, trego se a ndien mall për ta.
- Pyeti ata se pse jetojnë jashtë Kosovës dhe analizo në klasë përgjigjet e tyre.



Shumë njerëz jetojnë larg atdheut të tyre. Ata jetojnë në vende të ndryshme, por asnjëherë nuk i harrojnë të afërmit. Në rast festash apo organizimesh të ndryshme, ata kthehen në vendin e tyre. Kur kthehen prapë atje, gjithmonë me vete marrin gjëra me vlerë, të cilat ua kujtojnë vendin ku kanë lindur. Dhuratë e bukur për ta është një fotografi me pamje të qytetit, një kartolinë, një libër, apo gjëra të tjera që i ruajnë me dashuri. Kudo që të jetojnë, ne duhet të mos i harrojmë gjuhën, traditat dhe zakonet. Gjuha shqipe bashkon tërë shqiptarët që jetojnë brenda dhe jashtë atdheut.

Fjalët kyçe: dhuratë, simbol, takim.

35

Pasi të përmendin të gjitha, do të diskutojmë se si jetojnë ata dhe a kanë shoqëri, cila është gjuha që ata e flasin etj.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
 Diskutim i përbashkët


Lexohet situata e dhënë në libër dhe bisedohet për vendet e përshkruara, si dhe mënyrat e shkëmbimit të përvojave të tyre dhe traditat nga vendet që vijnë. Analizojmë edhe disa pyetje të parashtruara, si:

- Në cilën kohë takoheni me të afërmit tuaj që jetojnë jashtë vendit?
- Cilat janë dhuratat që shkëmbeni më së shpeshti?



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
 Diagrami i Venit

Përmes një flete të punuar me diagram, nxënësit tregojnë se ku jetojnë të afërmit e tyre.



### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e vendeve të tjera dhe përgjigjet e dhëna, duke u bazuar në tekstin e lexuar dhe identifikimin e të afërmeve që jetojnë në vende të ndryshme.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon dallimet dhe ngjashmëritë (në sjellje, në gjuhë, në veshje, në afinitete etj.) e të afërmeve të tij brenda dhe jashtë vendit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,2, III.1, V.8, VI.3,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1, 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ruajmë traditat tona

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Analizon konceptin kulturë dhe traditë;
- Vlerëson ruajtjen e traditave;
- Diskuton për llojet e traditave të vendeve të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor, internet.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Klaster

Në mes të tabelës, shënohen fjalët traditë dhe kulturë. Merren mendimet e nxënësve dhe shkruhen përreth se çka ata mendojnë që janë traditë dhe kulturë e vendit tonë.



Ruajmë traditat tona

**Situata 1.** Në familjen e Ardit gjithçka po gumëzohet. Të gjithë po bëjnë përgatitjet për Ditën e Faresit. Do të jetë shumë emocionuese. Ata menduan të përgatisnin ushqime tradicionale dhe kishin vendosur të visheshin me veshje popullore. E gjithë kjo menduan se do të pritej shumë mirë nga të gjithë, sidomos nga fëmijët që kishin lindur jashtë shtetit tonë. Ata do të këndojnë e kërcëjnë me këngë e valle popullore. Kjo do të bëjë që të ruhen traditat e vendit tonë.




- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Çfarë mendoni ju për këtë organizim?
- Pse janë të gëzuar fëmijët?
- Çfarë bëni ju në familjen tuaj për t'i ruajtur traditat?



**Situata 2.** Në Ditën e Faresit, ne me kushërinjtë tanë, që jetojnë jashtë vendit tonë, vendosëm të mësonim fjalë të gjuhëve të huaja. Secili na mësonte fjalë përshëndetëse në gjuhën e vendit në të cilin jetonte. Vizatuam flamurët e atyre vendeve dhe flamurin tonë. Më pas u interesuam që të dinim se cilat ishin ushqimet e tyre më të pëlqyera, veshjet që ata përdornin në ditët e zakonshme dhe në ditë festash. Donim t'i dinim marrëdhëniet që ata kishin me njëri-tjetrin dhe zakonet e tyre. Ne e kuptuam se sa të ngjashëm, por edhe sa të ndryshëm janë njerëzit. Çdo njeri ka të drejtë të jetojë sipas zakoneve të tij në komunitetin ku jeton.



- ? - Bisedoni për situatën e dhënë.
- Përmendni ngjashmëritë që kanë njerëzit mes vete.
- Po ndryshimet?
- A është e rëndësishme të mësohen edhe gjuhë dhe kultura të huaja? Pse?

 Njerëzit janë të njëjtë, por edhe ndryshojnë në shumë gjëra. Ata kanë kultura të ndryshme, varësisht prej vendit se ku jetojnë. Ata dallojnë për nga gjuha që flasin, simbolet etnike dhe kulturore, besimet fetare dhe zakonet që kanë në komunitetet ku banojnë. Të gjithë njerëzit, pavarësisht se ku jetojnë apo çfarë gjuhe flasin, kanë të drejta të barabarta.

Fjalët kyçe: kulturë, të ngjashëm, të ndryshëm, komunitet, simbol, gjuhë, zakon, traditë.

37



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
 DRTA

Lexohet situata 1 dhe pastaj parashtrohen pyetje për pjesën e lexuar dhe çfarë mendojnë që do të mësojnë në situatën 2. Kështu vazhdohet deri në fund të tekstit dhe pastaj parashtrohen edhe pyetjet që janë në libër dhe vlerësohet ruajtja e traditave, po ashtu edhe rëndësia e të njohurit të traditave e kulturave të ndryshme.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
 Mendim i lirë

Me anë të projektorit, paraqiten disa video të shkurtra që lidhen me kulturën e disa popujve të ndryshëm, p.sh. shqiptarëve, egjiptianëve, gjermanëve etj. Diskutohet për llojet e veshjeve, muzikës, ushqimeve, gjuha e shumë detaje të tjera të kulturave e traditave, të vëzhguara në projektor.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen për përgjigjet e dhëna dhe pjesëmarrjen në diskutim.

**Detyrë:**

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** III.1.2, IV.4.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mjedisi ku jetoj

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Vlerëson aksionet vullnetare për pastrimin e mjedisit;
- Përzgjedh rregulla dhe ilustrime për pastrimin e mjedisit;
- Promovon ruajtjen e mjedisit natyror.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Stuhi mendimesh


Nxitet diskutimi me anë të pyetjes:

- Pse duhet të kujdesemi për mjedisin?



VI. Raporti njeri-natyrë  
Mjedisi ku jetoj

**Situata 1.** Edhe pak ditë, Ana feston ditëlindjen e saj të 8-të. Meqenëse ditëlindjet e tjera ajo i kishte festuar në klasë, këtë vit asaj iu kujtua një ide më interesante. Bisedoi me prindërit që për ditëlindje të organizonte një festë në një prej fushave më të bukura të fshatit ku jetonin. Kjo fushë, sipas Anës, është më e bukura, sepse afër saj shtrihet lumi i fshatit dhe matanë tij është një mal me shumë drurë që lëshojnë erë të këndshme. Ana mendon se ai vend është shumë i përshtatshëm për aktivitete të ndryshme. Por, Ana kishte menduar edhe një propozim për shokët. Ajo u tha prindërve se do t'u kërkonte që të mos merrnin pajisje teknologjike me vete në këtë festë. Po ashtu, Ana vendosi të merrte me vete qese letre, në mënyrë që, pas përfundimit të festës, bashkë me shokët e shoqet, t'i grumbullonin të gjitha mbeturinat.



- Diskutoni për situatën e dhënë.
- Cila është dëshira e Anës për ditëlindjen e saj?
- Çfarë bisedoi Ana me prindërit e saj?
- Çfarë mendoni ju për idenë e Anës?
- Pse është e rëndësishme mbledhja e mbeturinave në natyrë?



Mjedisi jetësor është hapësira në të cilën jetojmë. Ai është i të gjithëve, prandaj të gjithë duhet të kujdesemi për të. Njeriu duhet të kujdeset që të mos e dëmtojë atë. Shëndeti i njeriut është i lidhur ngushtë me pastërtinë e mjedisit.



**Fjalët kyçe:** mjedisi, gjelbërim, festë, ditëlindje, shoqëri.





## VI. Raporti njeri-natyre Mjedisi ku jetoj

**Situata 1.** Edhe pak ditë, Ana feston ditëlindjen e saj të 8-të. Meqenëse ditëlindjet e tjera ajo i kishte festuar në klasë, këtë vit asaj iu kujtua një ide më interesante. Bisedoi me prindërit që për ditëlindje të organizonte një festë në një prej fushave më të bukura të fshatit ku jetonin. Kjo fushë, sipas Anës, është më e bukura, sepse afër saj shtrihet lumi i fshatit dhe matanë tij është një mal me shumë drurë që lëshojnë erë të këndshme. Ana mendon se ai vend është shumë i përshtatshëm për aktivitete të ndryshme. Por, Ana kishte menduar edhe një propozim për shokët. Ajo u tha prindërve se do t'u kërkonte që të mos merrnin pajisje teknologjike me vete në këtë festë. Po ashtu, Ana vendosi të merrte me vete qese letre, në mënyrë që, pas përfundimit të festës, bashkë me shokët e shoqet, t'i grumbullonin të gjitha mbeturinat.



- Diskutoni për situatën e dhënë.
- Cila është dëshira e Anës për ditëlindjen e saj?
- Çfarë bisedoi Ana me prindërit e saj?
- Çfarë mendoni ju për idenë e Anës?
- Pse është e rëndësishme mbledhja e mbeturinave në natyrë?



Mjedisi jetësor është hapësira në të cilën jetojmë. Ai është i të gjithëve, prandaj të gjithë duhet të kujdesemi për të. Njeriu duhet të kujdeset që të mos e dëmtojë atë. Shëndeti i njeriut është i lidhur ngushtë me pastërtinë e mjedisit.

38

Fjalët kyçe: mjedisi, gjelbërim, festë, ditëlindje, shoqëri.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Puna me tekst

Lexohet situata në heshtje dhe nxitet debati:

- Çfarë mendoni për aktivitetin që organizoi Ana?
- A jeni aktivë për mbrojtjen e mjedisit? Si?
- Çfarë mund të bëni më shumë për natyrën?

Nxënësit në grupe shkruajnë nga dy këshilla me ilustrime, për të promovuar mjedisin e pastër. Këshillat dhe ilustrimet e shënuara mund të vendosen në ndonjë kënd të klasës apo të shkollës.



## Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Tryezë e rrumbullakët

Nxënësit tregojnë ndonjë shembull të pjesëmarrjes së tyre në një organizim vullnetar për pas-trimin e mjedisit.

I bëjnë pyetje njëri-tjetrit.

Hulumtohet më shumë në internet për mbrojtjen e natyrës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për promovimin, përzgjedhjen dhe pjesëmarrjen në aksione vullnetare për pas-trimin e mjedisit.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon objekte dhe dukuri natyrore (lumi, liqeni, fusha, kodra, mali, era etj.) që kanë shërbyer dhe i shërbejnë njeriut për udhëtim, për ushqim, për energji etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,2 III.2, V.8 VI.1,2 .

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pasuritë natyrore të vendit tim

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Emërton vendet e paraqitura në fotografi;
- Identifikon vendet me fotografi të marra nga interneti;
- Plotëson tabelën e paraqitur me vendet e dhëna.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4, projektor, internet.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Njeriu dhe natyra, shkathtësi për jetë, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Parashikim me terma paraprakë

Përmes projektorit, do të shfaqen disa fotografi të bukurive natyrore të vendit tonë (Drini i Bardhë, Brezovica, Shpella e Gadimes, Shpella e Radacit etj.). Emërtojmë secilën fotografi, duke dhënë një përshkrim, si: ujëvarë, male, shpellë, minierë etj.



## Pasuritë natyrore të vendit tim



**Situata 1.** Ishte fundjavë dhe Hana ishte shumë e gëzuar. Ajo po shikonte një film ku personazhet e tij ishin fëmijë nga Australia. Papritur, fëmijët filluan të këndonin himnin e shtetit të tyre. Vargu që i mbeti në mend Hanës ishte "ne kemi tokë të artë..."


Hana, si kureshtarë që është, pyeti babanë e saj se çfarë nënkuptonin me *tokë të artë*. Babai sqaroi pa përtesë që kjo shprehje zakonisht përdoret për pasuritë natyrore të një vendi. Hana vazhdoi me kureshtjen e saj dhe donte të dinte se a ishte vetëm Australia ajo që kishte pasuri natyrore.

Babai qeshi ëmbël dhe lëvizi kokën lehtas në shenjë mohimi.

- Jo, e dashur, - edhe vendi ynë ka shumë pasuri natyrore prej të cilave ne jetojmë.

A s' të duket ty pasuri natyrore Brezovica jonë? A s' të mrekullojnë ty Malet e Sharrit me madhësinë e tyre? Po Ujëvarat e Mirushës, a s' kanë qenë pamja jote më e pëlqyer në verën e kaluar?

- Përveç këtyre e shumë të tjerave, - vazhdoi babai, - Kosova jonë ka shumë pasuri nëntokësore. Tani ti do të kërkosh në internet dhe do të gesh tri pasuritë më të mëdha nëntokësore që ka vendi ynë. Hana, krenare për vendin e saj, filloi të kërkonte në internet pas kërkesës së babait.



- Diskuto për situatën e dhënë.
- Cilin prej vendeve të mësipërme e ke vizituar?
- Cili të ka pëlqyer më shumë? Pse?
- Trego për ndonjë vend tjetër, jashtë Kosovës, që ti e ke vizituar.
- Në situatën e mësipërme, babai e këshilloi Anën të kërkonte informacione në internet. Analizo pse është i dobishëm një veprim i tillë.



*Pasuritë natyrore të çdo vendi kanë rëndësinë e vet. Kosova njihet për pasuri minerale, si: qymyr, plumb, zink, bakër, hekur etj. Shteti ynë duhet t'i shfrytëzojë me kujdes këto pasuri dhe duhet t'i mbrojë nga keqpërdorimi.*

**Fjalët kyçe:** mjedis, pasuri, tokë bujqësore, pyll, mal.

39



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

### Përpunimi i përmbajtjes

Dëgjim dhe diskutim

Lexohet mësimi nga libri, duke u munduar të ndalemi dhe të diskutojmë për situatën e dhënë. Pasi të përfundohet leximi dhe analizimi i mësimi, vazhdohet duke parashtruar pyetjet që janë në libër dhe diskutohet rreth tyre.

Hulumtojmë në internet për Shpellën e Gadimes, Ujëvarat e Mirushës, Minierën e Trepçës dhe Drinin e Bardhë.



## Përforcimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Tabela e koncepteve

Plotësojnë tabelën me njohuritë që kanë për këto pasuri natyrore të vendit tonë:

Shpella e Gadimes	Ujëvarat e Mirushës	Miniera e Trepçës	Drini i Bardhë
Lipjan	Malishevë	Mitrovicë	Radac

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin e pasurive natyrore, përgjigjet e dhëna dhe plotësimin e tabelës në mënyrë korrekte.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Njeriu e ndryshon natyrën

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Përshkruan të mirat që i marrim nga natyra;
- Analizon sjelljen e njeriut në raport me natyrën;
- Vlerëson rëndësinë e ruajtjes së natyrës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Pyetja sjell pyetjen

Kërkohet nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çka është natyra?
- Çfarë të mira marrim nga natyra?
- Çfarë gabimi bëjmë ne në raport me natyrën?



Njeriu e ndryshon natyrën

**Situata 1.** Mësuesja kërkoi nga nxënësit që të shkruanin gjithçka që dinin për ndryshimet që i bëri njeriu në natyrë. Njëri nga nxënësit e klasës e lexoi punimin e tij.

*Natyra është gjithçka që na rrethon. Ajo na solli shumë bukuri dhe të mira, të cilat njeriu i shfrytëzoi për ta përmirësuar jetën e tij. Me gurët e drurët e natyrës, njerëzit e parë ndërtuan shtëpitë, urat e rrugët. Me ujën ujitën fushat e mbjella me drithëra, pemë e perime, me të cilat siguruan ushqimin për veten dhe për kafshët.*

*Njeriu ndërtoi njësjelësin dhe e solli ujën në shtëpitë tona. Ai shfrytëzoi pasuritë natyrore, si thëngjillin, naftën e ujin për të prodhuar energji elektrike, të cilën e solli në shtëpitë tona. Njeriu, për përfitimet e veta, e shkatërroi pyllin. Shirat shpejt e vërshuan fshatin, më pas fshatarët mbollën sërish drurë dhe që nga ajo kohë ai vend u quajti "Lisat e xha Mani".*


*Nga kjo histori unë kuptova që njeriu edhe mund ta dëmtojë natyrën.*



- Ç'është natyra?
- Çfarë të mirash marrim nga natyra? Pse?
- Çfarë mendon ti për veprimin e tregtarit?
- Përmend shembuj të ndryshëm ku njeriu e dëmton natyrën.



*Është e domosdoshme ruajtja e natyrës. Njeriu merr shumë të mira nga natyra. Ai i shfrytëzon ato për t'i përmirësuar kushtet e jetesës. Ndonjëherë njeriu me moskujdesinë e tij ndikon negativisht në këtë mjedis, duke dëmtonuar natyrën. Mungesa e ruajtjes dhe e kujdesit sjell ndolje të vazhdueshme të ujit, të ajrit e të tokës, si dhe shumë probleme të tjera. Pasojat janë mjaft të dukshme. Kujdesi për natyrën dhe mbrojtja e mjedisit janë detyrë e çdo pjesëtarit të shoqërisë njerëzore.*





## Njeriu e ndryshon natyrën

**Situata 1.** Mësuesja kërkoj nga nxënësit që të shkruanin gjithçka që dinin për ndryshimet që i bëri njeriu në natyrë. Njëri nga nxënësit e klasës e lexoi punimin e tij.

*Natyra është gjithçka që na rrethon. Ajo na solli shumë bukuri dhe të mira, të cilat njeriu i shfrytëzoi për ta përmirësuar jetën e tij. Me gurët e drurët e natyrës, njerëzit e parë ndërtuan shtëpitë, urat e rrugët. Me ujën ujitën fushat e mbjella me drithëra, pemë e perime, me të cilat siguruan ushqimin për veten dhe për kafshët.*

*Njeriu ndërtoi ujësjellësin dhe e solli ujën në shtëpitë tona. Ai shfrytëzoi pasuritë natyrore, si thëngjillin, nafën e ujin për të prodhuar energji elektrike, të cilën e solli në shtëpitë tona. Njeriu, po ashtu, i shfrytëzoi bimët për mjekimin e sëmundjeve të ndryshme, ndërsa kafshët i përdori për bartje, udhëtime, ushqim dhe veshe. Ai vazhdimisht e ndryshoi natyrën për të jetuar sa më mirë.*

- Mësuese, mua po më kujtohet historia që gjyshi ma ka treguar për "Lisat e xha Manit", kur një tregtar mobilieësh preu të gjithë drurët në pyllin afër fshatit. Xha Mani nuk ishte i pajtimt që të priteshin drurët, sepse e dinte që fshati do të përmytejt nga shirat. Tregtari, për përfitimet e veta, e shkatërroi pyllin. Shirat shpejt e vërsjuan fshatin, më pas fshatarët mbollën sërish drurë dhe që nga ajo kohë ai vend u quajt "Lisat e xha Manit". Nga kjo histori unë kuptova që njeriu edhe mund ta dëmtoj natyrën.



- Ç'është natyra?
- Çfarë të mirash marrim nga natyra? Pse?
- Çfarë mendon ti për veprimin e tregtarit?
- Përmend shembuj të ndryshëm ku njeriu e dëmton natyrën.



*Është e domosdoshme ruajtja e natyrës. Njeriu merr shumë të mira nga natyra. Ai i shfrytëzon ato për t'i përmirësuar kushtet e jetesës. Ndonjëherë njeriu me moskujdesin e tij ndikon negativisht në këtë mjedis, duke dëmtuar natyrën. Mungesa e ruajtjes dhe e kujdesit sjell ndotje të vazhdueshme të ujit, të ajrit e të tokës, si dhe shumë probleme të tjera. Pasojat janë mjaft të dukshme. Kujdesi për natyrën dhe mbrojtja e mjedisit janë detyrë e çdo pjesëtarit të shoqërisë njerëzore.*

40

Fjalët kyçe: natyrë, kujdes, respekt, dëmtim, shfrytëzim.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Lexim i drejtuar

Komentohen ilustrimet e paraqitura në libër, duke iu përgjigjur pyetjeve:

1. Çfarë po shohim në fotografi?

Pastaj, lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve të librit.

Pas diskutimit të situatës së dhënë, lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Pse është e rëndësishme ruajtja e natyrës?
- Çka sjell mungesa e ruajtjes dhe e kujdesit?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i lirë

Në fletore pune, në faqen 32, nxënësit plotësojnë detyrën e dytë. Pas plotësimit të detyrës, disa nga nxënësit i lexojnë ato.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e natyrës dhe analizën e situatës, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, si dhe për rolin e ruajtjes së natyrës.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Ndotja e mjedisit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Krahason mjedisin e pastër me mjedisin e ndotur;
- Analizon situatën e dhënë;
- Vlerëson rëndësinë e mjedisit të pastër.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Xhigsou

Kërkohet nga nxënësit të ndahen në grupe dhe të shkruajnë çfarë dinë për ndotjen e natyrës dhe secili grup të shkruajë këshillë për detyrën që i është dhënë:

Grupi 1: Ndotja e tokës;

Grupi 2: Ndotja e ujit;

Grupi 3: Ndotja e ajrit.


Secili grup prezanton punën e bërë dhe diskutohet rreth tyre.



## Ndotja e mjedisit



**Situata 1.** Diellza dhe Patriku morën një iniciativë që, afër çdo lumi dhe koshi plehrash, të vendosnin thënieën: “Mos e ndot Tokën, sepse është planeti ku ne jetojmë”. Ata kishin vepruar kështu, sepse diçka njerëz të përgjegjshëm vazhdimisht po hidhnin mbeturina në lumë dhe në vende të tjera publike.



- Analizo situatën e dhënë. Çfarë mendon për veprimin e fëmijëve?
- Pse është e rëndësishme që mbeturinat të hidhen në vende të caktuara?
- Shkruaj një këshillë për njerëzit e pakujdesshëm.



Njeriu me punën e tij e ndryshoi shumë mjedisin natyror, me qëllim që të krijonte një jetë më të mirë. Por, njeriu shpesh edhe i bën dëm natyrës, duke mos e mbrojtur dhe duke mos treguar kujdes ndaj saj. Është shumë e rëndësishme që ne të mësojmë se si duhet të kujdesemi për ambientin ku jetojmë. Njeriu jeton shëndetshëm vetëm në një mjedis të pastër.

Fjalët kyçe: mjedis, kujdes, mbeturina, pastërti.

41



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Lexim i drejtuar

Komentohen ilustrimet e paraqitura në libër, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shohim në fotografi?
- A mendoni se fëmijët janë duke vepruar mirë?

Pastaj, një nxënës e lexon situatën e dhënë dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve të librit. Pas diskutimit të situatës së dhënë, lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Si e ndryshoi njeriu mjedisin e tij?
- Pse e ndryshoi njeriu mjedisin?
- Pse është e rëndësishme të kujdesemi për mjedisin?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Vizatim i lirë

Kërkohet nga nxënësit që në fletën A4 të vizatojnë një mjedis të pastër dhe një mjedis të ndotur. Më pas, 2-3 nxënës bëjnë krahasimin mes dy pjesëve të mjedisit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për krahasimin e mjedisit të pastër dhe atij të ndotur, analizën e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe për rolin e mjedisit të pastër.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënët të temës:**

Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kujdesem për bimët dhe për kafshët

**Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:**

- Përshkruan cilësitë e kafshës dhe bimës që i pëlqejnë;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Vlerëson rëndësinë për kujdesin ndaj bimëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

Përshkrim i vizatimit

Nxënësit vizatojnë kafshën dhe bimën e pëlqyer në fletë A4, pastaj 2-3 nxënës prezantojnë para klasës vizatimin e bërë, duke përshkruar cilësitë e asaj kafshe dhe bime.

Ja një përshkrim i mundshëm:


Në këtë vizatim kam vizatuar qenin dhe luleborën. Qeni është kafshë shtëpiake, besnik, rojtar i shtëpisë, kurse lulebora është e bardhë, ka aromë të mirë dhe është bimë shëruese.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathësive:**


**Përpunimi i përmbajtjes**

Lexim i drejtuar




**Situata 1.** Një pjesë e familjes së Matit jeton në fshat. Ai gëzohet shumë kur shkon atje, sepse mëson gjëra të reja nga gjyshi i tij. Këtë herë gjyshi i foli Matit për bimët dhe kafshët e vendit tonë. Kur dolën në kopsht, duke punuar, gjyshi fliste:





Njeriu kujdeset për rritjen dhe kultivimin e bimëve, sepse ato janë shumë të rëndësishme për të. Bimët i përdorim për ushqim, për ta pastruar ajrin, sepse lëshojnë shumë oksigjen, për ta zbkuruar mjedisin etj. Në natyrë ka edhe bimë mjekësore, të cilat njeriu i përdor për shërimin e sëmundjeve të ndryshme.

Kafshët që jetojnë në ferma, si: lopët, dhitë e delet, janë kafshë shtëpiake, sepse njeriu kujdeset për rritjen e tyre dhe ua siguron ushqimin, ndërsa kafshët, të cilat jetojnë në pyll, ku strehohen dhe e gjejnë ushqimin vetë, janë kafshë të egra. Në pyjet tona rriten: dhelpira, lepuri, rrëqebulli, ariu, dreri, dhia e egër, ujku e shumë kafshë të tjera.



- Çfarë përfiton njeriu nga bimët?
- Çfarë përfiton njeriu nga kafshët?
- Analizo si do të ishte jeta e njeriut pa bimë dhe pa kafshë.
- Përmend disa bimë dhe kafshë të zonës ku ti jeton.



Bimët janë organizma të gjallë që e sigurojnë vetë ushqimin. Ato janë shumë të dobishme për njeriun. Jeta e bimëve në një vend quhet florë. Njeriu kultivon bimë të ndryshme për ushqim dhe nevoja të tjera jetësore. Bimët kanë nevojë për përkujdesjen tonë, si për ujtin, plehërimin etj.

Jeta e kafshëve në një vend quhet faunë. Në vendin tonë rriten shumë kafshë e shpendë. Njerëzit i duan dhe kujdesen shumë për to. Por, përveç dashurisë që u japim, duhet edhe një përkujdesje për shëndetin e tyre. Kafshët duhet të vaksinohen dhe të kontrollohen rregullisht nga veterineri.

Fjalët kyçe: kafshë, bimë, kujdes, kultivim, florë, faunë.

43

- Cilat janë kafshët e egra? Pse quhen të egra?
- Cilat kafshë rriten në pyjet tona?



### Përforcimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Diskutim i drejtuar

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohen pyetjet:

- Si e krijojnë bimët ushqimin?
- Çka është flora?
- Çfarë përfiton njeriu nga bimët?
- Si duhet të kujdesemi për bimët?
- Çka është fauna?
- Si duhet të kujdesemi për kafshët?
- Analizo si do të ishte jeta e njeriut pa kafshë dhe bimë?
- Përmend disa bimë dhe kafshë të zonës ku jeton ti?

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin dhe estetikën e vizatimit, diskutimin e situatës dhe informacionit të dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrezultatin e orës mësimore:*

---



---

Në tabelë, shkruhet titulli i mësimi: “Kujdesi ndaj bimëve dhe kafshëve” dhe diskutimi fillon me pyetjet:

- Për çfarë mendoni se bën fjalë ky mësim? Pse mendoni kështu? (Nxënësit japin mendimet e tyre.)

Ja një përgjigje e mundshme e nxënësve:

Në këtë mësim mendoj që bëhet fjalë për bimët dhe kafshët, se si duhet të kujdesemi ne për bimët dhe kafshët, që ato të rriten. Mendoj kështu sepse vetë fjala kujdes po na tregon që mësimi ka të bëjë me kujdesin ndaj bimëve dhe kafshëve.

Më pas, lexohet me ndalesa situata e dhënë në libër.

Një nxënës lexon paragrafin e parë.

Në ndalesën e parë drejtohen këto pyetje:

- Ku jeton familja e Matit?
- Pse gëzohet Mati kur shkon te gjyshi?
- Për çfarë i foli gjyshi Matit?

Nxënësi i dytë lexon paragrafin e dytë. Në ndalesën e dytë drejtohen këto pyetje:

- Për kë kujdeset njeriu?
- Pse kujdeset për to?
- Për çfarë i përdor bimët njeriu?

Nxënësi i tretë lexon paragrafin e tretë. Në ndalesën e tretë drejtohen këto pyetje:

- Cilat janë kafshët shtëpiake? Pse quhen kafshë shtëpiake?

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; I.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Uji është jetë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Komenton ilustrimin e dhënë;
- Diskuton situatën e dhënë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

Teknika pesëvargësh

Udhëzohen nxënësit që në mes të fletës A4 ta shkruajnë emrin e temës. Pastaj nxënësit, nën emër, individualisht gjejnë 2 mbiemra, 3 folje, 1 fjali me katër fjalë dhe sinonimin e emrit. Pastaj, disa nga nxënësit i lexojnë pesëvargëshat e formuar.

Ja një shembull i dhënë:

\_\_\_\_\_ Uji \_\_\_\_\_ (Emër)  
 \_\_\_\_\_ i lëngshëm \_\_\_\_\_ i pangjyrë \_\_\_\_\_ (Dy mbiemra)  
 \_\_\_\_\_ rrjedh \_\_\_\_\_ pastron \_\_\_\_\_ mbush \_\_\_\_\_ (Tri folje)  
 \_\_\_\_\_ Uji \_\_\_\_\_ është \_\_\_\_\_ burim \_\_\_\_\_ i jetës \_\_\_\_\_ (Një fjali me katër fjalë)  
 \_\_\_\_\_ Jetë \_\_\_\_\_ (Sinonim i emrit)



Uji është jetë

**Situata 1.** Ana dhe gjithë shoqet dhe shokët e klasës, pas një loje të gjatë me top, u ulën që të pushonin nën hijen e një peme, pranë oborrit të shkollës. Papritur, Mati u shfaq me një shishe me ujë në dorë. Ai u tha shokëve që t'i mbushnin gotat me kujdes dhe të mundoheshin që, me ujin që kishin në shishe, ta kalonin etjen të gjithë. Ana piu gotën e saj të ujit dhe e falënderoi Matin. Jo rastësisht, në atë moment asaj iu kujtuuan fjalët e mësueses: "Pa ujë nuk ka jetë".



- Çfarë po bënin fëmijët?
- Pse Mati u kërkoi që të ishin të kujdesshëm?
- Trego disa karakteristika të ujit.
- Pse është i rëndësishëm uji për jetën tonë?
- Si mund ta mbrojmë ujin nga ndotja?



Uji është i rëndësishëm për një jetë të shëndetshme, prandaj ne duhet ta ruajmë atë, ta mbajmë të pastër dhe ta përdorim në mënyrë të arsyeshme. Uji është një nga elementet kryesore për jetën e njeriut, pasi, përveçqë është element i domosdoshëm për trupin tonë, atë e përdorim edhe për gatim, pastrim, ujitje etj. Kosova është vend i pasur me burime ujore. Dita Botërore e Ujit është më 22 mars.



**Fjalët kyçe:** ujë, i pastër, i domosdoshëm, ndotje, higjienë.



## Uji është jetë

**Situata 1.** Ana dhe gjithë shoqet dhe shokët e klasës, pas një loje të gjatë me top, u ulën që të pushonin nën hijen e një peme, pranë oborrit të shkollës. Papritur, Mati u shfaq me një shishe me ujë në dorë. Ai u tha shokëve që t'i mbushnin gotat me kujdes dhe të mundoheshin që, me ujin që kishin në shishe, ta kalonin etjen të gjithë. Ana piu gotën e saj të ujit dhe e falënderoi Matin. Jo rastësisht, në atë moment asaj iu kujtuan fjalët e mësueses: "Pa ujë nuk ka jetë".



- ? - Çfarë po bënin fëmijët?
- Pse Mati u kërkoi që të ishin të kujdesshëm?
- Trego disa karakteristika të ujit.
- Pse është i rëndësishëm uji për jetën tonë?
- Si mund ta mbrojmë ujin nga ndotja?



Uji është i rëndësishëm për një jetë të shëndetshme, prandaj ne duhet ta ruajmë atë, ta mbajmë të pastër dhe ta përdorim në mënyrë të arsyeshme. Uji është një nga elementet kryesore për jetën e njeriut, pasi, përveçqë është element i domosdoshëm për trupin tonë, atë e përdorim edhe për gatim, pastrim, ujëje etj. Kosova është vend i pasur me burime ujore. Dita Botërore e Ujit është më 22 mars.

44

**Fjalët kyçe:** ujë, i pastër, i domosdoshëm, ndotje, higjienë.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Komentohet ilustrimi i dhënë duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shohim në fotografi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?

Pastaj lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve të librit.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij duke iu përgjigjur pyetjeve:

1. Pse është i rëndësishëm uji?
2. Kush është ndotësi i ujit të pijshëm?
3. Sa litra ujë duhet të pihen në ditë?
4. Kur është Dita Botërore e Ujit?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e ilustrimit dhe diskutimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyrë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1, III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rëndësia e ujit për jetën e njeriut

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon rëndësinë e ujit;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Vlerëson rëndësinë e kursimit të ujit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektori.


**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
Klaster

U shpërndahen nxënësve fleta A4. Në mes shkruhet tema “Rëndësia e ujit” dhe kërkohet nga nxënësit të shkruajnë sa më shumë fjalë lidhur me rëndësinë e tij. Dy-tre nxënës i lexojnë fjalët e shkruara. Ja një shembull i dhënë:



Rëndësia e ujit për jetën e njeriut



**Situata 1.** Në të kaluarën, në shumë vende, jeta nuk ishte edhe aq e lehtë. Ujin e pijshëm njerëzit e merrnin nga puset. Ishte shumë e vështirë. Ata duhej ta nxirrnin ujin nga pusi si në verë, që ishte vapë, ashtu edhe në dimër, kur ishte shumë ftohtë. Njerëzit gjithmonë kanë punuar që ta përmirësonin jetën e tyre. Ata ndërtuan liqene artificiale dhe hapën kanale për t'i përcjellë gypat e ujësjellësit në çdo vend. Sot, ujin e pijshëm, ujin për ujitje e nevoja të tjera e marrim nga ujësjellësi. Prandaj, ne kujdesemi që ta kursejmë dhe ta ruajmë nga ndotja, pasi ai është burim i jetës.



**KËSHILLA PËR RUAJTJEN E UJIT**  
Mos harro ta mbyllësh çezmën pasi t'i lash dhëmbët!  
Mbylle rubinetin, ndërkohë që laves!  
Mbylle çezmën, gjersa fërkon duart me sapun!  
Mos i ujit çdo ditë lulet!  
Ujti bimët në mëngjes ose në mbrëmje, sepse uji avullon më pak!

- ?** Bisedo për situatën e dhënë.
- Çfarë mendon ti për vështirësitë që kishin njerëzit kur furnizoheshin me ujë nga pusi?
  - A mendon se uji i pusit është i pijshëm? Pse?
  - Si vjen uji deri në shtëpitë tona?
  - Me ndihmën e prindërve apo mësuesit/es, trego se cilat janë burimet ujore në fshatin apo qytetin ku ti jeton.
  - Pse është e rëndësishme ta kursejmë ujin?
  - Trego ndonjë rast kur ti kursen ujin.



*Tri të katërtat e Tokës janë të mbuluara me ujë. Pjesa më e madhe janë dete dhe oqeanë. Ky është ujë i njetëm (i kripur), kurse uji i ëmbël është i përhapur në burime, përenj, lumenj dhe liqene nëntokësore. Njeriu e përdor ujin për pije, për përgatitjen e ushqimit, për larje, për pastrim, për ujitje të bimëve etj. Njerëzit hapën liqene artificiale dhe ndërtuan rrjetin e ujësjellësit për të furnizuar me ujë të pijshëm të gjitha fshatrat e qytetet. Uji që nxirret nga puset nuk është ujë i pijshëm, prandaj duhet të kemi kujdes nëse e përdorim, sepse mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme. Uji duhet të mbrohet nga ndotja. Që të kemi ujë të njaftueshëm, njerëzit duhet ta kursejnë atë. Pa ujë nuk mund të jetojnë njerëzit, kafshët dhe bimët.*

**Fjalët kyçe:** pus, ujësjellës, i pijshëm, ujitje, larje, pastrim.

## Rëndësia e ujit për jetën e njeriut



**Situata 1.** Në të kaluarën, në shumë vende, jeta nuk ishte edhe aq e lehtë. Ujin e pijshëm njerëzit e merrnin nga puset. Ishte shumë e vështirë. Ata duhej ta nxirrnin ujin nga pusi si në verë, që ishte vapë, ashtu edhe në dimër, kur ishte shumë ftohtë. Njerëzit gjithmonë kanë punuar që ta përmirësonin jetën e tyre. Ata ndërtuan liqene artificiale dhe hapën kanale për t'i përcjellë gypat e ujësjellësit në çdo vend. Sot, ujin e pijshëm, ujin për ujtiqe e nevoja të tjera e marrim nga ujësjellësi. Prandaj, ne kujdesemi që ta kursejmë dhe ta ruajmë nga ndotja, pasi ai është burim i jetës.



### KËSHILLA PËR RUAJTJEN E UJIT

Mos harro ta mbyllësh çezmën pasi t'i lash dhëmbët!  
Mbylle rubinetin, ndërkohë që lahes!  
Mbylle çezmën, gersa fërkon duart me sapun!  
Mos i ujit çdo ditë lulet!  
Ujiti bimët në mëngjes ose në mbrëmje, sepse uji avullon më pak!

- ? - Bisedo për situatën e dhënë.  
- Çfarë mendon ti për vështirësitë që kishin njerëzit kur furnizoheshin me ujë nga pusi?  
- A mendon se uji i pusit është i pijshëm? Pse?  
- Si vjen uji deri në shtëpitë tona?  
- Me ndihmën e prindërve apo mësuesit/es, trego se cilat janë burimet ujore në fshatin apo qytetin ku ti jeton.  
- Pse është e rëndësishme ta kursejmë ujin?  
- Trego ndonjë rast kur ti kursen ujin.



Tri të katërtat e Tokës janë të mbuluara me ujë. Pjesa më e madhe janë dete dhe oqeanë. Ky është ujë i njelmët (i kripur), kurse uji i ëmbël është i përhapur në burime, përrrenj, lumenj dhe liqene nëntokësore. Njeriu e përdor ujin për pije, për përgatitjen e ushqimit, për larje, për pastrim, për ujtiqe të bimëve etj. Njerëzit hapën liqene artificiale dhe ndërtuan rrjetin e ujësjellësit për të furnizuar me ujë të pijshëm të gjitha fshatrat e qytetet.  
Uji që nxirret nga puset nuk është ujë i pijshëm, prandaj duhet të kemi kujdes nëse e përdorim, sepse mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme. Uji duhet të mbrohet nga ndotja. Që të kemi ujë të mjaftueshëm, njerëzit duhet ta kursejnë atë. Pa ujë nuk mund të jetojnë njerëzit, kafshët dhe bimët.

Fjalët kyçe: pus, ujësjellës, i pijshëm, ujtiqe, larje, pastrim.

45



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?

Më pas, një nxënës lexon situatën e dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër. Pas diskutimit të situatës së dhënë, lexohen këshillat e dhëna në libër për kursimin e ujit dhe diskutohet rreth tyre duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Cilat janë këshillat për kursimin e ujit?
- Pse është e rëndësishme ta kursejmë ujin?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Diskutim i drejtuar

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij:

- Si është i përhapur uji?
- Pse e përdorim ujin?
- Pse njerëzit hapin liqene artificiale dhe ndërtojnë rrjete ujësjellësish?
- Pse nuk duhet ta pimë ujin që merret nga pusi?
- Çka duhet të bëjmë që të kemi ujë të pijshëm?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për plotësimin e saktë të klasterit, diskutimin e situatës dhe informacionit të dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Raporti njeri-natyre

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit etj.) dhe shpjegon ndërvarësinë njeri-natyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** 1.1, III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Toka dhe ajri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan karakteristikat e tokës dhe ajrit;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Vlerëson rëndësinë e tokës dhe ajrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.


**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Diagrami i Venit

U shpërndahen nxënësve fleta A4 me Diagram të Venit, ku shkruhen karakteristikat e përbashkëta dhe dallimet e tokës dhe ajrit. Pastaj, disa nxënës lexojnë karakteristikat e shkruara. Ja një shembull i dhënë:



**Toka dhe ajri**

**Situata 1.** Ana kishte përgatitur një projekt me temën "Toka dhe ajri", të cilin do ta paraqiste para shoqeve dhe shokëve të klasës së saj. Ajo kishte kërkuar dhe kishte gjetur shumë informacione në internet për tokën dhe për ajrin. Ajo mendoi që, nëpërmjet një diagrami, të gjente dhe të shkruante të veçantat dhe të përbashkëtat e tokës me ajrin.

**TË PËRBASHKËTAT**

TOKA      AJRI

**?**

- Çfarë projekti po përgatiste Ana?
- Trego disa karakteristika të ajrit.
- Po për tokën, çfarë di?
- Pse është i rëndësishëm ajri për jetën tonë?
- Po toka, pse është e rëndësishme?
- Si mund t'i mbrojmë ajrin dhe tokën nga ndotja?

**📖** Toka ku ne jetojmë dhe zhvillojmë veprimtarinë tonë është jetike për nga rëndësia. Ashtu si edhe pa ujë, pa tokë nuk mund të ketë jetë. Faktorët që ndotin ujin dhe ajrin, e ndotin edhe tokën. Toka është e rrezikuar nga një mori problemesh: shpyllëzimi, nxjerrja e mineraleve, përdorimi i kimikateve të ndryshme, industrializimi, mbeturinat etj. Ajri që ne thithim shpeshherë është i ndotur, sidomos në zonat urbane ku është e përqendruar edhe popullsia më e madhe. Kjo ejen edhe si rezultat i përdorimit të automjeteve me djegie të brendshme dhe përdorimit të qymyrit për ngrohje. Njëra nga mënyrat për ta ruajtur ajrin nga ndotja është të shmanjim përdorimin e automjeteve, të ecim sa më shumë, të ngasim biçikletën ose të shfrytëzojmë transportin publik kur kemi distanca më të gjata.


**46** **Fjalët kyçe:** ajri, toka, interneti, parandalimi i ndotjes, kujdesi.



## Toka dhe ajri

**Situata 1.** Ana kishte përgatitur një projekt me temën "Toka dhe ajri", të cilin do ta paraqiste para shoqeve dhe shokëve të klasës së saj. Ajo kishte kërkuar dhe kishte gjetur shumë informacione në internet për tokën dhe për ajrin. Ajo mendoi që, nëpërmjet një diagrami, të gjente dhe të shkruante të veçantat dhe të përbashkëtat e tokës me ajrin.

TË PËRBASHKËTAT



- Çfarë projekti po përgatiste Ana?
- Trego disa karakteristika të ajrit.
- Po për tokën, çfarë di?
- Pse është i rëndësishëm ajri për jetën tonë?
- Po toka, pse është e rëndësishme?
- Si mund t'i mbrojmë ajrin dhe tokën nga ndotja?



Toka ku ne jetojmë dhe zhvillojmë veprimtarinë tonë është jetike për nga rëndësia. Ashtu si edhe pa ujë, pa tokë nuk mund të ketë jetë. Faktorët që ndotin ujin dhe ajrin, e ndotin edhe tokën. Toka është e rrezikuar nga një mori problemesh: shpyllëzimi, nxjerrja e mineraleve, përdorimi i kimikateve të ndryshme, industrializimi, mbeturinat etj. Ajri që ne thihim shpeshherë është i ndotur, sidomos në zonat urbane ku është e përqendruar edhe popullsia më e madhe. Kjo vjen edhe si rezultat i përdorimit të automjeteve me djegie të brendshme dhe përdorimit të qymyrit për ngrohje. Njëra nga mënyrat për ta ruajtur ajrin nga ndotja është të shmanzim përdorimin e automjeteve, të ecim sa më shumë, të ngasim biçikletën ose të shfrytëzojmë transportin publik kur kemi distanca më të gjata.

46

**Fjalët kyçe:** ajri, toka, interneti, parandalimi i ndotjes, kujdesi.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Çfarë po bën vajza?
- Çfarë mendoni që po shikon vajza në kompjuter?

Më pas, një nxënës e lexon situatën e dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër. Pas diskutimit të situatës së dhënë, lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij:

- Pse është e rëndësishme toka?
- Nga kush është e rrezikuar toka?
- Si mund ta parandalojmë ndotjen e ajrit?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Punë e pavarur

Në fletore pune, në faqen 71, punohet detyra e parë. Nxënësit udhëzohen të ngjyrosin figurën e dhënë dhe t'i shkruajnë disa karakteristika për tokën.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për plotësimin saktë të Diagramit të Venit dhe për diskutimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojllojshmëria e shoqërisë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.1.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:**

Diversiteti (llojllojshmëria) etnik e ai kulturor

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Komenton ilustrimin e dhënë;
- Diskuton situatën e dhënë në libër;
- Vlerëson rëndësinë e diversitetit kulturor.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Stuhi mendimesh

Paraqesim fotografi ose pamje me videoprojektor, ku paraqiten klasa të nxënësve të përbërë nga raca të ndryshme. Diskutohen fotografitë e paraqitura:

- Çfarë po shihni në fotografi?
- Cilat janë të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre?
- Pse është e rëndësishme që njerëzit ta respektojnë njëri-tjetrin?

**VII. Llojllojshmëria e shoqërisë**  
Diversiteti (llojllojshmëria) etnik e ai kulturor



**Situata 1.** Një ditë, Flaka dhe Mati bënë një lojë. Ata krijuan një skenë me një tavolinë e dy karrige dhe një mikrofon, për të luajtur sikur po bënin një intervistë. Mati vendosi ta luante rolin e gazetarit dhe Flaka të profesoreshës. Tema për të cilën do të bisedonin ishte: "Ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve".

Mati: Përsëndetje! Mirë se erdhe në emisionin tonë!  
Flaka: Mirë se ju gjeta! Faleminderit për ftesën!  
Mati: Çfarë kanë të përbashkët njerëzit?  
Flaka: Të gjithë njerëzit kanë nevoja, dëshira, gjuhë, besime, prire për argëtime, sporte, gatime, art, e duan jetën dhe shëndetin etj.  
Mati: Nga se ndryshojnë njerëzit?  
Flaka: Mënyra se si njerëzit i përmbushin nevojat e tyre, çfarë dëshirash kanë dhe si i realizojnë ato, çfarë arti, muzike e sporti prodhojnë nga priret e tyre etj., krijojnë llojllojshmërinë kulturore. Për rrjedhojë, njerëzit, përkatësisht shoqëritë, dallojnë ndërmjet vete për sa i përket kombit, etnisë, gjuhës, besimeve të ndryshme kulturore etj.  
Mati: Cilat komunitete etnike jetojnë në Kosovë?  
Flaka: Në vendin tonë, përpos shqiptarëve, që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë, jetojnë edhe shtatë komunitete etnike joshumicë: serbët, boshnjakët, turqit, romët, ashkallitë, egjiptianët dhe goranët.  
Mati: Faleminderit, profesore Flaka!

**?** - Bisedo për situatën e dhënë.  
- Çka kupton me fjalën *diversitet*?  
- Cilat komunitete jetojnë në vendin tonë?  
- Të gjitha komuniteteve në Kosovë u janë garantuar të drejtat e barabarta. Çka mendoni, a respektohen të drejtat e këtyre komuniteteve joshumicë?  
- Pse duhet të respektohen njerëzit, pavarësisht përkatësisë etnike?

**📖** *Diversiteti ose llojllojshmëria ka të bëjë me dallimet kulturore, gjuhësore, racore, fetare etj. ndërmjet njerëzve. Këto dallime shprehen në jetën e përditshme shoqërore të njerëzve. Në mënyrë interesante dhe tërheqëse. Të mësojmë rreth kulturave të tjera na ndihmon që ta njohim më mirë jo vetëm tjetrin, por edhe veten. Si rrjedhojë, edhe respekti për njëri-tjetrin rritet. Njerëzit duhet të jetojnë në tolerancë dhe në harmoni.*

**Fjalët kyçe:** diversitet, dallime etnike, kulturë, besim fetar, tolerancë.

47



## VII. Llojlojshmëria e shoqërisë

Diversiteti (llojlojshmëria) etnik e ai kulturor



**Situata 1.** Një ditë, Flaka dhe Mati bënë një lojë. Ata krijuan një skenë me një tavolinë e dy karrige dhe një mikrofoni, për të luajtur sikur po bënin një intervistë. Mati vendosi ta luante rolin e gazetarit dhe Flaka të profesoreshës. Tema për të cilën do të bisedonin ishte: "Ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve".

Mati: Përshëndetje! Mirë se erdhe në emisionin tonë!  
Flaka: Mirë se ju gjetat! Faleminderit për ftesën!  
Mati: Çfarë kanë të përbashkët njerëzit?  
Flaka: Të gjithë njerëzit kanë nevoja, dëshira, gjuhë, besime, prirje për argëtime, sporte, gatime, art, e duan jetën dhe shëndetin etj.  
Mati: Nga se ndryshojnë njerëzit?  
Flaka: Mënyra se si njerëzit i pëmbushin nevojat e tyre, çfarë dëshirash kanë dhe si i realizojnë ato, çfarë arti, muzike e sporti prodhojnë nga prirjet e tyre etj., krijojnë llojlojshmëri në kulturore. Për rrjedhojë, njerëzit, përkatësisht shoqëritë, dallojnë ndërmjet vete për sa i përket kombit, etnisë, gjuhës, besimeve të ndryshme kulturore etj.  
Mati: Cilat komunitete etnike jetojnë në Kosovë?  
Flaka: Në vendin tonë, përpos shqiptarëve, që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë, jetojnë edhe shtatë komunitete etnike joshumicë: serbët, boshnjakët, turqit, romët, ashkallitë, egjiptianët dhe goranët.  
Mati: Faleminderit, profesore Flaka!



- Bisedo për situatën e dhënë.
- Çka kupton me fjalën *diversitet*?
- Cilat komunitete jetojnë në vendin tonë?
- Të gjitha komuniteteve në Kosovë u janë garantuar të drejtat e barabarta. Çka mendoni, a respektohen të drejtat e këtyre komuniteteve joshumicë?
- Pse duhet të respektohen njerëzit, pavarësisht përkatësisë etnike?



*Diversiteti ose llojlojshmëria ka të bëjë me dallimet kulturore, gjuhësore, racore, fetare etj. ndërmjet njerëzve. Këto dallime shprehen në jetën e përditshme shoqërore të njerëzve. Në mënyrë gjuhë dhe kultura të ndryshme të shoqërive të tjera dhe kjo e bën jetën më interesante dhe tërheqëse. Të mësojmë rreth kulturave të tjera na ndihmon që ta njohim më mirë jo vetëm tjetrin, por edhe veten. Si rrjedhojë, edhe respekti për njëri-tjetrin rritet. Njerëzit duhet të jetojnë në tolerancë dhe në harmoni.*

**Fjalët kyçe:** diversitet, dallime etnike, kulturë, besim fetar, tolerancë.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Cilat janë dallimet mes tyre?
- Çfarë kanë të përbashkët?

Më pas, një nxënës lexon situatën e dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij:

- Pse është i rëndësishëm diversiteti?
- Pse është e rëndësishme të ndërveprojmë me njëri-tjetrin?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e ilustrimeve, për diskutimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe për rolin e diversitetit kulturor.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojllojshmëria e shoqërisë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon diversitetin kulturor, etnik, fetar në mjedisin e tij shoqëror (familje, shkollë, komunitet) dhe shpjegon thjesht këto dallime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Jetojmë së bashku me tolerancë e dashuri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpreh mendim për situatën e dhënë;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Vlerëson rëndësinë e tolerancës për bashkëpunim.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Imagjinatë e drejtuar

Nxënësve u kërkohet të ulin kokën mbi bankë dhe të mbyllin sytë, pastaj lexohet mesazhi para nxënësve e ata imagjinojnë. Imagjinoni veten sikur jeni nxënës i ri në shkollë dhe mësuesja po kërkon nga gjithë klasa të shprehin idetë e tyre si si do ta rregullojmë klasën për festën e 17 Shkurtit. Të gjithë nxënësit japin idetë e tyre, por idenë tuaj të tjerët nuk e pranojnë. Pas përfundimit, nxënësit hapin sytë dhe 2-3 nxënës tregojnë para klasës imagjinatën e tyre.

- Si do të ndiheshit ju në këtë rast?
- Si kanë vepruar nxënësit e tjerë ndaj jush?



Jetojmë së bashku me tolerancë e dashuri

**Situata 1.** Në orën e lëndës shoqëria dhe mjedisi, mësuesja kërkoi nga nxënësit të dëgjonin me vëmendje një ngjarje që kishte ndodhur në një familje.


*Një familje dëshironte të ndërronte orënditë në dhomën e ditës.*

*- Mua më pëlqejnë divanet me ngjyrë të gjelbër, sepse është ngjyra ime e pëlqyer dhe përshtaten me tapetin që kemi, - tha nëna.*

*- Më pëlqen mendimi yt, por edhe ngjyra e verdhë do të rrinte bukur, - tha babai.*

*- Për mua është e rëndësishme vetëm që të jenë të rehatshme, - tha motra.*

*Vëllai propozoi që të votojnë për divanet, kështu do t'i zgjidhnin ato që u pëlqenin shumicës.*



- Për çfarë po diskutohet në këtë familje?

- Çfarë mendoni ju se është toleranca?

- Pse mendoni se është e rëndësishme të respektohen mendimet e të gjithëve?

- Luani në klasë rolet e anëtarëve të familjes dhe, përmes tolerancës, zgjidheni situatën e dhënë.



*Për një jetë të lumtur, duhet të ketë tolerancë, harmoni e dashuri mes njerëzve.*

*Fjala tolerancë nënkupton gatishmërinë për të pranuar mendimet, qëndrimet dhe sjelljet ndryshe të tjerëve, e të cilat mund të mos na pëlqejnë ose me të cilat mund të mos pajtohemi. Me mendime apo sjellje që nuk mund të pajtohemi, duhet të diskutoni, dialogoni dhe të silleni me ndjeshmëri me ata që nuk janë si ju. Kjo do të thotë të tregosh respekt për racën, gjininë, mendimet, sjelljet, besimet fetare të njerëzve etj. Toleranca mundëson zgjidhjen e problemeve në mënyrë paqësore - pa dhunë. Ajo luan rol kyç në jetën e përbashkët e paqësore të njerëzve.*



**Fjalët kyçe:** tolerancë, dashuri, respekt, lumturi, diskutim, dialog.



- A mendoni se duhet të dëgjohen mendimet e të tjerëve?
- Çfarë mendoni për ata që nuk dëgjojnë asnjë mendim?
- Si do të vepronit ju?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Çfarë po bëjnë ata?

Pastaj një nxënës lexon situatën e dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër.



**Përforcimi:**

**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**

Diskutim i drejtuar

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij:

Çka nënkuptoni me fjalën tolerancë?

Pse është e rëndësishme të jemi tolerantë?

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shprehjen lirshëm të mendimit, komentimin e ilustrimeve, për diskutimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe rolin e tolerancës për bashkëpunim.

**Detyrë:**

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojllojshmëria e shoqërisë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon profesione të ndryshme (mësues, mjek, artist, polic, murator, bujk etj.) dhe arsyeton këtë llojllojshmëri veprimtarie.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Profesionet tona

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon profesionet që di;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Shkruan për profesionin që pëlqen.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori, fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Klaster

Në fletën A4 shkruhet fjala “Profesionet” në mes dhe kërkohet nga nxënësit të shkruajnë profesionet që ata dinë. Pastaj, kërkohet nga 2-3 nxënës të lexojnë. Ja një shembull i dhënë:



Profesionet tona

**Situata 1.** Ana dhe babai i saj po bisedonin për profesionet që kishin të afërmit e tyre. Ana po shënonte të gjitha profesionet. Babi është mjek, mami - arkitekte, gjyshi - veteriner, gjyshja - mësuese, gjyshi nga nëna - bujk, gjyshja - infermiere, halla - ekonomiste, daja - gjykatës, tezja - shitëse, xhaxhai - bukëpekkës. Kushërira e babis është police, kurse kushëriri futbollist.




- ? - Për çfarë po bisedonin Ana dhe babai?
- - Cilat profesione përmendën ata?
- - Trego ç'punë kryen secili profesionist.
- - Trego edhe ti për profesionet e familjarëve të tu.




**Situata 2.** Nora ka një akuarium në shtëpi. Brenda akuariumit ndodhen dy peshq, të llojit diskut. Ajo kujdeset shumë për ta. I ushqen, i pastron, bisedon me ta sikur ta kuptonin. Peshqit e shikojnë Norën në sy dhe hapin gojën sikur duan t'i thonë "faleminderit". Vërtet duket ashtu, se vetëm Nora kujdeset për ta, askush tjetër. Për Norën, kjo gjë është shumë e zakonshme, sepse ajo do të bëhet veterinere kur të rritet.

Përshtatur nga libri "Një familje e paparë"



- ? - Çfarë ka në shtëpi Nora?  
 - Si kujdeset ajo për peshqit e saj? Pse?  
 - Çfarë profesioni do të ketë Nora kur të rritet?  
 - Çfarë do të bëhesh ti kur të rritesh? Pse?

 Njerëzit edukohen që të marrin njohuri për një profesion të caktuar. Më pas, ata punojnë për ta bërë më të mirën në punën e tyre. Njeriu nuk mund të punojë i vetëm. Të gjitha profesionet janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe plotësojnë punën e njëra-tjetrës. Njerëzit që punojnë në fshat merren me punimin e tokës, rritjen e kafshëve, kultivimin e pemëve e perimeve. Disa të tjerë punojnë në fabrika, shkolla, ambulancë, spitale, teatro, polici e gjykatë. Të tjerët merren me projektme e ndërtime të ndërtesave të ndryshme. Por, që të gjithë së bashku punojnë për të mirën e shoqërisë sonë. Çdokush duhet ta ketë dhe të zhvillojë një profesion të caktuar, sepse vetëm ashtu kontribuon për të ardhmen e vendit.

Fjalët kyçe: profesion, përgjegjësi, edukim, arsimim, kontribut.

51



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Cilat lloje të profesioneve janë paraqitur?
- Trego punën e secilit profesion?

Më pas, një nxënës lexon situatën e parë të dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër. Lexohet situata e dytë e dhënë dhe diskutohet rreth saj duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër.

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Pse edukohen njerëzit?
- A kanë lidhshmëri profesionet me njëri-tjetrin?



**Përforcimi:**

**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët**

Shkrim i lirë

Nxënësit në fletore shkruajnë për temën: Profesionin që dëshiroj ta zgjedh në të ardhmen. Më pas, dy-tre nxënës lexojnë dhe diskutohet tema e shkruar duke iu përgjigjur pyetjes:

- Pse keni përzgjedhur këtë profesion?

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e ilustrimeve të dhëna në libër, për diskutimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe për shkrimin saktë për temën e dhënë.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Së bashku dhe të barabartë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon mirëkuptim, solidaritet midis të ndryshmëve (në aspektin gjinor) dhe angazhohet për trajtim të barabartë mes tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Të ndryshëm, por të barabartë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shkruan tiparet dalluese dhe ato të përbashkëta në familje;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Tregon të drejtat e barabarta mes dy gjinive.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori, fletorja, fleta A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Tabela T

Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë në fletën A4 tiparet e përbashkëta dhe dallimet që kanë si anëtarë të familjes:

Tiparet e përbashkëta	Tiparet dalluese



**VIII. Së bashku dhe të barabartë**

Të ndryshëm, por të barabartë

**Situata 1.** Kur vijnë gjyshërit, në familjen e Matit ka shumë gëzim. Televizori dhe kompjuteri fiken, të gjithë kanë dëshirë të dëgjojnë ngjarje nga jeta e tyre.

- Dikur, - tha gjyshja, - njerëzit donin të kishin vetëm djem, sepse djemtë konsideroheshin trashëgimtarë të familjes, punonin dhe udhëhiqnin familjen, kurse vajzat atëkohë kryenin punët e zakonshme të shtëpisë dhe kujdeseshin për fëmijët që lindnin.

- Kurse sot, - vazhdoi gjyshi, - edhe vajza, edhe djali janë të njëjtë. Të dy arsimohen, punësohen dhe ushtrojnë profesione të caktuara në shoqëri.

- Sa mirë që kohët kanë ndryshuar dhe dhe sot ekzistojnë mundësi të barabarta për njerëzit, pavarësisht gjinisë së tyre, - tha Mati.



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Çfarë mendoni ju për dallimet që janë bërë në të kaluarën?
- Po sot, a ka dallime mes vajzës dhe djalit? Pse?
- Pse duhet që të dyja gjinitë të kenë të drejta të barabarta?



*Njeriu është qenia më e zhvilluar në botë, e cila nuk mund të jetojë pa shoqëri. Njerëzit janë të lidhur mes vete, bashkëpunojnë dhe kujdesen për njëri-tjetrin. Njerëzit kanë tipare të përbashkëta, por edhe dallime. Ata nuk dallojnë vetëm nga raca, gjuha, besimi fetar, kultura, po edhe nga gjinia.*

*Në të kaluarën, gratë nuk gëzonin të njëjtat të drejta si burrat. Për t'i fituar këto të drejta dhe q të bëhen të barabarta me burrat, gratë kanë bërë përpjekje të vazhdueshme përgjatë historisë. Sot gratë dhe burrat kanë të drejtën për shkollim, punësim dhe pjesëmarrje aktive në gjithë jetën vendit.*



**Fjalët kyçe:** gjini, grua, burrë, të barabartë, të ndryshëm.



### VIII. Së bashku dhe të barabartë Të ndryshëm, por të barabartë

**Situata 1.** Kur vijnë gjyshërit, në familjen e Matit ka shumë gëzim. Televizori dhe kompjuteri fiken, të gjithë kanë dëshirë të dëgjojnë ngjarje nga jeta e tyre.

- Dikur, - tha gjyshja, - njerëzit donin të kishin vetëm djem, sepse djemtë konsideroheshin trashëgimtarë të familjes, punonin dhe udhëhiqnin familjen, kurse vajzat atëkohë kryenin punët e zakonshme të shtëpisë dhe kujdeseshin për fëmijët që lindnin.
- Kurse sot, - vazhdoi gjyshi, - edhe vajza, edhe djali janë të njëjtë. Të dy arsimohen, punësohen dhe ushtrojnë profesione të caktuara në shoqëri.
- Sa mirë që kohët kanë ndryshuar dhe dhe sot ekzistojnë mundësi të barabarta për njerëzit, pavarësisht gjinisë së tyre, - tha Mati.



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Çfarë mendoni ju për dallimet që janë bërë në të kaluarën?
- Po sot, a ka dallime mes vajzës dhe djalit? Pse?
- Pse duhet që të dyja gjinitë të kenë të drejta të barabarta?



Njeriu është qenia më e zhvilluar në botë, e cila nuk mund të jetojë pa shoqëri. Njerëzit janë të lidhur mes vete, bashkëpunojnë dhe kujdesen për njëri-tjetrin. Njerëzit kanë tipare të përbashkëta, por edhe dallime. Ata nuk dallojnë vetëm nga raca, gjyha, besimi fetar, kultura, por edhe nga gjinia.

Në të kaluarën, gratë nuk gëzonin të njëjtat të drejta si burrat. Për t' i fituar këto të drejta dhe që të bëhen të barabarta me burrat, gratë kanë bërë përpjekje të vazhdueshme përgjatë historisë. Sot, gratë dhe burrat kanë të drejtën për shkollim, punësim dhe pjesëmarrje aktive në gjithë jetën e vendit.

52

Fjalët kyçe: gjini, grua, burrë, të barabartë, të ndryshëm.



### Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Çfarë po bëjnë?
- Për çfarë mendoni që po flasin?

Më pas, një nxënës lexon situatën e dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër.

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- A mund të jetojë njeriu pa shoqëri?
- Cilat janë tiparet e përbashkëta të njerëzve?
- Cilat janë tiparet dalluese të njerëzve?
- Në të kaluarën, a kishin të drejta të barabarta gjinia femërore me gjininë mashkullore?



### Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës Shkrim i lirë

Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë në fletore për temën: "Të gjithë fëmijët gëzojnë të drejta të barabarta".

Pastaj, dy nxënës lexojnë temën e shkruar.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shkrimin e saktë të tipareve dalluese dhe të përbashkëta në familje, për diskutimin e situatës së dhënë në libër, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe shkrimin e saktë të të drejtave të barabarta në mes të dy gjinive.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Së bashku dhe të barabartë

**Rezultatet e të nxënimit të temës:**

Tregon mirëkuptim, solidaritet midis të ndryshmëve (në aspektin gjinor) dhe angazhohet për trajtim të barabartë mes tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Të punojmë së bashku

**Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:**

- Komenton ilustrimin e dhënë;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Tregon të drejtat e barabarta në mes dy gjinive.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori, fletorja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Stuhi mendimesh

Diskutohen pyetjet:

- Kush i bën punët në shtëpinë tuaj?
- Cilat janë punët që i bëjnë anëtarët e tjerë të familjes?
- Po ju, si kontribuoni në shtëpi?

Të punojmë së bashku



**Situata 1.** Një vogëlush ishte ulur në autobus. Hyri edhe një i moshuar. Vogëlushi u ngrit dhe i tha:  
 - Eja xhaxhi, ulu këtu.  
 - Faleminderit, biri im! - i tha xhaxhai.  
 Vogëlushi ishte shumë i sjellshëm. E quanin Drin. Gjatë gjithë rrugës biseduan. Xhaxhai e pyeti:  
 - Kush kryen punët në shtëpinë tënde?  
 Drini nuk u përgjigj.  
 - Të gjitha punët i bën mami apo...?  
 - tha xhaxhai.  
 Prapë, Drini nuk u përgjigj.  
 - Me siguri, se burrat nuk janë për punë shtëpie, - tha xhaxhai.  
 Drini u mendua, buzëqeshi dhe tha:  
 - Xhaxhai, në shtëpinë tonë punët i kryejmë të gjithë. Kur mami e babi kthehen nga puna e ne fëmijët nga shkolla, fillojmë t'i ndajmë detyrat dhe secili nga ne merr përgjegjësitë që i takojnë. Kështu, familja jonë është gjithmonë e lumtur.



(Përshtatur)



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Pse xhaxhai mendon që burrat nuk janë për punë shtëpie?
- A ju pëlqeu përgjigjja e Drinit? Pse?
- Po ju, si do të përgjigjeshit në një situatë të tillë? Pse?
- Si i organizoni ju punët në shtëpinë tuaj?



Në familje dhe në shoqëri, njerëzit jetojnë së bashku. Për të pasur një jetë më të mirë, ata duhet të kujdesen për të gjitha punët e shtëpisë. Në familje nuk mungon edhe ndihma e fëmijëve. Të gjithë i ndajnë detyrat e përgjegjësitë dhe, kështu, të gjithë e udhëheqin familjen. Ndarja e përgjegjësiave krijon mundësinë për të pasur harmoni dhe mirëkuptim në familje dhe në shoqëri.

**Fjalët kyçe:** kujdes, ndihmë, dashuri, respekt.





**Situata 1.** Një vogëlush ishte ulur në autobus. Hyri edhe një i moshuar. Vogëlushi u ngrit dhe i tha:

- Eja xhaxhi, ulu këtu.
- Faleminderit, biri im! - i tha xhaxhai.
- Vogëlushi ishte shumë i sjellshëm. E quanin Drin. Gjatë gjithë rrugës biseduan. Xhaxhai e pyeti:
- Kush kryen punët në shtëpinë tënde?
- Drini nuk u përgjigj.
- Të gjitha punët i bën mami apo...?
- tha xhaxhai.
- Prapë, Drini nuk u përgjigj.
- Me siguri, se burrat nuk janë për punë shtëpie, - tha xhaxhai.
- Drini u mendua, buzëqeshi dhe tha:
- Xhaxhai, në shtëpinë tonë punët i kryejmë të gjithë. Kur mami e babi kthehen nga puna e ne fëmijët nga shkolla, fillojmë t'i ndajmë detyrat dhe secili nga ne merr përgjegjësitë që i takojnë. Kështu, familja jonë është gjithmonë e lumtur.



(Përshtatur)



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Pse xhaxhai mendon që burrat nuk janë për punë shtëpie?
- A ju pëlqeu përgjigjja e Drinit? Pse?
- Po ju, si do të përgjigjeshit në një situatë të tillë? Pse?
- Si i organizoni ju punët në shtëpinë tuaj?



Në familje dhe në shoqëri, njerëzit jetojnë së bashku. Për të pasur një jetë më të mirë, ata duhet të kujdesen për të gjitha punët e shtëpisë. Në familje nuk mungon edhe ndihma e fëmijëve. Të gjithë i ndajnë detyrat e përgjegjësitë dhe, kështu, të gjithë e udhëheqin familjen. Ndarja e përgjegjësiave krijon mundësinë për të pasur harmoni dhe mirëkuptim në familje dhe në shoqëri.

**Fjalët kyçe:** kujdes, ndihmë, dashuri, respekt.

53



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Çfarë po bëjnë prindërit dhe fëmijët?
- Po ju, a u ndihmoni prindërve?
- Si u ndihmoni prindërve?

Më pas, një nxënës lexon situatën e dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër.

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Pse duhet të gjithë të marrim pjesë në punët e shtëpisë?
- Pse është e rëndësishme t'i ndajmë përgjegjësitë?



**Përforcimi:**

**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**

Shkrim i lirë

Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë në fletore për temën: "Të dyja gjinitë gëzojnë të drejta të barabarta".

Pastaj, dy nxënës lexojnë temën e shkruar.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin, diskutimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe shkrimin e saktë të temës së dhënë.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Së bashku dhe të barabartë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon mirëkuptim, solidaritet midis të ndryshmëve (në aspektin gjinor) dhe angazhohet për trajtim të barabartë mes tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Unë dhe ti - të barabartë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Komenton ilustrimet e dhëna;
- Tregon të drejtat e barabarta në mes të dy gjinive;
- Krahason dallimet dhe të përbashkëtat mes dy gjinive.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori, fletorja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Pyetja sjell pyetjen

Në tabelë shkruhet 8 Marsi dhe kërkohet nga nxënësit të tregojnë:

- Çfarë feste është 8 Marsi?
- Pse festohet kjo festë?
- A kishin gratë dikur të drejta të barabarta me burrat? Pse? (Nxiten nxënësit të tregojnë për dallimet dhe të përbashkëtat gjinore që kanë qenë dikur.)



Unë dhe ti - të barabartë

**Situata 1.** Lola është në klasën e tretë. Ajo ka dy vëllezër, Nolin dhe Lumin. Lola ka shumë dëshirë të luajë futboll, por vëllezërit nuk e marrin të luajë me ta, duke i thënë se futboli nuk është për vajza. Mirëpo, Lola nuk ndalet së ushtruar. Një ditë garoi me vëllezërit për ta mbajtur topin pa rënë në tokë. Lola mbajti topin me këmbë duke numëruar 1, 2, 3...9...18. Kur arriti te numri 19, topi i ra në tokë. Ajo doli fituese, sepse Noli kishte mbajtur topin deri në 17, kurse Lumi deri në 15.



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Cila është dëshira e Lolës?
- Pse vëllezërit nuk e merrnin në lojë?
- A kanë të drejtë ata?
- Bashkë me shokët dhe shoqet e klasës, garoni duke mbajtur topin pa rënë në tokë. Shënoni pikët e secilit/secilës.



**Situata 2.** Në klasë po organizoheshin gara vallëzimi. Në garë konkurruan tri pika vallëzimi modern. Pikën e parë e luajti Nora, pikën e dytë Korabi dhe pikën e tretë dyshja Ana-Mati. Garën e fituan Ana dhe Mati, të cilët edhe u duartrokitën nga të gjithë. Mësuesja tha se bashkëpunimi e bën vallëzimin më të bukur.



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Cili vallëzim e fitoi garën? Pse?
- Pse bashkëpunimi sjell fitore?
- A keni provuar të vallëzoni në klasë apo për ndonjë festë familjare?
- Tregoni raste kur bashkëpunimi ju ka ndihmuar që të keni sukses.



Njeriu është qenie shoqërore. Puna që bëhet në bashkëpunim është gjithmonë më e suksesshme. Njerëzit marrin pjesë për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, pa dallim. Të gjithë jemi të barabartë, prandaj edhe ndarja e përgjegjësiave duhet të bëhet në mënyrë të drejtë.

**Fjalët kyçe:** bashkëpunim, të drejta të barabarta, përgjegjësi.

55



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

DLTA

Nxënësit komentojnë fotografinë e paraqitur me anë të projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shikoni në fotografi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Si po ndihen ata?

Më pas, një nxënës lexon situatën e parë të dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në libër. Në të njejtën mënyrë diskutohet edhe situata e dytë.

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Pse është e rëndësishme të bashkëpunojmë?
- A jemi të gjithë të barabartë?



**Përforcimi:**

**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës**

Shkrim i lirë

Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë në fletore për temën: “Unë dhe motra ime jemi të barabartë/a”. Pastaj, dy nxënës e lexojnë temën e shkruar.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e ilustrimit të dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, për shprehjen e mendimit rreth situatës së dhënë dhe shkrimin e saktë të temës.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vendosim së bashku në familje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Rendit saktë fjalët në fjali;
- Diskuton situatën e dhënë;
- Vlerëson rëndësinë e bashkëpunimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Zarfi me letra, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Copëzat e përziera

Nxënësit ndahen në tri grupe. Secilit grup ia shpërndajmë zarfin me fjalët e përziera dhe kërkojmë që t'i rendisin fjalët, për të krijuar fjali me kuptim.

- çdo, punë, me, bëhet, bashkëpunim, e mirë. Me bashkëpunim çdo punë bëhet e mirë.
- çelësi, është, bashkëpunimi, i suksesit. Bashkëpunimi është çelësi i suksesit.
- ndërtojmë, të gjithë, jetë, së bashku, një, të mirë. Të gjithë së bashku ndërtojmë një jetë më të mirë.

Pastaj, secili grup lexon fjalitë dhe diskutohet rreth tyre:

- Pse çdo punë bëhet e mirë me bashkëpunim?
- Pse themi se bashkëpunimi është çelësi i suksesit?



**IX. Konsultohemi së bashku dhe vendosim**


Vendosim së bashku në familje

**Situata 1.** Ishin ditët e ngrohta të verës kur më erdhi dëshira për të shkuar në një kamp veror. Unë me familjen time ishim mësuar tashmë të qëndronim çdo verë për disa ditë në mal dhe të pushonim. Por, këtë verë dëshiroja që të shkoja me shokët e mi, të cilët donin të shkonin në një kamp vere jashtë vendit. Për këtë duhej të bisedoja me prindërit dhe ta merrija lejen e tyre. Nuk e dija nëse ata do të pajtoheshin, por vendosa t'i pyesja përmes një loje...




- Vazhdoni situatën, duke i dhënë një zgjidhje.
- Si përfshihen të gjithë në vendimmarrje?
- Cila mund të ishte zgjidhja më e mirë?
- Diskutoni për zgjidhjet që jepni.

**Situata 2.** Familja jonë pushonte në jug të Shqipërisë. Të gjithë shokët e mi pushonin në Durrës. Durrësi është qytet bregdetar pranë Adriatikut, kurse ne shkonim në brigjet e Jonit. Aty kishte shkëmbinj të thepisur. Babai tha se duhej të jepnim një mendim për pushimet e radhës. I nxitur nga lajmet dhe kurioziteti që ma kishin ngjallur fëmijët e tjerë, i thashë babait se këtë verë do të më pëlqente të shkonim në Durrës. Besoj se aty do të shkojmë, pasi edhe fjala ime dëgjohej në familje.



- Kush i merr vendimet në familje?
- Si duhet të merren vendimet?
- Jepni disa mendime dhe tregoni se kush duhet të vendosë:
  - Ku do të shkollohen fëmijët?
  - Ku do të luajnë?
  - A duhet ta përdorin celularin?
  - Sa orë duhet të lexojnë?
  - Si e zgjedhin shokun?
  - Çfarë emisionesh duhet të shohin? etj.

 Në familje diskutojmë për punët, planet dhe vendimet që do të marrim. Të gjithë anëtarët e familjes diskutojnë me njëri-tjetrin, po ashtu edhe fëmijët. Fëmijët kanë të drejtë t'i shprehin mendimet e tyre dhe të vendosin për gjërat që lidhen me ta me miratimin e prindërve. Këtë të drejtë ua mundëson "Konventa për të Drejtat e Fëmijëve". Shprehja e lirë e mendimeve i bën fëmijët të ndihën më të sigurt dhe më të përgatitur për jetë.

**Fjalët kyçe:** e drejtë, vendim, pjesëmarrje, mirëkuptim, mendim i lirë.

57



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DLTA

Komentohet ilustrimi i dhënë në libër (i paraqitur me projektor):

1. Çfarë po shohim në fotografi?
2. Çfarë po bëjnë fëmijët?
3. Për çfarë po flasin?

Më pas, lexohen situatat e dhënë në libër dhe diskutohet rreth tyre duke iu përgjigjur pyetjeve të librit.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Lexohet informacioni i dhënë në libër dhe diskutohet rreth tij, duke iu përgjigjur pyetjeve:

1. A kanë të drejtë fëmijët ta shprehin mendimin e tyre?
2. Çka është Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës?
3. A duhet ta respektojmë njëri-tjetrin? Pse?

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për renditjen e saktë të fjalëve në fjali, pjesëmarrjen aktive në diskutim, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe për të kuptuarit e rëndësisë së bashkëpunimit.

#### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.



*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet të ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, I.4; II.2; II.3; III.1; IV.4;

V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.2; 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vendosim së bashku në shkollë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Komenton situatën e dhënë në libër;
- Përgjigjet në pyetjet e librit;
- Tregon a e respekton mendimin e të tjerëve në marrjen e vendimeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Stuhi mendimesh

Bisedohet me nxënësit për vendimet që ata i marrin në shkollë. Pyeten nxënësit:

- Kush i merr vendimet në shkollë?
- A merrni pjesë në vendimet që merren brenda klasës?



Vendosim së bashku në shkollë

**Situata 1.** Mësuesja na njoftoi se duhet të realizonim së bashku një plan për aktivitetet. Secili nga ne dha mendime nga më të ndryshmet. Sa shumë idetë Mësuesja, e kënaqur, na këshilloi t'i listonim gjithë ato që i kishim diskutuar dhe ky do të ishte plani ynë i aktiviteteve. Po fillonim të rriteshim, pasi të gjithë kishim marrë vendime për aktivitetet tona.



- A keni plan aktiviteteve në klasë?
- Kush e harton atë?
- A merrni ju vendime së bashku?
- Diskutoni për mënyrën se si e bëni këtë.

**Situata 2.** Mësuesi po shpjegonte mësimin. Të gjithë nxënësit po e dëgjonin, përveç Lolës, e cila po luante me ngjyrat e shokut të bankës. Mësuesi disa herë i tha Lolës që të dëgjonte me kujdes. Kur mësuesi e përfundoi shpjegimin, ia bëri Lolës disa pyetje, por Lola nuk kishte dëgjuar asgjë dhe nuk mundi të përgjigjej. Ora përfundoi dhe Lola mbeti pa e kuptuar mësimin. Ajo e kuptoi gabimin dhe kërkoi falje para shokëve dhe shoqeve të klasës. Ata vendosën që të gjithë së bashku t'i ndihmojnë Lolës me shpjegimin e mësimin, por ata kërkuan që Lola t'i dëgjonte me kujdes.



- Çfarë mendon për veprimin e Lolës?
- Cila ishte arsyeja që Lola nuk iu përgjigj pyetjeve të mësuesit?
- A është e rëndësishme të dëgjojmë kur flet dikush? Pse?
- Si e vlerëson vendimin e shokëve dhe shoqeve për t'i ndihmuar Lolës?



Në shkollë shpeshherë gjendemi përballë situatave të ndryshme. Nganjëherë është e vështirë që të vendoset për zgjidhjen e tyre. Kur ne diskutojmë dhe marrim mendimet e njëri-tjetrit, patjetër që situata do të zgjidhet. Gjatë komunikimit duhet të dëgjojmë mendimin e tjetrit dhe të flasim me rradhë. Respektimi i mendimit të të tjerëve mundëson zgjidhjen më të mirë për situata të ndryshme në shkollë.



**Fjalët kyçe:** plan aktiviteteve, listim, respektim, zgjidhje.



## Vendosim së bashku në shkollë

**Situata 1.** Mësuesja na njoftoi se duhej të realizonim së bashku një plan për aktivitetet. Secili nga ne dha mendime nga më të ndryshmet. Sa shumë ide! Mësuesja, e kënaqur, na këshilloi t'i listonim gjithë ato që i kishim diskutuar dhe ky do të ishte plani ynë i aktiviteteve. Po fillonim të rriteshim, pasi të gjithë kishim marrë vendime për aktivitetet tona.



- A keni plan aktiviteteve në klasë?
- Kush e harton atë?
- A merrni ju vendime së bashku?
- Diskutoni për mënyrën se si e bëni këtë.

**Situata 2.** Mësuesi po shpjegonte mësimin. Të gjithë nxënësit po e dëgjonin, përveç Lolës, e cila po luante me ngjyrat e shokut të bankës. Mësuesi disa herë i tha Lolës që të dëgjonte me kujdes. Kur mësuesi e përfundoi shpjegimin, ia bëri Lolës disa pyetje, por Lola nuk kishte dëgjuar asgjë dhe nuk mundi të përgjigjej. Ora përfundoi dhe Lola mbeti pa e kuptuar mësimin. Ajo e kuptoi gabimin dhe kërkoi falje para shokëve dhe shoqëve të klasës. Ata vendosën që të gjithë së bashku t'i ndihmojnë Lolës me shpjegimin e mësimin, por ata kërkuan që Lola t'i dëgjonte me kujdes.



- Çfarë mendon për veprimin e Lolës?
- Cila ishte arsyeja që Lola nuk iu përgjigj pyetjeve të mësuesit?
- A është e rëndësishme të dëgjojmë kur flet dikush? Pse?
- Si e vlerëson vendimin e shokëve dhe shoqëve për t'i ndihmuar Lolës?



Në shkollë shpeshherë gjendemi përballë situatave të ndryshme. Nganjëherë është e vështirë që të vendoset për zgjidhjen e tyre. Kur ne diskutojmë dhe marrim mendimet e njëri-tjetrit, patjetër që situata do të zgjidhet. Gjatë komunikimit duhet të dëgjojmë mendimin e tjetrit dhe të flasim me radhë. Respektimi i mendimit të tjerëve mundëson zgjidhjen më të mirë për situata të ndryshme në shkollë.

58

**Fjalët kyçe:** plan aktiviteteve, listim, respektim, zgjidhje.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Komentohet ilustrimi i dhënë, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shohim në fotografi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?

Pastaj lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve të librit.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Diskutim i drejtuar

Pyeten nxënësit:

A e respektoni mendimin e tjetrit në rastin kur merren vendimet brenda klasës?

Shembull i një përgjigjeje:

Unë gjithmonë i dëgjoj shokët dhe shoqet kur ata flasin. Nëse më pëlqen mendimi i atij/asaj edhe unë e ndryshoj mendimin.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e ilustrimit dhe diskutimit të situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet të ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.1; II.3; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.2; 4.1; 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Vendimmarrja në komunitet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Komenton situatën e dhënë në libër;
- Diskuton rreth situatave të imagjinuara.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Stuhi mendimesh

Pyeten nxënësit:

- A luani me shokë dhe shoqe në lagje?
- A ju shqetëson ndonjë gjë teksa luani?
- A jeni munduar të gjeni zgjidhje nëse ju ka shqetësuar diçka?

Vendimmarrja në komunitet



**Situata 1.** Fëmijët e shkollës sonë banonin afër me njëri-tjetrin. Ata luanin në oborrin e shkollës dhe pasditeve thuajse qëndronin në shtëpi. Pranë pallateve nuk kishte asnjë shesh pushimi apo park lodrash. Sa të pakujdesshëm bëheshin ndonjëherë të rriturit; mendonin vetëm për vete. Në ditët e takimeve me përfaqësues të komunës, një grup fëmijësh vendosën të kërkonin një hapësirë ku të grumbulloheshin së bashku, larg pluhurit të makinave. Prindërit u gëzuan dhe na njoftuan se duhej të realizoheshin disa takime për t'u marrë vendimet e duhura. Ata inkurajuan fëmijët që të shkruanin një letër ku të shfaqnin shqetësimet e tyre dhe ku të kërkonin ndihmë për zgjidhjen e problemeve që i shqetësonin.



- Çfarë shqetësimi kishin fëmijët?

- Pse ata mendonin se të rriturit tregoheshin ndonjëherë të pakujdesshëm?

- Si do ta zgjidhnin këtë problem fëmijët?

- Shkruajuni një letër përfaqësuesve të komunës për gjërat që ju mungojnë në komunitetin tuaj.



Komuniteti paraqet një grup njerëzish që bashkëveprojnë. Ata jetojnë ose punojnë së bashku në një vend të caktuar. Sipshterë kemi nevoja të ndryshme në komunitet për të cilat nuk është e lehtë të merren vendime. Duhet të mendohet për zgjidhjen më të mirë, sepse është për të mirën e gjithë komunitetit. Pasi mbliidhemi dhe shprehim të gjithë mendimet dhe arsyetimet tona, atëherë vijmë deri te zgjidhja e duhur, e cila është e përshatshme për të gjithë. Disa vendime merren përmes procesit të votimit, siç është përzgjedhja e përfaqësuesit a përfaqësueses së komunitetit (kryetar/e). Votimi mundëson që të gjithë njerëzit t'i shprehin mendimet e tyre dhe, kështu, në fund të gjithë do të jenë të kënaqur.

**Fjalët kyçe:** mendim, vendim, arsyetim, komunitet, votim.





**Situata 1.** Fëmijët e shkollës sonë banonin afër me njëri-tjetrin. Ata luanin në oborrin e shkollës dhe pasditeve thuajse qëndronin në shtëpi. Pranë pallateve nuk kishte asnjë shesh pushimi apo park lodrash. Sa të pakujdesshëm bëheshin ndonjëherë të rriturit mendonin vetëm për vete. Në ditët e takimeve me përfaqësues të komunës, një grup fëmijësh vendosën të kërkonin një hapësirë ku të grumbulloheshin së bashku, larg pluhurit të makinave. Prindërit u gëzuan dhe na njoftuan se duhej të realizoheshin disa takime për t'u marrë vendimet e duhura. Ata inkurajuan fëmijët që të shkruanin një letër ku të shfaqnin shqetësimet e tyre dhe ku të kërkonin ndihmë për zgjidhjen e problemeve që i shqetësonin.



- ? - Çfarë shqetësimi kishin fëmijët?  
 - Pse ata mendonin se të rriturit tregoheshin ndonjëherë të pakujdesshëm?  
 - Si do ta zgjidhnin këtë problem fëmijët?  
 - Shkruajuni një letër përfaqësuesve të komunës për gjërat që ju mungojnë në komunitetin tuaj.

Komuniteti paraqet një grup njerëzish që bashkëpunojnë. Ata jetojnë ose punojnë së bashku në një vend të caktuar. Sipshtërë kemi nevoja të ndryshme në komunitet për të cilat nuk është e lehtë të merren vendime. Duhet të mendohet për zgjidhjen më të mirë, sepse është për të mirën e gjithë komunitetit. Pasi mbledhemi dhe shprehim të gjithë mendimet dhe arsyetimet tona, atëherë vijmë deri te zgjidhja e duhur, e cila është e përshtatshme për të gjithë. Disa vendime merren përmes procesit të votimit, siç është përzgjedhja e përfaqësuesit a përfaqësueses së komunitetit (kryetar/e). Votimi mundëson që të gjithë njerëzit t'i shprehin mendimet e tyre dhe, kështu, në fund të gjithë do të jenë të kënaqur.

Fjalët kyçe: mendim, vendim, arsyetim, komunitet, votim.

59



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Komentohet ilustrimi i dhënë, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shohim në fotografi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?

Pastaj lexohet situata e dhënë në libër, diskutohet rreth asaj situatë dhe nxënësit u përgjigjen pyetjeve të librit:

- Çfarë shqetësimi kishin fëmijët?
- Pse ata mendonin se të rriturit tregoheshin ndonjëherë të pakujdesshëm?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Imagjinatë e drejtuar

Nxënësve u jepet detyrë:

- Imagjinoni sikur jeni ju në vend të fëmijëve. Si do ta zgjidhnit këtë problem?

Fëmijët mendojnë për rreth 5 minuta dhe pastaj diskutojnë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e ilustrimit, diskutimin të situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe diskutimin rreth situatave të imagjinuara.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Vlerëson komunikimin si element të përbashkët pozitiv për vendimmarrje të qëndrueshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3, I.4; II.1; II.3; III.1; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.1; 3.2; 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Respektojmë mendimin ndryshe

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- Diskuton në dyshe për çështjen e dhënë;
- Komenton situatën e dhënë në libër;
- Përgjigjet në pyetjet e dhëna në libër.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënët**

Punë në dyshe

Nxënësve u kërkohet të mendojnë për lëndën e tyre të preferuar dhe t'i tregojnë njëri-tjetrit.

Pasi të mendojnë dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin, ata pyeten:

- Cila lëndë ju pëlqen më shumë?

Disa nga përgjigjet: matematika, gjuha shqipe, arti figurativ etj.

Nga kjo nxënësit kuptojnë që njerëz të ndryshëm kanë mendime dhe dëshira të ndryshme, andaj duhen respektuar të gjithë.



Respektojmë mendimin ndryshe

**Situata 1.** Nxënësit/et e klasës së tretë kishin vendosur të organizonin një ekskursion.  
- Unë mendoj që duhet të shkojmë në mal, pasi natyra dhe ajri i pastër janë të dobishëm për shëndetin. Do të na bëjë mirë, - tha Mati. Papritur u dëgjua zëri i Besës, e cila kishte dëshirë që, së bashku me shokët dhe shoqet e klasës, të shkonin në ndonjë muze historik, pasi aty mund të mësonin shumë gjëra interesante. Pas tyre, i shprehën mendimet edhe shokët e shoqet e tjera të klasës. Pati mendime të ndryshme.



- Si do të vepronit ju në një situatë të tillë?
- Tregoni një rast kur keni pasur mendim ndryshe nga shoku apo shoqja juaj.
- Si e keni zgjidhur atë rast?
- Si duhet të vepronit në rast se keni mendim ndryshe nga të tjerët?
- A duhet të vlerësohet mendimi ndryshe?
- Pse duhet të respektohet ai?



Mendimi ndryshe i takon qysh fillimit të njerëzimit. Ata që veprojnë sipas njërit mendim, nuk duhet të mendojnë se mendimi ndryshe i tjetrit është i pavlefshëm apo i papranueshëm. Mendimi ndryshe jo vetëm që duhet të pranohet, por edhe duhet të vlerësohet dhe të respektohet. Nuk mund të ketë barazi nëse diversiteti (llojlojshmëria) nuk njihet dhe nuk vlerësohet.



**Fjalët kyçe:** diversitet, paragjykim, qëndrim.



## Respektojmë mendimin ndryshe

**Situata 1.** Nxënësit/et e klasës së tretë kishin vendosur të organizonin një ekskursion.  
 - Unë mendoj që duhet të shkojmë në mal, pasi natyra dhe ajri i pastër janë të dobishëm për shëndetin. Do të na bëjë mirë, - tha Mati. Papritur u dëgjua zëri i Besës, e cila kishte dëshirë që, së bashku me shokët dhe shoqet e klasës, të shkonin në ndonjë muze historik, pasi aty mund të mësonin shumë gjëra interesante. Pas tyre, i shprehën mendimet edhe shokët e shoqet e tjera të klasës. Pati mendime të ndryshme.



- Si do të vepronit ju në një situatë të tillë?
- Tregoni një rast kur keni pasur mendim ndryshe nga shoku apo shoqja juaj.
- Si e keni zgjidhur atë rast?
- Si duhet të vepronit në rast se keni mendim ndryshe nga të tjerët?
- A duhet të vlerësohet mendimi ndryshe?
- Pse duhet të respektohet ai?

*Mendimi ndryshe i takon qysh fillimit të njerëzimit. Ata që veprojnë sipas njërit mendim, nuk duhet të mendojnë se mendimi ndryshe i tjetrit është i pavlefshëm apo i papranueshëm. Mendimi ndryshe jo vetëm që duhet të pranohet, por edhe duhet të vlerësohet dhe të respektohet. Nuk mund të ketë barazi nëse diversiteti (llojllojshmëria) nuk njihet dhe nuk vlerësohet.*

60 Fjalët kyçe: diversitet, paragjykim, qëndrim.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Komentohet ilustrimi i dhënë përmes projektorit, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po shohim në fotografi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?

Pastaj lexohet situata e dhënë në libër dhe komentohet nga nxënësit.



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Si do të vepronit ju në një situatë të tillë?
- Si duhet të vepronit në rast se keni mendim ndryshe nga të tjerët?
- A duhet të vlerësohet mendimi ndryshe?
- Pse duhet të respektohet ai?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

**Kontributi në rezultatet për kompetencat**

**kryesore të shkallës:** I.3, I.4; II.2; II.3; III.1; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së**

**kurrikulës:** 4.1; 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Si të marr një vendim të drejtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara;
- Komenton situatën në libër;
- Tregon një rast ku është keqkuptuar me një shok/shoqe.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Stuhi mendimesh


Pyeten nxënësit:

- Kë e pyesni në familje në rast se nuk dini se si të veproni për një çështje të caktuar?
- A e keni më të lehtë të merrni vendim kur i pyesni të tjerët?

Si të marr një vendim të drejtë?



**Situata 1.** - Shoqja ime dhe shoku im i klasës, Ana dhe Mati, nuk po komunikojnë më si më parë. Asnjëri prej tyre nuk thoshte se cili ishte shkak, por dukej se diçka duhej t'i kishte mërzhitur. Pyeta Anën dhe ajo nuk më pohoi asgjë. Vendosa t'i shkoja deri në fund situatës, pasi miqësia e tyre ishte shumë e rëndësishme. Pyeta Matin dhe pothuajse e njëjta situatë. Shpesh nga komunikimi zgjidhen problemet dhe unë vendosa të organizoja një festë dhe t'i ftoja të dy, - tha Dritani.



- Si u përpoq ta zgjidhte problemin Dritani?
- A bëri ai përpjekje për të arritur komunikimin mes Anës dhe Matit?
- A ju ka ndodhur të jeni në dilemë për zgjidhjen e një problemi?
- Cili ishte vendimi që mori Dritani? A ju duket i drejtë?



Procesi i vendimmarrjes është shumë i rëndësishëm pasi gjatë gjithë jetës sonë na duhet të marrim vendime. Kjo do të thotë që ne duhet të përzgjedhim bashkërisht njërin prej mundësive që diskutohen. Nuk mund të ketë vendimmarrje të suksesshme, pa i përfshirë nxënësit si pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Nxënësit duhet të kenë mbështetjen e duhur nga familja, shkolla dhe shoqëria, me qëllim që të marrin një vendim të drejtë.

Fjalët kyçe: përkrahje, komunikim, vendim, zgjidhje.

Si të marr një vendim të drejtë?



**Situata 1.** - Shoqja ime dhe shoku im i klasës, Ana dhe Mati, nuk po komunikojnë më si më parë. Asnjëri prej tyre nuk thoshte se cili ishte shkak, por dukej se diçka duhej t'i kishte mërzhitur. Pyeta Anën dhe ajo nuk më pohoi asgjë. Vendosa t'i shkoja deri në fund situatës, pasi miqësia e tyre ishte shumë e rëndësishme. Pyeta Matin dhe pothuajse e njëjta situatë. Shpesh nga komunikimi zgjidhen problemet dhe unë vendosa të organizoja një festë dhe t'i ftoja të dy, - tha Dritani.



- Si u përpoq ta zgjidhte problemin Dritani?
- A bëri ai përpjekje për të arritur komunikimin mes Anës dhe Matit?
- A ju ka ndodhur të jeni në dilemë për zgjidhjen e një problemi?
- Cili ishte vendimi që mori Dritani? A ju duket i drejtë?



Procesi i vendimmarrjes është shumë i rëndësishëm pasi gjatë gjithë jetës sonë na duhet të marrim vendime. Kjo do të thotë që ne duhet të përzgjedhim bashkërisht njërin prej mundësive që diskutohen. Nuk mund të ketë vendimmarrje të suksesshme, pa i përfshirë nxënësit si pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Nxënësit duhet të kenë mbështetjen e dhuruar nga familja, shkolla dhe shoqëria, me qëllim që të marrin një vendim të drejtë.

**Fjalët kyçe:** përkrahje, komunikim, vendim, zgjidhje.

61



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**

**Përpunimi i përmbajtjes**

Teknika DLTA

Lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve të librit:

- Si u përpoq ta zgjidhte problemin Dritani?
- A bëri ai përpjekje për të arritur komunikimin mes Anës dhe Matit?
- Cili ishte vendimi që mori Dritani? A ju duket i drejtë?



**Përforcimi:**

**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**

Diskutim i drejtuar

Pyeten nxënësit:

- Për çdo dyshim ose keqkuptim që kemi, a është zgjidhja më e mirë komunikimi?
- A arrihet zgjidhje përmes komunikimit?

Tregoni nëse ju ka ndodhur ndonjëherë që të keqkuptoheni me shokun/shoqen dhe se çfarë ka ndodhur pasi keni komunikuar.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe tregimin e një rasti ku janë keqkuptuar me një shok/shoqe.

**Detyrë:**

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Diskuton me të tjerët përvoja të ndryshme, para se të marrë vendime për situata nga jeta e përditshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; II.2; II.3; III.1; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pasuritë natyrore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Tregon me fjalë se çka janë pasuritë natyrore;
- U përgjigjet pyetjeve rreth situatës;
- Shkruan në fletore për pasuritë natyrore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Përgjigjemi bazuar në ilustrime

Përmes projektorit, shfaqet një fotografi.

Pyeten nxënësit:

- Çka janë pasuritë natyrore?



**X. Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre**  
Pasuritë natyrore

**Situata 1.** - Në orën e lëndës shoqëria dhe mjedisi, sapo erdhi mësuesja në klasë, shkroi në tabelë: **Çfarë janë pasuritë natyrore?** Ajo kërkoi nga ne që, për pesë minuta, t'i përgjigjeshim pyetjes. Disa nga përgjigjet tona ishin këto, - tha Mati.

Pasuri natyrore janë të gjitha të mirat që i marrim nga natyra për një jetë më të mirë, e të cilat nuk i ka krijuar njeriu.

Burime natyrore janë: Dielli, uji, ajri, toka, bimët, kafshët dhe lëndët djegëse.




Pasuri natyrore janë mineralet që gjenden nën tokë.

Pasuri natyrore janë të gjitha të mirat që janë mbi tokë dhe nën tokë e të cilat i shfrytëzojmë për një jetë më të mirë e që ne duhet të kujdesemi për ruajtjen e tyre.



62





- ?
- Çfarë kërkoi mësuesja nga nxënësit?
  - A i pëlqyen asaj përgjigjet e nxënësve? Pse?
  - Çfarë menduan ata për pasuritë natyrore? Cilat janë ato?
  - Shkruaj çfarë di ti për pasuritë natyrore?
  - Pse janë të rëndësishme ato?
  - Pse duhet të kujdesemi për mbrojtjen e tyre?



Pasuri natyrore janë të mirat materiale që gjenden në natyrë dhe që mund të përdoren nga njeriu. Disa nga këto pasuri natyrore njeriu i duhen për të mbijetuar, sepse janë të domosdoshme. Disa nga to njerëzit i përdorin për ta bërë jetën e tyre më të mirë. Secili vend dallohet për pasuritë natyrore që ka. Disa vende karakterizohen me toka pjellore, florë dhe faunë (bimë dhe kafshë) të pasur etj. Vende të tjera janë të pasura me minerale, xehe e shumë pasuri të tjera. Duke ditur që pasuritë natyrore janë shumë të rëndësishme për jetën tonë, ne duhet të kemi kujdes për mbrojtjen e tyre nga keqpërdorimi.

Fjalët kyçe: pasuri natyrore, minerale, mbrojtje, shfrytëzim i dulur.

63



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Pasi nxënësit t'i përgjigjen pyetjes së parashtruar, duke shikuar fotografinë e shfaqur, atyre u lexohet situata në libër.

Pyeten nxënësit rreth situatës në libër:

- A i pëlqyen mësueses përgjigjet e nxënësve?
- Çfarë menduan ata për pasuritë natyrore? Cilat janë ato?
- Pse janë të rëndësishme ato?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim 10-minutësh

Kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë në fletë A4 se çfarë dinë ata për pasuritë natyrore dhe cila është rëndësia e tyre.

Pas përfundimit të detyrës, disa nga nxënësit e lexojnë atë se çfarë kanë shkruar.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e sakta të pyetjeve të librit dhe shkrimin në fletore për pasuritë natyrore.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre

**Rezultatet e të nxënësve të temës:**

Dallon pasuritë natyrore dhe humane.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.4; II.2; II.3; III.1; III.4;

IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njëësia mësimore:** Pasuritë nëntokësore

**Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**

- U përgjigjet pyetjeve të parashtruara;
- Komenton situatën e dhënë në libër;
- Shpreh me fjalë disa nga pasuritë nëntokësore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Përgjigjemi bazuar në ilustrime

Përmes projektorit, shfaqet një fotografi.

Pyeten nxënësit:

Çfarë po bëjnë njerëzit në fotografi?

Çfarë po nxjerrin ata nga toka?





Pasuritë nëntokësore

**Situata 1.** Një ditë, Ana dhe familja e saj po udhëtonin për në Prishtinë. Ata, gjatë gjithë rrugës, bisedonin për bukuritë e vendit tonë. Panë male, fusha, kafshë që po kullosnin, bimë të ndryshme, lumin Drin e shumë bukuri të tjera. - Të gjitha këto, - tha babai, - janë pasuri natyrore të vendit tonë. Kur u afruan te qyteti i Obiliqit, ajo pa tymtarin e Termocentralit të Kosovës. Ishte shumë kurioze të dinte se çfarë ishte ai. Babai ndaloi makinën, dolën jashtë dhe i tregoi se ky ishte Termocentrali i Obiliqit, në të cilin prodhohej energjia elektrike nga thëngjilli.

- E ku e marrin thëngjillin? - pyeti Ana.

- Nga nëntoka, - u përgjigj nëna. - Thëngjilli, nafta, gazi natyror etj., janë pasuri nëntokësore, të cilat njeriu i shfrytëzon për një jetë më të mirë.

- Sa zemërgjerë është toka! - tha Ana. - Na jep gjithë këto të mira!



- Bisedo për situatën e dhënë.

- Për çfarë po bisedonte Ana me prindërit?

- Çfarë panë ata?

- Çfarë prodhohet në Termocentralin e Obiliqit?

- Ku nxirret thëngjilli?

- Përmend disa pasuri natyrore.

- Çfarë mendoi Ana për tokën? Po ti, çfarë mendon?



*Pasuritë natyrore janë mbitokësore dhe nëntokësore. Disa nga këto pasuri janë në sipërfaqen e tokës dhe quhen pasuri mbitokësore, kurse ato që janë nën tokë quhen pasuri nëntokësore. Pasuri mbitokësore janë: ujërat (lumçinjë, liqenet, detet, oqeanet), fushat, malët, bimët etj. Pasuri nëntokësore janë: shikëmbinjë, mineralet, xehet dhe lëndët djegëse. Lëndët djegëse janë: thëngjilli, nafta dhe gazi natyror. Kosova ka shumë pasuri. Ajo është e pasur me thëngjill, nga i cili prodhohet energjia elektrike në Termocentralin e Kosovës. Ajo është e pasur me shumë minerale, ndër to më së shumti plumb, i cili nxirret në minierat e Trepçës në Mitrovicë. Kosova dallohet edhe për ujërat termale nëntokësore, të cilat janë shëruese. Burimet e tyre janë në Banjen e Pejës dhe atë të Klokotit.*



**Fjalët kyçe:** pasuri mbitokësore, pasuri nëntokësore, lëndë djegëse, minerale, shikëmbinj.







## Pasuritë nëntokësore

**Situata 1.** Një ditë, Ana dhe familja e saj po udhëtonin për në Prishtinë. Ata, gjatë gjithë rrugës, bisedonin për bukuritë e vendit tonë. Panë male, fusha, kafshë që po kullosnin, bimë të ndryshme, lumin Drin e shumë bukuri të tjera. - Të gjitha këto, - tha babai, - janë pasuri natyrore të vendit tonë. Kur u afruan te qyteti i Obiliqit, ajo pa tymtarin e Termocentralit të Kosovës. Ishte shumë kurioze të dinte se çfarë ishte ai. Babai ndaloi makinën, dolën jashtë dhe i tregoi se ky ishte Termocentrali i Obiliqit, në të cilin prodhohej energjia elektrike nga thëngjilli.

- E ku e marrin thëngjillin? - pyeti Ana.

- Nga nëntoka, - u përgjigj nëna. - Thëngjilli, nafta, gazi natyror etj., janë pasuri nëntokësore, të cilat njeriu i shfrytëzon për një jetë më të mirë.

- Sa zemërgjerë është toka! - tha Ana. - Na jep gjithë këto të mira!



- Bisedo për situatën e dhënë.

- Për çfarë po bisedonte Ana me prindërit?

- Çfarë panë ata?

- Çfarë prodhohet në Termocentralin e Obiliqit?

- Ku nxirret thëngjilli?

- Përmend disa pasuri natyrore.

- Çfarë mendoi Ana për tokën? Po ti, çfarë mendon?



*Pasuritë natyrore janë mbitokësore dhe nëntokësore. Disa nga këto pasuri janë në sipërfaqen e tokës dhe quhen pasuri mbitokësore, kurse ato që janë nën tokë quhen pasuri nëntokësore. Pasuri mbitokësore janë: ujërat (lumenjtë, liqenet, detet, oqeanet), fushat, malet, bimët etj. Pasuri nëntokësore janë: shkëmbinjtë, mineralet, xehet dhe lëndët djegëse. Lëndët djegëse janë: thëngjilli, nafta dhe gazi natyror. Kosova ka shumë pasuri. Ajo është e pasur me thëngjill, nga i cili prodhohet energjia elektrike në Termocentralin e Kosovës. Ajo është e pasur me shumë minerale, ndër to më së shumti plumb, i cili nxirret në minierat e Treçës në Mitrovicë. Kosova dallohet edhe për ujërat termale nëntokësore, të cilat janë shëruese. Burimet e tyre janë në Banjën e Pejë dhe atë të Kllokotit.*

64

**Fjalët kyçe:** pasuri mbitokësore, pasuri nëntokësore, lëndë djegëse, minerale, shkëmbinj.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

### Përpunimi i përmbajtjes

#### Teknika DLTA

Lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet bashkë me nxënësit.

Më pas, pyeten nxënësit rreth situatës në libër:

- Për çfarë po bisedonte Ana me prindërit?
- Çfarë panë ata?
- Çfarë prodhohet në Termocentralin e Obiliqit?



### Përforcimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

#### Stuhi mendimesh

Më pas, pyeten nxënësit:

- Përmend disa pasuri natyrore.
- Çfarë mendon ti për tokën?
- Përmend disa nga pasuritë nëntokësore.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e situatës së dhënë, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve, dhe për shprehjen me fjalë të disa pasurive natyrore.

## Detyrë:

Plotëson në fletore pune.



*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre

**Rezultatet e të nxënët të temës:**

Ndërlidh llojin e pasurive natyrore dhe humane me vendbanimin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; II.1; II.2; II.3; III.1; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.2; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Profesionet e trashëguara

**Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:**

- Diskuton rreth fotografive të paraqitura;
- U përgjigjet pyetjeve të dhëna në libër;
- Tregon për një profesion që e ka parë nga afër.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Diskutim i drejtuar

Përmes projektorit, shfaqen disa fotografi dhe diskutohet me nxënësit se çfarë po shohin.




Profesionet e trashëguara




**Situata 1.** Nxënësit e klasave të treta po bënin një projekt, me ç'rast do të hulumtonin për profesionet që janë trashëguar nga e kaluara. Ata organizuan një vizitë në Çarshinë e Madhe në Gjakovë, për të vizituar zejtarë të ndryshëm. Nxënësit mbajtën shënime për zejet që ende ruheshin nga familjet e që u trashëguan brez pas brezi. Mbetën të befusuar nga bukuritë e punimeve të zejtarëve. Disa nga zejet ishin:

<p><b>ZDRUKTHËTARËT</b></p> <p>Zdrukthetarët bëjnë punime druri. Punimi që u bëri shumë përshtypje nxënësve ishte djepi i punuar nga druri dhe i ngjyrosur me figura e ngjyra të harmonizuara mes vete.</p>	<p><b>PLISAXHINJTË</b></p> <p>Plisaxhinjtë bëjnë punimin e plisave. Plisat punohen nga leshi i deleve apo i qengjave.</p>
<p><b>NALLBANËT</b></p> <p>Nallbanët bëjnë mbajtjen e kuajve, lopëve, buajve, gomarëve, mushkave.</p>	<p><b>ARGJENDARËT</b></p> <p>Argjendarët punojnë stoli të ndryshme të argjendit.</p>
<p><b>VORBËTARËT</b></p> <p>Vorbëtarët janë zejtarë që bëjnë punimin e enëve prej balte (argjile). Baltë të argjilës ka shumë në Çabrat.</p>	<p><b>QEPJE DHE QËNDISJE</b></p> <p>Puna me pëlhurë; qëndisjet me penj; qëndisjet me ari; punëdore me gjilpërë; thurje.</p>



Kur u prezantua projekti, puna u vlerësua me notën më të lartë, sepse u përmendën profesionet kryesore të trashëguara.



- ?
- Bisedoni për situatën e dhënë.
  - Cila ishte detyra e nxënësve?
  - Cilat zeje u përmendën?
  - Pse ruhen këto zeje?
  - Bisedoni me mësuesin/en në klasë dhe me prindërit në shtëpi për lloje të tjera të zejeve.
  - A është përcjellë ndonjë zeje në familjen tuaj nga e kaluara?

Nëse e shikojmë historikisht krijimin e profesioneve, atëherë mund të vërejmë se profesionet kanë ndryshuar. E gjitha kjo është duke ndodhur falë teknologjisë, e cila ka pushtuar çdo sferë të jetës. Dikur profesionet janë quajtur zeje dhe njerëzit që janë marrë me atë profesion janë quajtur zejtarë. Zejet janë ruajtur e përcjellë brez pas brezi. Këto zeje mbeten si pasuri e trashëguar e vendit tonë, edhe pse disa prej tyre janë duke u shuar.

66 **Fjalët kyçe:** trashëgimi, profesion, plisaxhi, argjendar, nallban, zdrukthëtar, vorbëtar.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Lexohet situata në libër.

Më pas pyeten nxënësit:

- Cila ishte detyra e nxënësve?
- Cilat profesione u përmendën?
- Pse ruhen këto profesione?
- Si janë quajtur profesionet në të kaluarën?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Pyeten nxënësit:

- Për cilat nga këto profesione keni dëgjuar?
- A keni ndonjë të afërm në familje që merret me ndonjë nga këto profesione?
- A e ke parë nga afër se si punohet në këtë profesion?

Një nga përgjigjet:

- Po, babai im është zdrukthëtar. Ky profesion është shumë i rrezikshëm, sepse punohet me makineri me sharra të mprehta.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e situatës së dhënë, diskutimin rreth fotografive të paraqitura dhe për tregimin për një profesion që e kanë parë nga afër.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon se mbrojtja e pasurive nuk do të thotë mosshfrytëzim, jep shembuj të shfrytëzimit racional të pasurive në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; II.3; III.1; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ta kursejmë energjinë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon termin kursim;
- Diskuton rreth situatës në libër;
- Tregon raste të kursimit të energjisë në bazë të figurave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Diskutim i drejtuar

Bisedohet bashkë me nxënësit për kursimin e gjërave të ndryshme.

Pyeten nxënësit:

- Çka kuptoni me fjalën kursim?
- Pse duhet të kursejmë?

Ta kursejmë energjinë



**Situata 1.** Ana ka dëshirë që në mbrëmje t'i ndezë të gjitha llambat e shtëpisë. Babai i bën vërejtje se nuk duhen ndezur tërë llambat.

- Ndize llambën vetëm në dhomën ku qëndron apo kur hyn në të për të kryer ndonjë punë, - i thotë babai.

Të gjithë i thonë se babai është dorështrënguar, sepse nuk ka dëshirë të bëjë shpenzime. Një ditë, Ana e pyeti:

- Baba, pse ti nuk ke dëshirë t'i lësh llambat e ndezura?

- Sepse energjia duhet kursyer, bija ime. Ta kursesh energjinë është kulturë. Në vendin tonë, energjia elektrike prodhohet nga thëngjilli. Sa më shumë prodhohet, aq më shumë ndotet ambienti dhe harxhohet thëngjilli, i cili është pasuri natyrore dhe nuk mund të zëvendësohet. Duke e kursyer energjinë elektrike, kursen paratë, por edhe mbrojnë natyrën, - tha babai.

- Sa i mirë je, o babai im! - i tha Ana duke e përqafuar.

Ajo i premtoi babait se nga ai moment do të ishte më e kujdesshme.



- Bisedo për situatën e dhënë.

- Cila ishte biseda mes babait e Anës?

- A kishte të drejtë babai? Pse?

- Pse është e rëndësishme të kursehet energjia elektrike?

- A mund të jetojmë pa energji elektrike?

- Trego raste kur ti kursen energjinë elektrike.

**Situata 2.** Në shkollën e Matit, gjatë dimrit, për ngrohje përdorin sobë me dru. Nxënësit nuk kanë kujdes fare. Ata gjithmonë në pushim hapin derën e klasës. Klasa ftohet e ata më pas e mbushin sobën me dru sepse mërdhijnë.



- Bisedoni për situatën e dhënë.
- Çfarë mendon ti për Matin dhe shokët e shoqet e tij? Pse?
- Çfarë ndodh me drunjët që i kanë për ngrohje?
- Si duhet të sillen ata në këtë rast? Pse?
- A mendon se, duke kursyer drunjët dhe energjinë, mbron natyrën? Pse?



Energjia është e domosdoshme për të ndriçuar, për të ngrohur e për shumë aktivitete të përditshme. Njerëzit duhet ta kursejnë atë. Kursimi dhe përdorimi i arsyeshëm i energjisë sjellin dobi. Kjo do të thotë se do të harxhoni më pak energji dhe do të paguani më pak para. Kursimi i energjisë mundëson mbrojtjen e pasurive natyrore, si: thengjillit, naftës e gazit natyror, sepse ato janë pasuri të papërtëritshme. Përdorimi i pakursyeshëm i tyre ndot ambientin. Për ta mbrojtur natyrën, në botë po bëhet prodhimi i energjisë elektrike nga era, rrezet e diellit e uji, sepse janë pasuri të përtëritshme natyrore.

68

**Fjalët kyçe:** energji, kursim, pasuri të papërtëritshme, pasuri të përtëritshme.



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Lexohen situatat e dhëna në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve të librit.

- Pse është e rëndësishme të kursehet energjia elektrike?
- A mund të jetojmë pa energji elektrike?
- A mendon se, duke kursyer drurët dhe energjinë, mbron natyrën? Pse?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Duke parë vendet në fotografi, trego se kur ti kursen energjinë elektrike.



### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shpjegimin e termit kursim, diskutimin rreth situatës në libër dhe për tregimin e një rasti kur kanë kursyer energjinë.

#### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Tregon se mbrojtja e pasurive nuk do të thotë mosshfrytëzim, jep shembuj të shfrytëzimit racional të pasurive në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; II.3; III.1; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Riciklimi i mbetjeve

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon kuptimin e fjalëve të paraqitura;
  - Komenton situatën e dhënë në libër;
  - Tregon me fjalë për ndarjen e mbeturinave sipas shportave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.


**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
 Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Diskutim i drejtuar

Pyeten nxënësit:



Riciklimi i mbetjeve

**Situata 1.** Nxënësit e një shkolle dëshirojnë që të kontribuojnë për mbrojtjen e ambientit ku jetojnë. Ata vendosën të organizonin një aktivitet.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të formojë një ekip për riciklimin e mbeturinave. Në të mund të marrin pjesë nxënësit e klasave të treta, të katërta dhe të pesta, së bashku me mësuesit/et.

Aktiviteti zgjat  
nga \_\_\_\_\_ deri më \_\_\_\_\_.

Bëhet fjalë për mbledhjen e mbeturinave:

- plastikë;
- qelq;
- letër;
- mbetje ushqimore.

Nxënësit do t'i mbledhin këto mbeturina në lagjen e tyre dhe do t'i grumbullojnë në oborrin e shkollës. Pastaj ato do të dërgohen për riciklim.

**?** - Bisedoni për aktivitetin e organizuar nga nxënësit.  
 - Çfarë mendoni ju për këtë nismë?  
 - A bëhet në shkollën tuaj riciklimi i mbeturinave?  
 - Pse është i rëndësishëm riciklimi i mbeturinave?  
 - A do të donit edhe ju të ishit pjesë e Ekipit të Riciklimit? Pse?  
 - Organizoni edhe ju në shkollë një aktivitet të ngjashëm.

**📖** Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave. Për përfitimet nga materialet e ricikluar si dhe për ta bërë sa më të thjeshtë këtë proces, është vendosur të bëhet grumbullimi i mbeturinave të klasifikuara në: letër, qelq, plastik dhe mbetje ushqimore. Riciklimi i mbeturinave ndihmon planetin tonë. Riciklimi i mbeturinave mund të bëjë një ndryshim në shkollën, komunitetin dhe mjedisin përreth nesh. **KLASIFIKIMI, RICIKLIMI dhe RIPËRDORIMI janë 3 ueprimet/proceset më të rëndësishme që ndihmojnë natyrën dhe mjedisin ku jetojmë.**

Fjalët kyçe: riciklim, ripërdorim, klasifikim, mbrojtje.

69

## Riciklimi i mbetjeve



**Situata 1.** Nxënësit e një shkolle dëshirojnë që të kontribuojnë për mbrojtjen e ambientit ku jetojnë. Ata vendosën të organizonin një aktivitet.



Qëllimi i këtij aktiviteti është të formojë një ekip për riciklimin e mbeturinave. Në të mund të marrin pjesë nxënësit e klasave të treta, të katërta dhe të pesta, së bashku me mësuesit/et.

Aktiviteti zgjat  
nga \_\_\_\_\_ deri më  
\_\_\_\_\_.

Bëhet fjalë për mbledhjen e mbeturinave:

- plastikë;
- qelq;
- letër;
- mbetje ushqimore.

Nxënësit do t'i mbledhin këto mbeturina në lagjen e tyre dhe do t'i grumbullojnë në oborrin e shkollës. Pastaj ato do të dërgohen për riciklim.



- Bisedoni për aktivitetin e organizuar nga nxënësit.
- Çfarë mendoni ju për këtë nismë?
- A bëhet në shkollën tuaj riciklimi i mbeturinave?
- Pse është i rëndësishëm riciklimi i mbeturinave?
- A do të donit edhe ju të ishit pjesë e Ekipit të Riciklimit? Pse?
- Organizoni edhe ju në shkollë një aktivitet të ngjashëm.



Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave. Për përfitimet nga materialet e riciklueshme si dhe për ta bërë sa më të thjeshtë këtë proces, është vendosur të bëhet grumbullimi i mbeturinave të klasifikuara në: letër, qelq, plastikë dhe mbetje ushqimore. Riciklimi i mbeturinave ndihmon planetin tonë. Riciklimi i mbeturinave mund të bëjë një ndryshim në shkollën, komunitetin dhe mjedisin përreth nesh. **KLASIFIKIMI, RICIKLIMI DHE RIPËRDORIMI janë 3 veprimet/proceset më të rëndësishme që ndihmojnë natyrën dhe mjedisin ku jetojmë.**

Fjalët kyçe: riciklim, ripërdorim, klasifikim, mbrojtje.

69



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Kërkohet nga nxënësit që të komentojnë ilustrimin e dhënë në libër. Më pas, lexohet situata e dhënë në libër dhe komentohet bashkë me nxënësit.

Pyeten nxënësit:

- A bëhet në shkollën tënde riciklimi i mbeturinave?
- Pse është i rëndësishëm riciklimi i mbeturinave?



## Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Përmes projektorit, shfaqen disa fotografi të shportave me ngjyrë.

Pyeten nxënësit:

- Para se të riciklojmë mbeturinat, çfarë duhet të dimë?
- Si bëhet ndarja e mbeturinave në shporta të caktuara?



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shpjegimin e kuptimit të fjalëve, komentimin e situatës në libër dhe për ndarjen e mbeturinave sipas shportës së caktuar.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon se njeriu është përgjegjës për përkujdesjen, mirëmbajtjen e mjedisit dhe shkaktari kryesor i ndotjes së tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; II.3; III.1; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.2.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njëësia mësimore:** Aktivitet: Ta mbrojmë mjedisin në të cilin jetojmë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Krijon poster me temën e caktuar;
- Komenton para nxënësve të tjerë për punën e bërë;
- Interviston shoqet/shokët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.


**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
Punë në grupe


Formohen 3 grupe brenda klasës. Secilit grup i jepet detyrë të krijojë poster.

- Grupi I: poster për mbrojtjen dhe kursimin e ujit.
- Grupi II: poster për kursimin e energjisë elektrike.
- Grupi III: poster për mbrojtjen dhe kursimin e drurëve.



**Aktivitet:** Ta mbrojmë mjedisin në të cilin jetojmë

- Ndahuni në tri grupe brenda klasës. Krijoni postera për vetëdijësimin e njerëzve për:
  - a) mbrojtjen dhe kursimin e ujit (grupi 1);
  - b) kursimin e energjisë elektrike (grupi 2);
  - c) mbrojtjen dhe kursimin e drurëve (grupi 3).



- Sipas grupeve tashmë të ndara, shkoni nëpër klasat e tjera të shkollës.
- Tregojani posterat nxënësve të tjerë.
- Mbanini një ligjëratë për rëndësinë e kursimit në jetën e njeriut.
- Intervistoni shokët/shoqet e klasave të tjera në lidhje me mbrojtjen dhe kursimin e ujit të energjisë elektrike dhe të drurëve.
- Kërkoni nga ta që t'ju tregojnë shembuj të ndryshëm nga jeta e tyre e përditshme, për mbrojtjen dhe kursimin e ujit, të energjisë elektrike dhe të drurëve.




**Fjalët kyçe:** mbrojtje, kursim, ujë, energji elektrike, dru.





**Aktivitet:** Ta mbrojmë mjedisin në të cilin jetojmë

- Ndahuni në tri grupe brenda klasës. Krijoni postera për vetëdijësimin e njerëzve për:
  - a) mbrojtjen dhe kursimin e ujit (grupi 1);
  - b) kursimin e energjisë elektrike (grupi 2);
  - c) mbrojtjen dhe kursimin e drurëve (grupi 3).



- Sipas grupeve tashmë të ndara, shkoni nëpër klasat e tjera të shkollës.
- Tregojani posterat nxënësve të tjerë.
  - Mbanë një ligjëratë për rëndësinë e kursimit në jetën e njeriut.
  - Intervistoni shokët/shoqet e klasave të tjera në lidhje me mbrojtjen dhe kursimin e ujit, të energjisë elektrike dhe të drurëve.
  - Kërkoni nga ta që t'ju tregojnë shembuj të ndryshëm nga jeta e tyre e përditshme, për mbrojtjen dhe kursimin e ujit, të energjisë elektrike dhe të drurëve.

**70** Fjalët kyçe: mbrojtje, kursim, ujë, energji elektrike, dru.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
Teknika DLTA

Pasi grupet ta përfundojnë posterin, shpërndahen nëpër klasa të ndryshme.

Sipas temës që kanë punuar, grupet mbajnë ligjëratë para nxënësve të tjerë.

Ata tregojnë për rëndësinë e kursimit në jetën e njeriut.



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
Diskutim i drejtuar

Pas përfundimit të ligjeratës, nxënësit intervistojnë shokët/shoqet e klasave të tjera në lidhje me mbrojtjen dhe kursimin e ujit, energjisë elektrike dhe të drurëve.

Në fund, kërkohen nga ta që të tregojnë shembuj të ndryshëm nga jeta e tyre për mbrojtjen dhe kursimin e ujit, energjisë elektrike dhe drurëve.

### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për krijimin e posterit me temën e caktuar.

#### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi  
**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III  
**Tema:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Përshkruan të veçantat e mjedisit natyror dhe kulturor, karakteristikat e vendit ku jeton.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; II.3; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Njeriu dhe mjedisi natyror

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përgjigjet në pyetjen e parashtruar;
  - Komenton situatën e dhënë në libër;
  - Tregon për kujdesin që shfaq ndaj mjedisit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**  
 Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**  
 Diskutim i drejtuar



XI. Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim  
 Njeriu dhe mjedisi natyror



**Situata 1.** Mësuesja kërkoi nga nxënësit e klasës së tretë që t'i shkruanin mendimet e tyre rreth pyetjes: "Çfarë e bën jetën tuaj më të bukur?". Ana mendoi se kishte shumë gjëra që ia bënin jetën të bukur. Prandaj, ajo mendoi që të shkruante për familjen, shokët e shoqet, mësuesit e shkollën. Ajo vuri re se shkrimi të saj i mungonte diçka. Ajo nuk kishte shkruar për maçukun e saj, Simbon, për frutat e pëlqyera, si qershizat që i donte shumë, dredhëzat, kumbullat e shumë fruta të tjera. Ajo madje nuk kishte shkruar për ndjesinë që i jepnin delet, të cilat i dukeshin shumë të këndshme, apo për besnikërinë që qeni Riko tregonte ndaj saj. Specat e gjelbër, rrepat e kuqe e shumë gjëra të tjera i vinin në mendje. Ajo që e shqetësonte ishte se si do t'i organizonte të gjitha këto në shkrimin e saj. Një gjë ishte e sigurt, Ana e çmonte shumë natyrën dhe ishte shumë e lidhur me të.



- ? - Çfarë u kërkoi mësuesja nxënësve?  
 - Pse e kishte të vështirë Ana që t'i organizonte mendimet e saj?  
 - Për çfarë do të shkruante ajo?  
 - A ke shkruar edhe ti një shkrim të tillë?  
 - Tregoj shokëve se cilat gjëra e bëjnë jetën tënde më të mirë.  
 - Çfarë kujdesi tregon ti për natyrën?

*Kujdesi për mjedisin jetësor është detyrë e çdo banori në planetin Tokë. Herë pas here, ne hasim në katastrofa natyrore, të cilat na tregojnë se çfarë ndodh nëse e shfrytëzojmë në mënyrë të gabuar mjedisin. Pasojat nuk i shohim menjëherë, por ato shfaqen me kalimin e kohës. Mbi të gjitha, pasojat i vuajnë gjeneratat e ardhshme. Prandaj duhet që të gjithë të kujdesemi për natyrën dhe të kontribuojmë për mbrojtjen e saj. Njeriu duhet të përshtatet me mjedisin ku jeton, ta ndryshojë atë dhe ta bëjë sa më të dobishëm për jetën e tij pa dëmtuar atë. Natyra është gjëja më e çmueshme që ne kemi - është vetë jeta jonë.*

**Fjalët kyçe:** natyrë, gjelbërim, kujdes, e çmueshme, e dobishme.

## XI. Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim Njeriu dhe mjedisi natyror



**Situata 1.** Mësuesja kërkoi nga nxënësit e klasës së tretë që t'i shkruanin mendimet e tyre rreth pyetjes: "Çfarë e bën jetën tuaj më të bukur?". Ana mendoi se kishte shumë gjëra që ia bënin jetën të bukur. Prandaj, ajo mendoi që të shkruante për familjen, shokët e shoqet, mësuesit e shkollën. Ajo vuri re se shkrimi i saj i mungonte diçka. Ajo nuk kishte shkruar për maçukun e saj, Simbon, për frutat e pëlqyera, si qershizat që i donte shumë, dredhëzat, kumbullat e shumë fruta të tjera. Ajo madje nuk kishte shkruar për ndjesinë që i jepnin delet, të cilat i dukeshin shumë të këndshme, apo për besnikërinë që qeni Riko tregonte ndaj saj. Specat e gjelbër, rrepat e kuqe e shumë gjëra të tjera i vinin në mendje. Ajo që e shqetësonte ishte se si do t'i organizonte të gjitha këto në shkrimin e saj. Një gjë ishte e sigurt, Ana e çmonte shumë natyrën dhe ishte shumë e lidhur me të.



- Çfarë u kërkoi mësuesja nxënëseve?
- Pse e kishte të vështirë Ana që t'i organizonte mendimet e saj?
- Për çfarë do të shkruante ajo?
- A ke shkruar edhe ti një shkrim të tillë?
- Tregoj shokëve se cilat gjëra e bëjnë jetën tënde më të mirë.
- Çfarë kujdesi tregon ti për natyrën?



*Kujdesi për mjedisin jetësor është detyrë e çdo banori në planetin Tokë. Herë pas here, ne hasim në katastrofa natyrore, të cilat na tregojnë se çfarë ndodh nëse e shfrytëzojmë në mënyrë të gabuar mjedisin. Pasojat nuk i shohim menjëherë, por ato shfaqen me kalimin e kohës. Mbi të gjitha, pasojat i vuajnë gjeneratat e ardhshme. Prandaj duhet që të gjithë të kujdesemi për natyrën dhe të kontribuojmë për mbrojtjen e saj. Njeriu duhet të përshtatet me mjedisin ku jeton, ta ndryshojë atë dhe ta bëjë sa më të dobishëm për jetën e tij pa dëmtuar atë. Natyra është gjëja më e çmueshme që ne kemi - është vetë jeta jonë.*

**Fjalët kyçe:** natyrë, gjelbërim, kujdes, e çmueshme, e dobishme.

71



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Teknika DLTA

Komentohet ilustrimi i dhënë, duke iu përgjigjur pyetjes:

- Çfarë po shohim në fotografi?

Pastaj, lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet duke iu përgjigjur pyetjeve të librit.

- Pse e kishte të vështirë Ana t'i organizonte mendimet e saj?
- Për çfarë do të shkruante ajo?
- Çfarë kujdesi tregoni ju për natyrën?



## Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diskutim i drejtuar

Kërkohe nga nxënësit:

- Tregoni se cilat gjëra e bëjnë jetën tënde më të mirë.
- Çfarë kujdesi tregoni ju për natyrën?

Në fund, bashkë me nxënësit e shikojmë një video që ka të bëjë me mjedisin natyror.

### Vlerësimi i nxënëseve:

Nxënësit vlerësohen për komentimin e situatës së dhënë, përgjigjet në pyetjet e parashtruara dhe tregimin për kujdesin që tregojnë ndaj mjedisit.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përshkruan të veçantat e mjedisit natyror dhe kulturor, karakteristikat e vendit ku jeton, që tërheqin vëmendjen e vizitorëve.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.3; II.1; II.3; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Njeriu dhe mjedisi kulturor

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Diskuton për fotografitë e shfaqura;
- Komenton situatën e dhënë në libër;
- Përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Shiko dhe diskuto

Me anë të projektorit, paraqiten disa fotografi para nxënësve dhe diskutohet rreth tyre.




Njeriu dhe mjedisi kulturor

**Situata 1.** Ana kishte shumë familjarë që jetonin jashtë Kosovës. Ata vinin kohë pas kohe për pushime në Kosovë. Ana e shijonte shumë kohën me ta. Ishte bërë një kohë e gjatë që kur Ana kishte filluar ta njohte kulturën e vendit të saj. Për këtë e kishte ndihmuar vizita në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Ishte magjepsur kur kishte parë veshje tradicionale, monedha të vjetra e fotografi nga qytete të ndryshme shqiptare. Tani ajo kishte vendosur që, kur t'i vinin kushërinjtë në Kosovë, t'u fliste më shumë për figurat e ndryshme të kulturës shqiptare. Ajo kishte menduar që, së bashku me prindërit e saj, të organizonin një vizitë të përbashkët në Muzeun e Kosovës, në Bibliotekën Kombëtare dhe në Teatrin Kombëtar.



Muzeu i Kosovës - Prishtinë



Brezovica




Miniera e Trepçës - Mitrovicë



Gryka e Rugovës - Pejë



Kalaja e Prizrenit - Prizren



Malet e Sharrit



Sahat-kulla - Prishtinë



- Diskuto për situatën e dhënë.
- Çfarë po mendonte Ana?
- Ku do t'i çonte kushërinjtë?
- Përmend disa mjediset kulturore që njeh.
- Çfarë mësojmë nga mjediset kulturore?



Njeriu kulturën e shpreh përmes gjuhës, stilit të jetës që bën, bindjeve të tij, zakoneve e normave, besimit që i takon etj. Pra, kultura është një përmbledhje e gjuhës, stileve të jetesës, bindjeve, zakoneve, vlerave, besimeve, normave etj. Ajo tregon arritjet e një shoqërie dhe të gjithë njerëzimit.  
Duke njohur dhe respektuar kultura të ndryshme, ne jemi të sigurt për të ardhmen e përbashkët të shoqërisë njerëzore.

**Fjalët kyçe:** mjedis, kulturë, besim, vlerë, muze, bibliotekë.

73



## Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

### Përpunimi i përmbajtjes

Teknika DLTA

Nxënësit tregojnë se çfarë po shohin në fotografitë e paraqitura dhe diskutohet se çka është kultura si dhe çka janë mjediset kulturore. Nxënësit emërtojnë vendet që shohin përmes fotografive.

Më pas lexohet situata e dhënë në libër.



## Përforsimi:

### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Diskutim i drejtuar

Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve nga libri:

- Çfarë po mendonte Ana?
- Ku do t'i çonte kushërinjtë?
- Çfarë mësojmë nga mjediset kulturore?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për diskutimin e fotografive të paraqitura dhe komentimin e situatës në libër, duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

## Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Tregon se njeriu është përgjegjës për përkujdesjen, mirëmbajtjen e mjedisit dhe shkaktari kryesor i ndotjes së tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I.4; II.1; II.2; III.1; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Një mjedis i pastër për të gjithë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon domethënien e thënies së paraqitur;
- Diskuton rreth situatës së dhënë në libër;
- Shkruan këshilla për mbrojtjen e mjedisit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Diskutim i drejtuar

Me anë të projektorit, para nxënësve paraqitet një thënie që ka të bëjë me natyrën. Kërkohet nga ta që të tregojnë domethënien e saj.




Një mjedis i pastër për të gjithë

**Situata 1.** Ana dhe familja e saj vendosën që të dielën ta kalonin në parkun e qytetit. E donin shumë qetësinë dhe gjelbërimin e atij vendi. Por, kur u afruan afër parkut, zhurma që dëgjonin i bëri të kuptonin që dita e sotme nuk do të ishte shumë e qetë në park. Ana pyeti prindërit se çfarë po ndodhte. Ata i treguan se njerëzit po protestonin kundër ndotjes së hapësirave të gjelbra. Ana, si një ambientaliste që është, u përfshi me turmën dhe u mundua të kuptonte thirrjet e tyre. Të gjithë protestuesit kishin në duar letra ku shkruhej: "Ruani Tokën!", "Ruani ujtin!", "Mos i pritni drurët!". Kjo e fundit i shkaktoi pak çudi Anës. Këta njerëz që protestonin kundër ndotjes së tokës, kishin shpenzuar qindra letra të cilat bëheshin nga druri i prerë. Gjithë rrugës për në shtëpi, Ana diskutoi me prindërit për këtë çështje.



74





**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:**  
**Përpunimi i përmbajtjes**  
 Teknika DLTA

Lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet, duke iu përgjigjur pyetjeve të librit.

- Ku shkoi Ana me prindërit?
- Pse u habit Ana?
- Po ju, a keni dëgjuar për protesta të tilla?
- Pse janë të rëndësishme ato?
- A kishte të drejtë Ana? Pse?



**Përforcimi:**  
**Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**  
 Shkrim 5-minutësh

Shikohet bashkë me nxënësit një video në lidhje me ndotjen e mjedisit.

Në fund të orës, nxënësve u shpërndahet një fletë A4 që të shënojnë disa këshilla për mbrojtjen e mjedisit dhe disa nga nxënësit i lexojnë ato që kanë shënuar.



**RUANI TOKËN!  
 RUANI UJIN!  
 MOS I PRITNI  
 DRURËT!**



- Ku shkoi Ana me prindërit?
- Pse u habit ajo?
- Po ju, a keni dëgjuar për protesta të tilla?
- Pse janë të rëndësishme ato?
- Cila ishte çudia më e madhe e Anës?
- A kishte të drejtë Ana? Pse?



Duke parë rëndësinë e mjedisit, krijohet nevoja e madhe për mbrojtjen e tij. Për një mjedis të pastër duhet të punojmë të gjithë. Njeriu është në kontakt me mjedisin gjatë gjithë jetës së tij. Nuk ka shëndet të mirë pa ujë të pastër, pa ajër të pastër dhe pa ushqim të shëndetshëm. Sot po përballemi me probleme që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit. Prandaj, të gjithë ne duhet të kontribuojmë sot, për një të ardhme më të mirë.

Fjalët kyçe: gjelbërim, ndotje, park, pastërti, protestë.

75

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për domethënien e thënies së paraqitur, diskutimin e situatës në libër dhe shkrimin e këshillave për mbrojtjen e mjedisit.

**Detyrë:**

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Shoqëria dhe mjedisi

**Shkalla e kurrikulës:** 2 **Klasa:** III

**Tema:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Demonstron veprime konkrete (në klasë, shtëpi apo rrethinë) për një ambient dhe mjedis të qëndrueshëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; II.1; II.3; III.4; IV.4; V.1; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 5.1; 5.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Higjiena në komunitet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpjegon kuptimin e thënies;
- Diskuton rreth situatës së dhënë në libër;
- Vazhdon me fjalët e tij/saj bisedën në situatën e librit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Diskutim i drejtuar

Me anë të projektorit, paraqitet një thënie para nxënësve. Kërkohej nga ta që ta shpjegojnë domethënien dhe mesazhin e saj.



Higjiena në komunitet

**Situata 1.** Siç e dini, Ana dhe Mati janë shokë klase. Ata, së bashku me shoqet dhe shokët e klasës dhe mësuesen/in, kanë disa rregulla për ruajtjen e higjienës në klasë, në korridor dhe në tualete. Kjo iniciativë erdhi pas një ligjërate që kishte përgatitur nëna e Matit për fëmijët e klasës.

Ajo kishte filluar ligjëratën me fjalinë "Pastërtia është gjysma e shëndetit". Ajo renditi fakte për mikrobet, parazitët, sëmundjet dhe çdo gjë të keqe që sjell një ambient i papastër.

Fëmijët menduan se, edhe pse ishin të vegjël, roli i tyre në këtë drejtim mund të ishte shumë i madh. Ana besonte se, nëse secili prej fëmijëve nuk do ta ruante higjienën personale, do të bëhej shkak për shpërndarjen e papastërtive në mjedise të ndryshme, si në klasë, në shtëpi apo në bibliotekë. Ishte ditë e bukur për të reflektuar për veprimet e secilit.

Ata duhej të kujdeseshin edhe për pastërtinë në komunitetin ku banonin. Të gjithë po mendonin se çfarë duhej të bënin në këtë drejtim...



- Çfarë krijuan Ana, Mati dhe shokët e klasës? Pse?
- Po ju, a keni një rregullorë të tillë?
- Tregoni për rregullat në klasën tuaj.
- Shkruani një këshillë për shokët/shoqet e klasës.
- Vazhdojeni bisedën e fëmijëve në situatën e dhënë.
- Si mendoni ju, çfarë mund të bënin fëmijët për higjienën në komunitetin e tyre?







### Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

#### Përpunimi i përmbajtjes

Teknika DLTA

Lexohet situata e dhënë në libër dhe diskutohet rreth saj bashkërisht me nxënësit. Më pas, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë krijuan Ana, Mati dhe shokët/shoqet e klasës? Pse?
- Po ju, a keni një rregullore të tillë?

Trego për rregullat në klasën tënde.



### Përforcimi:


#### Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Dhënie e ideve

Nxënësve u kërkohet që të vazhdojnë bisedën me fjalë të tyre në situatën e dhënë.

Në fund, nxënësit tregojnë se çfarë mund të bënin fëmijët për pastrimin e mjedisit në lagjen e tyre.


Disa nga idetë:



Që të kemi një jetë të shëndetshme, ne duhet t'i mbajmë të pastra të gjitha hapësirat ku veprojmë. Në lagjen në të cilën jetojmë, është përgjegjësi e secilit prej banorëve të komunitetit që të përkujdeset për një ambient të pastër. Prandaj, detyrat dhe përgjegjësitë janë të barabarta për secilin.

Fjalët kyçe: higjienë, komunitet, kujdes, përgjegjësi, pastërti.

77



### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shpjegimin e thënies, diskutimin e situatës në libër dhe vazhdimin e bisedës në situatën në libër me fjalët e tyre.

### Detyrë:

Plotëson në fletore pune.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---